

1 E enjte, 31 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Thaçi paraqitet përmes

5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i  
8 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
10 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim  
11 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.  
12 Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Vërej se të akuzuarit, me përjashtim të z. Thaçi, i cili  
15 po na ndjek përmes videolidhjes, të tjerët janë të pranishëm  
16 në sallën e gjyqit.

17 Vazhdojmë sot me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë  
18 W04295.

19 Ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

20 Z. Roberts, mezi po presim të na thuash a do kesh pyetje?

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, kam në fakt. E mendova në fakt  
22 gjatë natës dhe nuk kam pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

1 uleni. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

2 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
4 që erdhët përsëri sot. Do vazhdojmë sot me dëshminë tuaj. Ju  
5 kujtoj dhe një herë që pyetjeve t'ju përgjigjeni qartë me  
6 fjali të shkurtra. Nëse nuk e kupton një pyetje, lirisht  
7 kërkoni që pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni dhe  
8 do ta sqarojmë. Na thoni gjithashtu se ku i bazoni ju  
9 njohurinë, faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë  
10 pyetje.

11 Ju përsëris se jeni ende nën betim për të thënë të  
12 vërtetën sikurse vetë e thatë përmes betimit solemn.

13 Gjithashtu, flisni pranë mikrofonit dhe bëni një pauzë  
14 përpara se t'i përgjigjeni pyetjes në mënyrë që të përfundojë  
15 përkthimi.

16 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na thoni dhe do  
17 bëjmë organizimin përkatës.

18 Tani do të ketë pyetje z. Ellis që përfaqëson z. Jakup  
19 Krasniqi në këtë çështje gjyqësore. Është në të djathtën tuaj.  
20 Dëgjojeni me vëmendje.

21 DËSHMITARI: HAXHI MAZREKU [Vijon]

22 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

23 Z. ELLIS: [Përkthim]

24 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

25 PË. Mirëmëngjesi.

1 PY. Shumë pak pyetje kam sot paradite. Do përpiqem që të jem  
2 i qartë në pyetjet e mia.

3 Gjatë intervistës me Prokurorinë, e cila është tani pjesë  
4 e provave gjyqësore dhe ka numrin P1805.7, faqja 16, rreshti  
5 9, Prokuroria ju ka treguar një komunikatë dhe ti ke thënë që:

6 "Nuk i ndiqja këto komunikatat, por mund të them që e  
7 vërteta ... ose 100 për qind e të vërtetës mund të gjendet  
8 vetëm në faqen e fundit të gazetës ku janë emrat e personave  
9 që kanë vdekur. Sa u takon faqeve të tjera, personalisht nuk i  
10 besoja të gjitha ato që lexoja."

11 A e mban mend që ia ke thënë këtë Prokurorisë në 2019?

12 PË. Po. Dhe shumë e vërtetë është.

13 PY. Pra, po thonit që ju nuk e besonit që ishin të vërteta  
14 ato që shkruheshin në komunikatë, kështu?

15 PË. Jo. Por nuk i kam lexu se nuk i kam përcjellë  
16 komunikatat. E vërteta është që kush ka vdek ajo ka qenë 100  
17 për qind, domethënë, ku në faqet e fundit janë kanë që i kanë  
18 cek emnat e njerëzve që kanë vdek, kurse ato s'i kam përcjellë  
19 unë. S'kam qenë në atë drejtim unë. Aty është qëllimi im për  
20 me spjegju.

21 PY. E kuptoj. Gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë javën  
22 e kaluar, ti sqarove diçka nga ato që kishe thënë më përpara -  
23 jo është në paragrafin 33 të Shënimit Përgatitor numër 1 - dhe  
24 ti ke thënë se ti nuk e dije se kush i lexonte këto  
25 komunikata. Dhe kjo është e vërtetë në fakt sepse ti vetë nuk

1 i ndiqje komunikatat, apo jo?

2 PË. Po, shumë e vërtetë është.

3 PY. Tani do të kalojmë në një temë tjetër, që ka lidhje me  
4 një fragment të një libri, librin e Ilaz Kadollit dhe dje ta  
5 tregoi Prokuroria këtë paragraf. Dhe më duket se ti dje pohove  
6 se nuk e kishe parë ndonjëherë më përpara këtë libër dhe për  
7 herë të parë e ke parë kur ta tregoi Prokuroria, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Në një deklaratë të kohëve të fundit, e cila numrin  
10 081717, Pjesa 1, rreshti 12, faqja 7, i është bërë pyetje Ilaz  
11 Kadollit:

12 "Këto gjëra që ke shkruar në libër janë gjëra që i ke  
13 parë me sytë e tu apo janë informata që i ke mbledhur prej  
14 personave të tjerë?"

15 Ai ka thënë:

16 "Disa i kam parë me sytë e mi. Por shumica e gjërave që  
17 janë aty janë marrë nga interneti, nga shtypi ditor dhe nga  
18 personat të ndryshëm."

19 Pra, kur ta tregoj Prokuroria ty këtë librin, e dije ti  
20 që Ilaz Kadolli vetë kishte thënë që shumica gjërave që janë  
21 në libër janë marrë nga interneti, nga shtypi apo nga persona  
22 të ndryshëm?

23 PË. Për Zotin, unë nuk i kam përcjell këto komente as t'i  
24 shoh. Hera e parë këtu që i kam dëgju ato, atë lexim  
25 faktikisht.

1 PY. Faleminderit. Tani prapë do kaloj në një temë tjetër.  
2 Nëse e kam kuptuar unë siç duhet dëshminë tuaj, dy-tri javë  
3 pas ngjarjes së Oeterushës, ti ke ikur për në Shqipëri,  
4 kështu?

5 PË. Po. Ndoshta ka edhe më tepër, po jo bash dy-tri javë,  
6 ndoshta ka dhe më tepër veç kam me ik. Jam largu faktikisht  
7 kam ik. Kam ik thuja.

8 PY. Dhe aty je kyçur tek UÇK-ja në Kalimash dhe ke marrë  
9 pjesë në luftimet e Kosharës, kështu?

10 PË. Po.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Një çast, të nderuar Gjykatës.  
12 Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
14 Ka pyetje plotësuese nga Prokuroria?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
17 Barthe? Jo.

18 Gjykatësi Mettraux.

19 Pyetje nga Trupi Gjykses:

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

21 PË. Mirëmëngjesi.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë dua të sqarojmë disa  
23 aspekte që janë diskutuar dje.

24 Për këtë do t'i kërkoja Sekretarisë të vendosë në ekran  
25 materialin që mban numrin e provës P75.

1 Për të rifreskuar kujtesën, Dëshmitar. A mban mend që  
2 këtë dokumentin ta tregoi dje Prokurori, sidomos atë pjesën që  
3 kishte akuza për bashkëpunim që kishin lidhje me ty vetë dhe  
4 ti the që s'janë të vërteta? Të kujtohet dokumenti?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të  
7 çojë në faqen U001-9295. Bëhet fjalë për faqen 9295.

8 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës  
9 këshillohen]

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkohet ndjesë,  
11 Dëshmitar, se s'po e gjejmë dot dokumentin. Bëni pak durim, ju  
12 lutem. Bëhet fjalë për dokumentin U001-9244 deri në U001-9306.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nëse mund ta ndihmojmë Sekretarin  
14 e seancës, është pjesë e një prove materiale që është pranuar  
15 tashmë, faqja 49 e një materiali me 63 faqe në PDF.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit dhe z.  
17 Halling dhe Sekretarit.

18 Dëshmitar, tani shiko pak në fund djathtas në qoshe  
19 poshtë djathtas të kësaj faqeje. E sheh emrin tënd aty?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë një herë në të  
22 majtë të faqes në krye. E shihni që ka një shënim këtu i datës  
23 16 korrik 1998. E shihni?

24 PË. Po, po e shoh shënimin.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që të kuptojmë nga

1 pikëpamje kohore, i bie kjo të ketë qenë përafërsisht nja dy  
2 ditë pas sulmit në fshatin tuaj, kështu, dy ditë para sulmit?  
3 PË. Para sulmit. Për çka bëhet fjalë?

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Data 16 korrik 1998 ka  
5 qenë dy ditë para sulmit në fshatin tuaj, kështu? Kështu  
6 është?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani shikojmë poshtë  
9 djathtas, në të djathtë të faqes poshtë. Tek anglishtja  
10 përmendet fshati juaj Optrushë dhe ka dhe këtu thotë  
11 "personat që duhen marrë në pyetje". Është një emri juaj dhe  
12 ti e konfirmove: "Haxhi Mazreku (ushtar)". Është dhe një Nezir  
13 Mazreku.

14 A mund të na thoni kush është ky person?

15 PË. Për Nezir Mazrekun është kushëri i jemi. Edhe ka qenë  
16 kryetar i socialistes, domethënë, në Operush ka shërbu si  
17 kryetar. E ka punu punën e vet, ka punu punë bujqësie. Kryetar  
18 ka qenë. Ka këqyrë me mbrojt me çdo kusht fshatin. Bile për  
19 këtë person bajagi shumë kam rreziku ndër vedin që dojshin për  
20 me e marrë, por i thashë "Nëse këtë e mirrni atëherë duhet me  
21 më hjek mu, tani këtë me e marr, se përndryshe s'leshoh pe".  
22 Kështu ka qenë. E din edhe fshati, e din edhe gjithë. Veç pse  
23 ka qenë kryetar i socialistes, domethënë, në atë kohë.

24 Ka pyetje ndonjë sen? Ka pyetje tjera?

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Po. E para kur thatë

1 ju "e morën" kush u përpoq ta merrte?

2 PË. Po këta që u bashkangjiten gjoja që UÇK-së, domethënë,  
3 këta personat. Po këta krejt komplet problemi që ka qenë prej  
4 fshatit, fshatarët e tanë domethënë. Se ky demek kryetar i  
5 socialistes edhe me e këqyrë me e marrë këtë se gjoja  
6 bashkëpunëtor. S'ka të bëj me bashkëpunëtor ai absolutisht as  
7 sen, jo Zotit. E kam mbrojt me mish e me shpirt fshatin,  
8 komplet komunitetin shqiptar, serb, romë që i kemi pas.

9 Po këtu ka qenë një farë propagande, një farë kërcënimi.  
10 Edhe unë u mendojsha me grupin tim në pritje për mos me ardhë  
11 tek derti tek konflikti, mos me ardhë tek derti tek  
12 gjakderdhja. Edhe më kapën sy të keqen dhe mu. Kjo është e  
13 vërteta.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur thoni që ai mbronte  
15 fshatin me aq sa të mundej, e ke fjalën, që njësoj si ty edhe  
16 ai po mbronte fqinjët e tij serbë?

17 PË. Kur them mrojke fshatin domethënë, para konfliktit se unë  
18 asaj kohës nuk i them që ka qenë luftë, po ka qenë konflikt,  
19 para konfliktit kemi pas probleme nëpër fshat domethënë. Ai u  
20 mundoke me e stabilizoi fshatin me e qetësu, mos e çu në polici  
21 djemtë shqiptarë, po flas, ose çdokushi që i ka bë ndonjë  
22 problem u mundoke me i eliminu problemet edhe me e pas  
23 qetësinë në fshat. Kjo është.

24 Në kohën e luftës, që po i thojmë luftë, atëherë e kam  
25 marrë unë atë përsipër komplet atë barrë edhe jam mundue edhe



1 unë me i mbajt një farë rendi, një farë qetësie, një farë  
2 drejtimi. Se thjesht na si UÇK kemi qenë kundra regjimit serb,  
3 kundra uniformës serbe, policia serbe, jo kundra civilëve. Por  
4 me civilë atë e dim çdokushi që fëmijë të vogël me vet që  
5 është e ndalume.

6 Kështu që unë, bile veprimi jem që ka qenë, unë qysh kam  
7 vepru në atë kohën e luftës, asht për me i mburrë shqiptarët,  
8 është për me u mburrë edhe Evropa edhe mbarë bota. Sepse punë  
9 të pahijshme ku thuhet ose në krime ose në keqpërdorime unë  
10 gjithmonë kam intervenu. Nuk bën kështu duhet me u kanë ka e  
11 mbara ka e mira. Me mbrojt veç me mjete, veç familjarët, ndesh  
12 me anë të pushkës me i mbrojt për mos me ardh derti tek një e  
13 keqe. Po mu ma morën për të keq, po ma morën të fshatit. Tani  
14 si se ngrehet qysh shku tuj u përfol për mu, tuj u përfol edhe  
15 mbeta, mbeta ku mbeta. Po ja që kam qenë i padëshirueshëm  
16 thuaja dhe për të.

17 A unë jam në gjendje me dalë para çdo institucionit,  
18 ndesht kryetar shteti, ndesht kryetar komune, ndesht kryetar  
19 bote m'i tregu realitetin të vërtetën çka a.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në emrin Nezirit a ka qenë  
21 një prej emrave që ishte në atë listën me 18 personat që  
22 dyshoheshin si bashkëpunëtorë, ajo lista që kishe parë para  
23 sulmit në fshat, ishte dhe emri i tij në atë listë?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa kuptova unë, ti gjatë

1 intervistës me Prokurorinë ke thënë që Nezirit i kishin marrë  
2 një armë. E kam kuptu si duhet?

3 PË. Po, mirë e ke kuptu, po mbasandej e kanë marrë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kush ia mori armën?

5 PË. Po janë ardh disa persona nga Samadraxha, pjesëtarë kanë  
6 qenë të UÇK-së me ja marrë armën. Kur ndëgjova unë me grupin  
7 tim, derisa unë shkova atje, ai veç e kish dorëzu armën.  
8 Armën, një allti është fjala, e kish dorëzu. Edhe atëherë po i  
9 them unë "Ktheja armën". Ai po thotë "Jo, jo ia dhashë unë  
10 këtë dhe u kry ky muhabet". Dhe për mos me ardhë tek derti te  
11 e keqja se unë kisha mujt me u hakmarrë me ata. Unë qaq për  
12 temin jam në gjendje që t'i dishna me kë ka krejt. Po ai është  
13 i shini, faktikisht këtë problem e shini vetë. Tha "Ia dhashë  
14 armën dhe rri, Haxhi, mos bën zë".

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të  
16 shkojmë në faqen U001-9286 në të njëjtin dokument.

17 Dëshmitar, shiko në të majtë të dokumentit. Është një  
18 shënim këtu -- ju lutem shkojmë pak më poshtë. Është një  
19 shënim që mban datën 23 korrik 1998. E sheh?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu thuhet që ata e kanë  
22 përgatitur këtë dokument kanë biseduar me përfaqësuesit e  
23 fshatit Brestovc përreth datës 23 korrik 1998, që i takon  
24 rreth pesë ditë pas ngjarjes në fshatin tuaj.

25 Tani unë do t'ju pyes nëse dini diçka lidhur me këta

1 gjashtë persona - më falni - njihni ndonjë prej këtyre gjashtë  
2 personave?

3 PË. Unë për zotin, me asnjënin nuk jam njoft. Që ky emri i  
4 Nahit Elshani ky më duket si ka qenë i LDK-së, mos ka punu në  
5 Rahovec përpara, para konfliktit, para luftës. Si emën po më  
6 duket. Këta të tjerët asnjënin s'i njof. Jo që kam pas  
7 kontakte me Nahitin si, por si person kështu më duket që e kam  
8 pa.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Ruzhdi Kabashin, për  
10 shembull, të thotë gjë ky emër?

11 PË. Po ky Ruzhdi Kabashi na e kem -- ti the për fshatin  
12 Brestovc apo? Kurse Ruzhdi Kabashi na kemi dhe në fshatin  
13 tonë. Por ju thatë për në Brestovc. Unë në Brestovc Ruzhdi  
14 Kabashi nuk e njof.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë po  
16 vazhdoj me një pyetje tjetër.

17 Tani dua të pyes për pyetjet që të kanë bërë në duart e  
18 Ilaz Kadollit. A të kujtohet që fole për këtë me Prokurorinë?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më duket se ti ke thënë se  
21 ai u prezantua si komandant, po ama nuk të tha që ishte anëtar  
22 i shërbimit të zbulimit dhe kundërzbulimit, kështu?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me përfaqësitë kujtohet  
25 kur të kanë marrë në pyetje?

1 PË. Për data, muaj, e kam problem për me ju caktu, po si  
2 ngjarje e di.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim dhe për atë që  
4 ka ndodhur atë ditë. Po përpiqu pak nga pikëpamja kohore, për  
5 shembull, a ka qenë para sulmit apo pas sulmit në fshatin  
6 tënd? Nëse ka qenë para, me për afërsi sa kohë para? Nëse ka  
7 ndodhur pas sulmit, me për afërsi sa kohë pas sulmit?

8 PË. Jo kjo mu që më kanë shku përpara mbas sulmit ka qenë kjo.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me për afërsi sa kohë më  
10 pas? Me për afërsi.

11 PË. Dy javë, një muaj. Ashtu diçka ka mujt me qenë, hiç më  
12 tepër jo.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Mesa mban  
14 mend ti, ai ka qenë vetëm apo ka qenë i shoqëruar nga persona  
15 të tjerë?

16 PË. Po mesi më kanë çuar atje në atë farë shtabi. Ka pas aty  
17 edhe persona tjerë, po ai folke. Ka pas roje, ka pas rreth ka  
18 pas.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ku ka qenë saktësisht na e  
20 thua dot?

21 PË. Saktësisht ka qenë në Semetishtë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën me ZPS-në  
23 ti ke thënë që Ilaz Kadolli të ka kërcënu, kështu?

24 PË. Po, është e vërtetë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na tregon dot për çfarë të

1 ka kërcënuar?

2 PË. Po ishin në pyetje dikund 30,000 marka në atë kohë që i  
3 lypshim ne, domethënë, ku janë tash UÇK-ja. E unë thosha që  
4 ato para janë të fshatit, domethënë, ato pare janë për me ble  
5 ushqim, veshmbathje pas nevojë, armatim, po për fshat tonin,  
6 jo për tjerët. Ejupi, Ejup Kabashi me këmbëngulje ato pare me  
7 ia dhanë unë atynve. Unë atynve nuk ia dhashë, domethënë,  
8 Ejupi, grupit të Ejupit nuk ia dhashë. "Sepse këto janë",  
9 thashë, "më kanë ardh mue dhe unë kam përgjegjësi për to".  
10 Erdhëm më morën e më çuan atje, "Paret me na i pru. 24 orë i  
11 ke", tha, "kohë ose paret ose e din se çka të gjen".  
12 Domethënë, kjo ishke kërcënimi që -- thashë "Mos e prit 24  
13 orëshin, por që tash", thashë, "ekzekutom, se paret nuk i  
14 jap". Edhe fjala e tij tha ke "Ti", tha, "je atje por je i  
15 drejtë", tha, "Je atje por je budall", tha. "Diçka te ti",  
16 tha, "është në pyetje". Thashë "Zgjidhe cilën dush, unë paret  
17 nuk i jap kurrë". Edhe më dhatën afat 24 orë.

18 Shkova në shtëpi, i mora paret dhe komplet i shkepa  
19 familjarëve të tyne qysh i kanë çu djemtë e tyne prej  
20 mërgatës, unë i shkepa nëpër shtëpia. "O zotni ti një mijë, ti  
21 një mijë", se ka një mijë i kanë çu. Ka pas prej Kabashëve, ka  
22 pas prej Spahijve. Shumica ka qenë Mazrekë. I kam shpërnda dhe  
23 jam rehat.

24 Për shka më ndodhi ma tavani mbasandej mbasi është kry  
25 krejt, kur jemi kthyer prej mbas luftës, krejt qëta familjarët

1 që u kam kthyer paret, tanë që më merrshin në përfaqim. "Haxhi  
2 me ato pare që mi ke dhënë ti unë kam shku në Shqipëri e kam  
3 shpëtu familjen teme". Unë e ndijsha veten krenar me atë  
4 gjest që e kam bë. Ai ka qenë gjest human për mu. Kurse në  
5 anën tjetër kam qenë shumë i kërcnum. Okej. Faleminderit.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam nevojë për një sqarim,  
7 për procesverbal, se mbase ka dalë emri gabimisht. Këto gjëra  
8 që të kanë thënë, këto kërcënime, këtu ka dalë sikur i ka  
9 bërë Kabashi. Mos e ke pas fjalën që këto janë kërcënime e  
10 Ilaz Kadollit se na ka dalë Kabashi këtu?

11 PË. Kabashi e ka dhezë në Opterushë, domethënë, thashethënet  
12 për mu. Kurse këta tjerët, pala tjetër, se s'e kanë njoft se  
13 kush është Haxhia thjesht, këta tani e kanë marrë gjoja që  
14 jemi na pak më fortë ose ma të ashpër ose mos e bind  
15 provokimet tynve ose në kërcënime tynve, po unë nuk u  
16 dorëzova. Dhe thashë dhe diçka "Unë jam me një fytyrë kam le  
17 dhe me një kam me vdek. Kështu që s'ka shancë".

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që të jem i qartë, këtë  
19 kërkesën që duhet të jepje këto paratë, këto 30,000 markat  
20 gjermane, këtë ta kërkoi Kadolli apo ta kërkoi Kabashi, kush  
21 t'i kërkoi paratë?

22 PË. Kabashi i ka kërkue ndërmjet njerëzve të vet. Po unë  
23 s'kam marrë parasysh se s'ka pas guxim ai me më dalë përballi  
24 mu. Kurse tani i ka shti këta tjerët, këta si pak ma ekstra,  
25 si më policë specialë si ma dhe i ka shti. Këta tani erdhën

1    thua j a më arrestutën me ardh me dhënë deklarëtë për ato pare  
2    pse s'po na i japësh neve. Edhe "Po mor", thashë, "nuk ka  
3    problem. Kudo që je, unë vij". E jam shku po nuk kam shku duar  
4    lidhë po kam shku normal. Edhe tani kemi hi. Po ai fillojti me  
5    kërcënime atene dhe unë e mbajsha atë qëndrimin tem. Kjo ka  
6    qenë e tëra dhe e vërteta.

7           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Domethënë, "kur filloj të  
8    më kërcënonte", tani e ke fjalën për Kadollin? Kush të  
9    kërcënoi?

10   PË.   Për Kadollin. Po, për Kadollin.

11           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këto kërcënime dhe kërkesa  
12   që t'u bënë a ia raportove dikujt në UÇK apo a ke mund në atë  
13   kohë t'ia raportojsh ato dikujt në UÇK?

14   PË.   Jo, sesa ma shumë që folsha aq më shumë u rrezikojsha.  
15   Unë e kisha vetëm axhën tem, tash është për rametli, tash nuk  
16   a, ka vdek. Krejt i tregojsha atij "Këqyre se nëse ndodh diçka  
17   me mue që pi që knejni po vjen rreziki, pi qati po vjen  
18   rreziki". Për çdo send atij i informojsha. Dhe ai e kishte  
19   fort, fort vecveci. "Qysh ki ke thënë mor, Haxhi, qi ki po  
20   rrezikoj shumë, po s'ki me kën me rreziku". Aty ka qenë ajo e  
21   vërteta.

22           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, zotni. Këto  
23   ishin pyetjet e mia për ty.

24           GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

25           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni pyetje

Dëshmitari: Haxhi Mazreku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 16

1 palët?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kam pyetje.

3 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kemi pyetje.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Kam një pyetje.

5 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

6 Z. ELLIS: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, në faqen 9 të transkriptit, Gjykatësi Mettraux  
8 ju pyeti se kush ia mori armën Nezirit. Dhe ju u përgjigjët:

9 "Se ishin do njerëz prej Samadraxhe ..." - më fal në  
10 qoftë se s'e shqiptoj si duhet fshatin.

11 Pyetja ime është kjo: A ju kam kuptu drejt se ky fshat  
12 është rreth 4 kilometra prej Opterushës?

13 PË. Po, shumë e saktë.

14 PY. Çka është e saktë, më falni?

15 PË. E saktë është 4 kilometra dikun. 3-4 kilometra është prej  
16 Opterushës fshati Samadraxhë. Fort mirë po ju kuptoj për çdo  
17 send.

18 PY. Më fal, unë e shqiptova keq emrin e fshatit dhe kërkoj  
19 ndjesë. U sqaru tash.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, me  
21 kaq përfundon dëshmia jote. Tani je i lirë të largohesh prej  
22 Gjykate. Faleminderit edhe një herë që erdhët për të dëshmu  
23 dhe që ndatë informacionet me ne, ju dëshirojmë çdo të mirë.

24 DËSHMITARI: Faleminderit dhe prej juve të gjithëve.

25 Respekt për të gjithë.



1 [Dëshmitari largohet]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë  
3 pushim prej 15 minuta për ta sjellë dëshmitarin tjetër. Do të  
4 vazhdojmë në orën 9.45 minuta.

5 --- Seanca ndërpritet në orën 9.32

6 --- Seanca rifillon në orën 9.48

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara me  
8 dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë me numrin 04758, Trupi  
9 Gjykes dëshiron që të merret me disa çështje paraprake. Do të  
10 ketë tre urdhra me gojë.

11 I pari është i shkurtër.

12 Dhe në bazë të rregullës 82(5), Trupi Gjykes  
13 riklasifikon P02671, që në fakt është një urdhër i dhënë në  
14 Gjykatë që ky urdhër të klasifikohet si konfidencial. Dhe  
15 përkthimet duhet gjithashtu të riklasifikohen si të tilla.

16 Ky është fundi i këtij urdhri.

17 I dyti, urdhri i dytë me gojë.

18 Që në datën 24 tetor të vitit 2014, Trupi Gjykes,  
19 dokumenti me numrin provizor 123264 deri në 123267 si P01765  
20 duke pritur përkthimin e rishikuar. Dhe nuk kishte  
21 kundërshtime në lidhje me këtë dokument.

22 Gjithashtu, në parashtrimin 1467, ZPS-ja ka parashtruar  
23 përkthimin e rishikuar të këtij dokumenti. Prandaj, në rast se  
24 nuk ka kundërshtime të tjera nga palët dhe pjesëmarrësit,  
25 atëherë Trupi Gjykes do të pranojë faqet e dorëzuara nga ZPS-

1 ja, faqet 123265 deri në 123267.

2 A ka kundërshtime?

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ne, në fakt, kemi dorëzuar edhe  
4 një dokument tjetër të rishikuar në Paketën 1473, gjë të cilën  
5 unë do ta thosha sot përpara procesverbal. Dhe ERN e saj është  
6 123264 deri në 123267-ET E Rishikuar me numrin 1 dhe ne  
7 dëshirojmë ta aplikojmë që ky përkthim i rishikuar t'i shtohet  
8 dokumentit P1765 dhe të jetë pjesë e dokumenteve që do t'i  
9 shfaqen Dëshmitar 4758.

10 Faleminderit.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka  
14 kundërshtime. Atëherë Trupi Gjykses pranon 123264 deri në  
15 123267-ET Të Rishikuar si pjesë e materialit P1765. 1765, apo  
16 jo?

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
19 statusi i provave të P01765 do të ndryshohet kur të pranohet.  
20 Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërkohë që  
22 kemi dhe një urdhër të tretë me gojë.

23 Urdhri i tretë është.

24 Gjithashtu, në datën 24 tetor të vitit 2024, një dokument  
25 tjetër me referencën U008-1625-U008-1625 si prova me numër

1 provizor MFI V00008, është dorëzuar nga Mbrojtja e Viktimave  
2 për t'u pranuar.

3 Dhe Palët Mbrojtëse të Veselit dhe Thaçit kanë  
4 kundërshtuar për pranimin e këtij materiali.

5 Dhe duke marrë parasysh kundërshtimet dhe parashtrimet e  
6 palëve, atëherë Trupi Gjykses është i kënaqur që ky dokument  
7 është i rëndësishëm për këtë çështje. Prandaj Trupi Gjykses ka  
8 rënë dakord me parashtrimet e Avokatit të Viktimave që është i  
9 rëndësishëm dhe që kjo deklaratë për shtyp nga organizata që  
10 ka të bëjë me drejtorinë e informimit të UÇK-së ka të bëjë me  
11 një viktimë e cila thuhet që është mbajtur në një vend të  
12 caktuar.

13 Dhe, gjithashtu, në lidhje me autenticitetin e saj, Trupi  
14 Gjykses është i kënaqur që autenticiteti -- në lidhje me  
15 autenticitetin e saj. Gjithashtu, në lidhje me këtë datë bëhet  
16 fjalë pikërisht për artikullin me emrin Bujku.

17 Ndërkohë që sa i përket Trupi Gjykses, mocionit për prova  
18 joligjore, vendimi ynë i tretë është që në këtë dokument të  
19 paktën mungon *prima facie* vlera vërtetuese e saj dhe është e  
20 paqartë nëse informacioni që ka dalë në këtë dokument është i  
21 duhur dhe kërkohet në fakt që të vihet në kontekstin e duhur.  
22 Megjithatë, Trupi Gjykses ka kuptuar që prej atij vendimi  
23 personi me emër në këtë dokument është identifikuar si viktimë  
24 që ka marrë pjesë në këto procedura. Dhe Dëshmitari W04758  
25 është konfirmuar pikërisht në këtë dokument dhe që një person

1 me një emër të ngjashëm është përmendur në dokument dhe është  
2 mbajtur nga UÇK-ja, për këtë arsye Trupi Gjykses ka dëgjuar  
3 provat që janë dorëzuar për sa i përket drejtorisë së  
4 informimit apo nëse është drejtorja për informim nga  
5 dëshmitarë të ndryshëm si për shembull, Dëshmitari W04752. Dhe  
6 jemi të kënaqur për kontekstualizimin që ka ndodhur, prandaj  
7 Trupi Gjykses mendon që dokumenti MFI V00008 përmbush kriteret  
8 e rregullës 138 dhe e pranon atë si provë.

9 Dhe ky është edhe fundi i këtij urdhri të tretë me gojë.

10 Kemi dhe një çështje të katërt, Trupi Gjykses rikujton që  
11 avokatët mbrojtës të z. Thaçi kanë të drejtën që të dorëzojnë  
12 SPOE00227422 deri në SPOE00227423 në rast, pra, pranohet nga  
13 Trupi Gjykses V00008 si provë.

14 Dhe meqenëse është pranuar tashmë si provë ky dokument  
15 nga Trupi Gjykses, atëherë a dëshiron që ta dorëzojë këtë  
16 dokument Avokati Mbrojtës i z. Thaçi?

17 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar  
18 Kryetar i Gjykatës, ne do ta marrim këtë në konsideratë dhe do  
19 t'ju kthejmë përgjigje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Kjo ishte pjesa e urdhrave me gojë dhe tani do të vijojmë  
22 me dëshminë e Prokurorit W04758.

23 Nëse mund të sillet në sallë dëshmitari.

24 Nuk e përmenda këtë gjë më parë, por për procesverbal, z.  
25 Misetic është në fakt *online*, pra e kemi të lidhur me video

1 dhe shpresojmë të na dëgjojë e ta dëgjojmë siç duhet.

2 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. Ju  
3 dëgjoj siç duhet, i nderuar Gjykatës.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
6 mund të vini kufjet.

7 Mirëmëngjes, Dëshmitar. Mirë se keni ardhur sërish. Sot  
8 ne do të vijojmë me dëshminë tuaj dhe shpresojmë shumë që ta  
9 përfundojmë atë sot, besoj që dhe ju këtë dëshironi.

10 Ju rikujtoj që t'u përgjigjeni pyetjeve qartësisht dhe me  
11 fjali të shkurtra. Në rast se nuk kuptoni një pyetje, mund të  
12 pyesni Mbrojtjen, pra, që ta përsërisë pyetjen ose në rast se  
13 nuk e kuptoni thojeni këtë gjë në mënyrë që ata ta sqarojnë.  
14 Gjithashtu, kur flisni tregoni dhe bazën mbi të cilën i  
15 mbështesni faktet të cilat do të tregoni apo përgjigjet e  
16 pyetjeve.

17 Ju rikujtoj edhe një herë që keni sërish detyrimin që të  
18 tregoni të vërtetën dhe vetëm të vërtetën ashtu siç keni thënë  
19 në deklaratën që keni bërë.

20 Mos harroni që të flisni pranë mikrofonit, prisni pesë  
21 sekonda përpara se t'u përgjigjeni pyetjeve dhe flisni me  
22 ngadalë në mënyrë që përkthyesit të kenë mundësi t'ju  
23 përkthejnë saktësisht.

24 Dhe në rast se keni nevojë për ndonjë pushim, ju lutem na  
25 e thoni këtë gjë dhe do të përpiqemi ta bëjmë këtë gjë të

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 22

1 mundur.

2 DËSHMITARI: Nuredin Ibishi [Vijon]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
4 fillojmë tashmë me pyetjet e fundit nga Mbrojtja e z.  
5 Krasniqi.

6 Znj. Alagendra, fjala për ju. Dhe keni 15 minuta kohë që  
7 ju kanë mbetur.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
9 Gjykatës.

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

11 [Vazhdim]

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

13 PY. Mirëmëngjes, z. Ibishi.

14 PË. Mirëmëngjesi.

15 PY. Dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje në lidhje me disa  
16 sqarime që na duhen me përgjigjet që i keni dhënë Prokurorisë  
17 gjatë përgatitjes që keni bërë.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem në ekran vendosni  
19 paragrafin 60 të Shënimit Përgatitor numër 2.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Nëse mund të na jepni  
21 referencën përkatëse.

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Referenca është ERN 123228  
23 deri në 123253. Paragrafin 60, ju lutem. Po. Po e lëmë këtë  
24 pjesë në ekran dhe do të vijojmë më poshtë më vonë.  
25 Faleminderit.

1 PY. Z. Ibishi, ju e mbani mend që ju është bërë pyetja në  
2 lidhje me një person me emrin Enver Sekiraqa gjatë kohës që  
3 keni bërë seancën përgatitore, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ju i keni thënë Prokurorisë që ju e njihnit Enver  
6 Sekiraqën si një person problematik që prej viteve 1990, e  
7 mbani mend këtë?

8 PË. Po.

9 PY. Po gjithashtu ju keni thënë që për momentin është në burg  
10 për shkak të një dënimi penal që i është dhënë. E mbani mend  
11 këtë?

12 PË. Po.

13 PY. Dëshiroj të identifikoj faktin për Enver Sakiraqën, kush  
14 është ai.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Për këtë arsye mund të  
16 vendosim në ekran dokumentin me numër DJK01037-ET. Është  
17 njësoj si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze.

18 PY. Atëherë e shihni këtu fotografinë në ekran në versionin  
19 shqip, z. Ibishi?

20 PË. Po, vetëm se në anën e djathtë timen e kam vetëm  
21 përkthimin e kam në anglisht. Kështu që në anën e majtë të  
22 monitorit e kam në shqip. Kështu që urdhnoni për komentimin.

23 PY. Po. Në fakt fotografia është në versionin origjinal,  
24 ndërsa në të djathtë keni vërtetë vetëm përkthimin në gjuhën  
25 anglisht. Kjo për Gjykatën.

1 Thjesht dëshiroj që të identifikojmë personin. A është ky  
2 person Enver Sekiraqa për të cilin ju keni folur gjatë seancës  
3 përgatitore me Prokurorinë?

4 PË. Po. Në pyetjet e Prokurorisë kam folur, pra, lidhur me  
5 të.

6 PY. Atëherë ju keni thënë që ai ka qenë në burg për një dënim  
7 penal. E keni fjalën për këtë dënim 25 vjet për vrasjen e  
8 oficerit të policisë Triumf Riza në 2007?

9 PË. Po.

10 PY. Faleminderit.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani  
12 këtë dokument. Dhe në ekran do t'ju lutesha të vendosim  
13 dokumentin me numrin DJK1040-ET si edhe versionin në gjuhën  
14 shqipe i cili është me numrin DJK01038239. Në shqip numri që  
15 kërkoni për referencë është numri DJK01038 deri në 39. Dhe  
16 nëse mund të kalojmë në fund të faqes, ju lutem edhe pak më  
17 poshtë.

18 PY. Pra, ju keni thënë që ju besonit që Enver Sekiraqa ishte  
19 në burg për shkak të këtij dënimi që i ishte dhënë në kohën që  
20 keni folur me Prokurorinë dy javë më parë.

21 Tani, unë thjesht dëshiroj t'ju tregoj këtë artikull. A e  
22 dinit ju që ka patur lajme që Enver Sekiraqa ishte arratisur,  
23 pra, ishte ai i arratisur në atë kohë kur ju keni folur me  
24 Prokurorinë? Ky është një artikull nga data 17 maj 2024.

25 PË. Po.



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 25

1 PY. Kuptoj. Pra, ju e dinit që ai ishte i arratisur dhe që  
2 për momentin nuk është në burg?

3 PË. Ashtu sa kam informacione para se të vij këtu, ashtu  
4 është. Është i arratisur.

5 PY. Pra, është arratisur. Pra, ndërmjet majit 2024 dhe  
6 periudhës kur ju keni folur me Prokurorinë për seancën  
7 përgatitore, a ishte arrestuar dhe mbahej sërish me ç'dini ju?

8 PË. Për cilin vit, më fal edhe një herë, i referohesh? Viteve  
9 të luftës apo? S'kuptova.

10 PY. Jo. Në maj të 2024, kemi një artikull ku thuhet që ai  
11 është arratisur. Dy javë më parë kur ju folët me Prokurorinë  
12 menduat që ishit ende në burg, pra. Pyetja ime është ndërmjet  
13 majit 2024 dhe momentit kur keni folur me Prokurorinë përpara  
14 dy javësh a kishit dëgjuar që ishte arrestuar sërish ky person  
15 dhe ishte në parandalim?

16 PË. Jo, nuk kam ndëgju. Unë mendoj, sipas informacioneve të  
17 mia, akoma mendoj, mendoj, se është i arratisur. Nuk kam  
18 informacion në atë [E pakuptueshme].

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Atëherë do t'ju lutesha që  
20 në ekran të vendosej dokumenti me numrin DJK01036, si në shqip  
21 ashtu edhe në anglisht.

22 PY. Atëherë ky është një artikull i cili është botuar në  
23 vitin 2010 pas dënimit që ai ka marrë në vitin 2007, ose të  
24 paktën për dënimin prej 25 vjetësh të cilit iu referuam në  
25 artikullin që ju treguam më parë. Sipas këtij artikulli nga

1 *The Irish Times*, Enver Sekiraqa konsiderohej figura kryesore e  
2 krimit të organizuar në Kosovë dhe që jetonte në Irlandë dhe  
3 që ishte tashmë në listën e të kërkuarve të Interpolit. Dhe  
4 sipas këtij artikulli, thuhet që ai është dënuar me 36 vjet  
5 burg, apo jo?

6 PË. Po ashtu informacionet flasin, tash unë s'muj ta  
7 kualifikoj a ka qenë, domethënë, gjegjësisht, personi që është  
8 më i kërkuari për krime organizuar. Është çështje e  
9 drejtësisë. Por ajo çka qëndron që është kërkuar për organe të  
10 drejtësisë për shkak të vet, domethënë, të ikjes tij nga  
11 drejtësia.

12 PY. E kuptova, z. Ibishi.

13 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
14 dëshiroj që të dorëzojmë si prova këta tre artikuj.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Alagendra, përpara se  
16 ta bëjmë këtë gjë cili është synimi për këtë?

17 A po na thoni ju që Enver Sekiraqa është një person i keq  
18 dhe nuk duhet të besojmë asgjë që ka thënë ai për parandalimin  
19 e tij, burgosjen e tij e të gjitha këto gjëra?

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Këta artikuj konfirmojnë që  
21 ai është arratisur nga juridiksioni.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po ju pyes për këtë  
23 gjë, znj. Alagendra. Po ju pyes se përse është i rëndësishëm  
24 për ne ky informacion në këto artikuj? Kemi dëgjuar që ka qenë  
25 i dënuar. Me dëshmitarin e kuptuam që dhe ai e di që është

1 arratisur. Ajo që po ju kërkoj është përse është i dobishëm  
2 për ne ky informacion?

3 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Sepse ka të bëjë me  
4 kredibilitetin, pra, besueshmërinë e z. Sekiraqa.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, të Sekiraqës?

6 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe besoj që pasi të jenë  
8 dorëzuar dokumentet nga Mbrojtja ne do të kërkonim që, nëse do  
9 të bëheshin kundërshtime, do të kishim kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkojmë që dokumenti  
12 DJK01037 si në anglisht ashtu edhe në shqip. Dokumenti  
13 DJK01040-ET me versionin në shqip me referencën DJK01038 deri  
14 në 39 dhe dokumenti DJK01036 si në shqip dhe në anglisht të  
15 dorëzohen për t'u pranuar.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar, unë kundërshtoj për  
17 bazën e kësaj kërkesë që bëhet. Sepse, në fakt, Avokati e ka  
18 diskutuar me dëshmitarin dhe ka folur pikërisht për çështjet e  
19 besueshmërisë për sa i përket, pra, këtij dëshmitari dhe ai ka  
20 folur për këto gjëra, kështu që ne nuk e shikojmë se pse janë  
21 të dobishme, pse duhet të ishin të dobishme për Gjykatën këto  
22 dokumente për t'u pranuar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Paneli

1 Gjykues, Trupi Gjykues do të vendosë në lidhje me këtë  
2 çështje në një moment tjetër. Deri atëherë do t'i japim një  
3 numër për ta identifikuar, në fakt, të treja këto artikuj do  
4 të marrin numrat përkatës.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
6 dokumenti DJK01037 deri në DJK01037 dhe përkthimi në gjuhën  
7 angleze do të marrin numrin 4D00093. Dokumenti DJK01040 deri  
8 në DJK01040 dhe versioni në gjuhën shqipe që ka numrin  
9 DJK01038 deri në DJK01039 do të marrë për identifikim numrin  
10 4D00094. Ndërsa dokumenti DJK01036 deri në DJK01036 dhe  
11 përkthimi në gjuhën angleze për identifikim do të marrin numrin  
12 4D00095.

13 Thjesht dëshiroj që të shënohet që nuk na është thënë  
14 asgjë sa i përket klasifikimit të këtyre dokumenteve.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për momentin  
16 do të qëndrojnë konfidenciale.

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po janë lajme që kanë qenë  
18 publike, të nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne nuk i kemi  
20 pranuar ende deri më tash, kështu që do të mbajnë klasifikimin  
21 konfidencial për momentin.

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

25 Pyetje vijuese nga znj. D'Ascoli:

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, kam disa pyetje të tjera për ju. Gjatë  
3 kundërpjetjeve, Mbrojtja e z. Thaçi ju ka bërë pyetje në  
4 lidhje me kontaktet ndërmjet zonës së Llapit dhe Shtabit të  
5 Përgjithshëm, dhe këtë e gjejmë në transkript në procesverbal  
6 në faqen 21132. Kur u përgjigjët në lidhje me shpeshësinë e  
7 këtyre kontakteve, pra, sa të shpeshta kishin qenë ato, ju  
8 thatë dhe lexoj nga faqja 21132:

9 "... ne patëm vetëm dy vizita", thoni ju, "gjatë luftës  
10 nga Shtabi i Përgjithshëm, në gusht dhe në tetor ..."

11 Tani, Dëshmitar, në intervistën tuaj me ZPS-në që ka  
12 numrin P1755.9 në faqen 3, ju keni folur edhe për një vizitë  
13 të tretë të Shtabit të Përgjithshëm në zonën e Llapit, e cila  
14 ka ndodhur në momentin kur u arrestuan tetë ushtarë serbë në  
15 zonën e Shalës. A e mbani mend këtë, Dëshmitar?

16 PË. Jo. Ndoshta është ndonjë keqkuptim. Unë e kam përmend  
17 kështu rastin e arrestimit të tetë ushtarëve serbë të Armatës  
18 së Popullit të Jugosllavisë që është quajt në atë kohë, por  
19 asnjëherë s'kam thënë që ata kanë vizitue zonën tonë. Ndoshta  
20 kanë vizitue zonën e Shalës. Mirëpo në kuadër të këtyre dy  
21 vizitave është bisedue lidhur me atë. Pasi që ka një  
22 koincidencë, domethënë, vizitën e tetorit, pra, jo gushtit po  
23 tetorit që ndoshta është bisedue lidhur me këtë.

24 Por, gjithsesi, nuk ka pas vizitë të tretë. Në Zonën  
25 Operative të Llapit ka pas gjithsej dy vizita nga Shtabi i

1 Përgjithshëm.

2 Pra dhe një herë, është ka mund të bisedohet lidhur me  
3 çështjen e arrestimit të ushtarëve të Armatës Popullore të  
4 Jugosllavisë nga zona, ushtarët e Zonës Operative të Shalës,  
5 por asesi nuk ka të bëjë me një vizitë të tretë të Shtabit të  
6 Përgjithshëm në Zonën Operative të llapit. Ndoshta një  
7 keqkuptim në deklaratë apo në bisedë.

8 PY. Në rregull. E sqarojmë.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shohim provën P1755.9. Ju lutem  
10 faqen 3 në të dyja gjuhët. Pjesa 9, pra, edhe një herë, bëhet  
11 fjalë për provën materiale që ka numrin P1755.9, është Pjesa 9  
12 e intervistës me ZPS-në. Faqen 3 në të dyja gjuhët.

13 PY. Dëshmitar, unë po lexoj nga anglishtja. Mund ta ndiqni  
14 nga shqipja nga rreshti 3 deri në rreshtin 21. I ke përpara në  
15 shqip. Unë po lexoj nga rreshti 8 e më poshtë në anglisht. Në  
16 këtë pjesë, Prokurori ju ka thënë, ju ka treguar një pjesë të  
17 librit të Skënder Zhitisë që ka lidhje me një vizitë të  
18 Shtabit të Përgjithshëm që ka ndodhur pas ofensivës, pas  
19 ofensivës së dhjetorit 1999. Po lexoj nga rreshti 8:

20 "Do t'i tregoj historinë ushtarake nga Skënder Zhitia, e  
21 cila flet për një vizitë të Shtabit të Përgjithshëm në zonën  
22 operative dhe thuhet se kjo vizitë ka ndodhur pas ofensivës  
23 serbe. Ofensiva që ka ndodhur nga data 24 deri në 27 dhjetor  
24 1998, ka qenë kjo beteja e Llapashticës, apo jo? A ju kujtohet  
25 një vizitë nga Shtabi i Përgjithshëm?"

1 Dhe ju jeni përgjigjur kështu:

2 "Përafërsisht, po. Por detajet i kam harruar."

3 Më pas, siç mund ta shihni dhe nga teksti, është  
4 përmendur dhe aty një listë e pjesëmarrësve në këtë vizitë dhe  
5 më pas ju është bërë sërish pyetje atë kujtohej vizita? Duhet  
6 të kalojmë tek faqja 4 tek anglishtja, tek shqipja rreshti 22,  
7 23, që ta kuptoni ku po lexojmë, Dëshmitar.

8 Pra, kur ua treguam këtë pjesë dhe të pyetëm a është e  
9 vërtetë kjo, a është e saktë. Dhe ti ke thënë:

10 "Po, mendoj se po. Tash po më kujtohet."

11 Të kujtohet tani, Dëshmitar? A ishte e saktë?

12 PË. Po unë po flas këtu ka të bëjë me, pra, ka të bëjë me  
13 betejën pas betejës jo të Llapashticës, po ka të bëjë pas  
14 betejës së Grykës së Kaçanollit që ka ndodh më 15 deri më 18  
15 shtator të vitit 1998. Atëhere ata, domethënë, Shtabi i  
16 Përgjithshëm më ka ardhë në tetor e asesi jo sikur kështu  
17 është përshkrue, pra, në nëntor, në dhjetor apo si përshkruhet  
18 beteja, ngase nuk ka pas vizitë të Shtabit të Përgjithshëm.

19 Mandej ju është referuar në paragrafin tjetër se lidhur  
20 me arrestimin. Ky arrestim i ushtarëve edhe normal këmbimi me  
21 pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kjo ka ndodh  
22 shumë më vonë. Pra, ndoshta kur ju kam referue "Po, më  
23 kujtohet", më kujtohet lidhur me arrestimin e tetë ushtarëve,  
24 pra, në Zonën Operative të Shalës, e asesi jo për një takim të  
25 tretë të Shtabi i Përgjithshëm.

1 Pra, këtu plotësisht jam i kjartë. Pra, ka ndodh dy  
2 vizita, vizita në, pra, në gusht dhe vizita në tetor. Nuk ka  
3 vizitë tjetër. Mirëpo çështje ndoshta e një keqkuptimi gjatë  
4 bisedës lidhur me këto dy çështje, çështjen e vizitës dhe  
5 çështjen e kësaj të kapjes apo arrestimit të tetë ushtarëve  
6 serbë, kjo ka ndodhë një kohë tjetër. Kështu që nuk ka, për  
7 atë dhe jam referue në kontekst të kohës --

8 PË. Në rregull.

9 PË. -- që nuk ka të bëjë.

10 Pra, dhe një herë, decidivisht jam i sigurtë ka dy  
11 vizita. Ka vizitë në gusht dhe ka një vizitë në tetor. Ndërsa  
12 kjo çka i referohet është krejt një kohë e mëvonshme. Pra, nuk  
13 ka dhe një vizitë të tretë.

14 PY. Po. Në rregull. Kështu, mesa ju kujtohet ju, kështu janë  
15 vetëm dy vizita domethënë?

16 PË. Po. Edhe kështu e kam thënë.

17 PY. Qartë. E kemi të qartë.

18 PË. Kam deklarue se s'ëm kujtohet, mirëpo saktësisht jam  
19 decidiv që ka pas dy vizita ka pas. S'ka pas vizitë të tretë

20 PY. E kam të qartë. E kam të qartë. Do kaloj në një fushë  
21 tjetër.

22 Avokati i z. Thaçi ju bëri pyetje për rolin që kishte  
23 Adem Demaçi dhe ju tregoi dhe një dokument "UÇK-ja, Shtabi i  
24 Përgjithshëm" i shkruar nga z. Jakup Krasniqi.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kjo është reflektuar në faqet



1 21148 deri në 21150 të transkriptit.

2 Do lutesha të shfaqej në ekran materiali me numrin  
3 SPOE00231037 deri në SPOE00231128 dhe përkthimi në anglisht që  
4 përfundon me -ET. Si fillim shohim ballinën, faqen e parë.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na jepni dhe  
6 një herë numrin, ju lutem.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po. SPOE00231037 deri në  
8 SPOE00231128. Mund ta merrni nga lista e materialeve që kemi  
9 përdorur ne gjatë pyetjeve tona dhe që është ngarkuar dje në  
10 sistem.

11 PY. Dëshmitar, kjo është thjesht ballina. Është një  
12 dorëshkrim. Mund të shihni dhe titullin këtu. Është  
13 sekuestruar prej Jakup Krasniqi kjo.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani unë dua të shohim një faqe  
15 të këtij dorëshkrimi i cili mban numrin SPOE00231107 në të  
16 dyja gjuhët.

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ky është një dorëshkrim i  
18 pabotuar. Është e qartë kjo dhe nga Legal Workflow që është  
19 një dorëshkrim i pabotuar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
21 Vazhdoni.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj disa pjesë të kësaj faqeje.

24 Pjesët që do t'ju lexoj unë kanë lidhje me rolin e Adem

25 Demaçit. Për të dhënë dhe periudhën kohore, bëhet fjalë për

1 periudhën shkurt 1999. Po lexoj qysh në fillim në faqes.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë tek  
3 shqipja.

4 PY. "Bacë Adem Demaçi në ato momente erdhi në Shtabin e  
5 Përgjithshëm."

6 Po shkoj në mes të paragrafit:

7 "Bacë Ademi nuk kishte raporte ushtarake dhe politike që  
8 kishim ne, sepse, natyrshëm, ai nuk ishte anëtarë i Shtabit të  
9 Përgjithshëm të UÇK-së."

10 Shkojmë më poshtë:

11 "Ai ka thënë se do të merrte pjesë në takimet e Shtabit  
12 të Përgjithshëm por ai nuk ishte anëtar i Shtabit të  
13 Përgjithshëm dhe ne nuk e ftonim, nga ata që i kishin dhënë  
14 atij detyrën të drejtonte zyrën politike të UÇK-së në  
15 Prishtinë. Pra, ky takim me bacë Ademin përfundoi por në asnjë  
16 mënyrë dhe kurrë nuk e humbëm respektin dhe për kontributin e  
17 çmueshëm që i kishte dhënë ai lëvizjes politike shqiptare,  
18 rolin në zyrën e UÇK-së në Prishtinë dhe përfshirjet e tija të  
19 singerta dhe të shumta në arenën politike të Kosovës."

20 Dëshmitar, ju keni thënë se keni pasur dijeni për mënyrën  
21 e strukturimit të UÇK-së në 1998 dhe 1999, kështu?

22 PË. Unë kam pas njohuri lidhur me strukturimin në kuadër të  
23 zonave, pra, ajo çka qenë forma, them, organogrami apo  
24 struktura organizative në nivel të zonave të brigadave. Nuk  
25 kam pas strukturim në nivelin e Shtabit të Përgjithshëm,

1 prandaj nuk mund të flas me kompetencë për këtë.

2 Pra, atë e keni pas parë edhe keni ju në dokumente  
3 çështjen e strukturimit të nivel të zonave operative,  
4 gjegjësisht, një herë nënzona mandej zona operative edhe  
5 brigadave. Por asesi jo edhe në nivel të Shtabit të  
6 Përgjithshëm, ngase kjo ka ndryshue në kontekst të kohës. Edhe  
7 mendoj edhe ky material, gjegjësisht, material pune, të them,  
8 apo sikur ka qenë pa përfunduar ky libër apo ky publikim dhe  
9 s'mund t'i referohem pasi nganjëherë pa dasht as të arsyetoj,  
10 as e kundërshtoj.

11 PY. Po, Dëshmitar.

12 PË. Pa dashtë me të -- mirëpo mendoj që në këtë formë nuk  
13 mund të komentoj diçka çka nuk e ka një formë përfundimtare ky  
14 material, gjegjësisht, kjo libër apo publikim i z. Jakup  
15 Krasniqi. Por prapë, kam dit ristrukturimin në nivel të  
16 nënzonave apo zonave --

17 PY. Dëshmitar. Dëshmitar.

18 PË. -- po edhe të brigadave. Po.

19 PY. Të bëra një pyetje, tjetër gjë doja të pyesja unë. Në  
20 fakt besoj se ju përgjigjët pyetjes dhe mjafton për  
21 procesverbal tani.

22 Tani po kaloj te pyetja e radhës: Kur i jeni përgjigjur  
23 Mbrojtjes së z. Thaçi - e cila është reflektuar në faqen 21150  
24 të transkriptit - ti i je drejtuar z. Adem Demaçi si  
25 përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm në Prishtinë, kështu?

1 PË. Po, ashtu është.

2 PY. Pjesa që unë sapo ju lexova nga kjo faqe për rolin e Adem  
3 Demaçit në Prishtinë, a përputhet kjo me atë që dinit ju për  
4 faktin që Adem Demaçi, sipas fjalëve tuaja, ka qenë  
5 përfaqësues dhe jo anëtar apo pjesë e Shtabit të Përgjithshëm,  
6 po përdor fjalët e avokatit që janë përdorur në Prishtinë?

7 Pra, ajo që unë ju lexova a përputhet me atë që dini ju  
8 për Adem Demaçin, pra, me fjalë të tjera që Adem Demaçi ka  
9 qenë përfaqësues dhe nuk ka qenë anëtar i Shtabit të  
10 Përgjithshëm në Prishtinë? Një përgjigje të shkurtër ju lutem.

11 PË. Unë e kam kuptuar në bazë të asaj çka kam pas njohuri dhe  
12 çkam njohuri që Adem Demaçi ka qenë zëfolës, a përfaqësues i  
13 Shtabit të Përgjithshëm në Prishtinë dhe ka përfaqësue  
14 interesat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe mendoj që ka  
15 qenë, sipas mendimit tim, që ka qenë anëtar i Shtabit të  
16 Përgjithshëm.

17 PY. Okej. Në rregull.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kërkoj që  
19 të pranohet dhe ballina dhe faqja që sapo diskutove me  
20 dëshmitarin si pjesë e provave gjyqësore, bëhet fjalë për  
21 faqet që mbajnë numrin SPOE00231107, në anglisht dhe në shqip,  
22 të cilat mund t'i bashkëngjiten provës P1091, e cila është një  
23 provë që përmban pjesë të këtij dorëshkrimi.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
25 kundërshtime?

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga znj. D'Ascoli

Faqe 37

1 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
2 pozicioni ynë është që ne jemi në një seancë publike.  
3 Dëshmitari e ka thënë se nuk e di se çfarë ka atje dhe nuk  
4 është në pozicion që të komentojë lidhur me përmbajtjen e  
5 këtij teksti.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
7 atëherë. Materiali SPOE00231037-00231128, bashkë me  
8 përkthimin, do të pranohet sepse është relevant, ka vlerë  
9 provuese dhe është autentik, në bazë të rregullës 138(1).

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kam nevojë për një  
11 sqarim. Do pranojmë të gjithë librin apo vetëm ballinën dhe  
12 faqen përkatëse?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Vetëm ballinën dhe këtë faqen  
14 konkrete.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë faqet  
16 kanë numrin SPOE00231037.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Do të  
18 marri numrin P01091.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]  
20 PY. Dëshmitar, pyetja e fundit. Gjatë kundërpvetjeve ju  
21 pyetën nëse kishit dijeni ju për raporte lidhur me  
22 bashkëpunëtorët që i janë dhënë Shtabit të Përgjithshëm nga  
23 zona e Llapit.

24 Meqë ke folur për këtë dhe në intervistën me ZPS-në dhe  
25 këtë pjesë të intervistës e përdori dhe Ekipi i Mbrojtjes,

1 unë tani do të doja t'ju lexoja përgjigjen e plotë që keni  
2 dhënë ju në këtë intervistë dhe ku jepni arsyet.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Unë do lexoj nga faqja 14,  
4 rreshtat 16 dhe 17 të anglishtes dhe faqja 11, rreshtat 21 dhe  
5 22 të shqipes.

6 PY. Pyetja ishte lidhur me informacionet dhe raportet lidhur  
7 me bashkëpunëtorët dhe nëse jepeshin raporte të tilla Shtabit  
8 të Përgjithshëm. Ju i keni thënë:

9 "Nuk kam informacione për këto, se ishte komandant i  
10 zonës përgjegjës për kontaktet me Shtabin e Përgjithshëm."

11 E konfirmoni këtë?

12 PË. Po. Kontakti, pra, i vetëm ishte apo mundësia që  
13 komandanti i zonës bënte përfaqësimin e nënzonës apo zonës në  
14 kuadër të Shtabit të Përgjithshëm edhe ajo qëndron.

15 PY. Në rregull. Faleminderit.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
18 Gjykatësi Barthe.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
20 Smith.

21 Pyetje nga Trupi Gjykses:

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe mirëmëngjesi, z. Ibishi.

23 PË. Mirëmëngjesi.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses ka disa pyetje  
25 për ju për të sqaruar disa nga aspektet për të cilat nuk jemi

1 tërësisht të sigurtë. E kuptoni këtë?

2 PË. Po ju ndëgjoj.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Ibishi, javën e kaluar, ti na the se u emërove si  
5 komandant i Brigadës 151 në Zonën Operative të Llapit në 18  
6 korrik 1998, dhe se të ka emëru Rrustem Mustafa që njihet  
7 ndryshe dhe si komandant Remi, kështu?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, kjo ka ndodhur disa  
10 javë pasi je kyçur në UÇK në qershor të 1998, kështu?

11 PË. Po, ashtu i bie.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju po ashtu keni thënë që  
13 emërimi u konfirmua më pas ose u miratua zyrtarisht nga Shtabi  
14 i Përgjithshëm i UÇK-së në gusht të 1998-s gjatë një vizite që  
15 kreu Shtabi i Përgjithshëm në zonën tuaj operative, saktë?

16 PË. E saktë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po ashtu ke  
18 thënë se z. Jakup Krasniqi ta ka dorëzuar vendimin që të bënte  
19 zyrtarisht komandant të Brigadës 151 dhe kjo ka ndodhur në  
20 praninë e komandant Remit dhe në praninë e zëvendësit të tij,  
21 Kadri Kastrati që njihet po ashtu si Daja, kështu?

22 PË. Ashtu është.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal, ky  
24 informacion mund të gjendet edhe në intervistën e Dëshmitarit  
25 W04758 me ZPS-në në nëntor 2019, përndryshe me numër P01755.1,

1 faqja 13.

2 Z. Ibishi, po ashtu ke thënë gjatë intervistës me ZPS-në  
3 - dhe e kam fjalën për provën me numër P01755.1, faqja 13 - se  
4 ti besojë se z. Krasniqi, pra, z. Jakup Krasniqi, aso kohe  
5 ishte zëdhënës i UÇK-së dhe se z. Krasniqi e shoqëronin disa  
6 persona të tjerë mes të cilëve Hashim Thaçi dhe Rexhep Selimi,  
7 kështu?

8 PË. Ashtu është.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ia konfirmojë z. Misetic  
10 nga Mbrojtja e z. Thaçi javën e kaluar dhe i keni thënë se ju  
11 e vetmja gjë që dinit ishte që z. Thaçi ishte një anëtar i  
12 Shtabit të Përgjithshëm, saktë?

13 PË. Ashtu kam mendu për kohën.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal, kjo mund  
15 të gjendet në faqen 21139 të transkriptit.

16 Z. Ibishi, tani unë kam këtë pyetje për ju: Nga e dinit  
17 ju këtë? Nga e dinit ju që z. Thaçi ishte anëtar i Shtabit të  
18 Përgjithshëm të UÇK-së?

19 PË. Po nuk e dijsa. Aty për aty na është njoftue para se të  
20 shkojmë në atë momentin e dorëzimit apo marrjes së vendimeve  
21 për emërim në poste, pra, ka të bëjë me emërimin e zotit  
22 zëvendëskomandantit të zonës, z. Kadri Kastrati, Daja, mue,  
23 Nuredin Ibishit, Leka edhe Idriz Shabanit, Luta, për komandant  
24 të Brigadës 152. Edhe nga aty thatë që është vizita, na  
25 njoftuan paraprakisht e një delegacioni, them, të Shtabit të



1 Përgjithshëm.

2 Nga të gjithë ata, unë njihja, them kështu, vetëm z.  
3 Jakup Krasniqi. Kjo është e saktë. Ngase ai kishte paraqitje  
4 mediatike në kuptim të promovimit të Ushtrisë Çlirimtare të  
5 Kosovës dhe si zëdhënës apo zëfolës edhe nga ajo ishte në  
6 media të ndryshme. Dhe nga ato kontakte, gjegjësisht, në ato  
7 shqime, pra, nga aspekti mediatik, them më shumë, e kam njoft  
8 si figurë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime e  
10 radhës është kjo: Kush ua ka thënë këtë gjë? Kush ua ka thënë  
11 këtë përpara takimit se do të takoheshit me anëtarë të Shtabit  
12 të Përgjithshëm mes të cilëve dhe me z. Thaçi?

13 PË. Po ne ishim në fazës e ngritjes së kapaciteteve, të  
14 trajnimeve të ushtarëve, organizimeve të brendshme dhe kur u  
15 ftuam të tretë, atëherë na njoftuan lidhur me këtë. Nuk më  
16 kujtohet saktësisht kush na ka thënë këtë, mirëpo dikush nga  
17 ata që na ka bërë ftesën, pasi që komanda ishte aty në afërsi,  
18 komanda e zonës. Edhe në takim mund të presupozojsha përveç  
19 aty stafit që ishte i njohur, komandant Remi e disa të tjerë,  
20 që e dijsa që nga ata mysafirë ishte si e njofsha Jakup  
21 Krasniqin. Edhe disa tjerë vetëm në bazë të njoftimit  
22 presupozoja se janë të Shtabit të Përgjithshëm ashtu sikur na  
23 thanë njoftimin apo ftesën për të ardhur në takim.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjithashtu a e dinit ju nëse  
25 z. Selimi ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm? A ju kanë

1 thënë nëse dhe ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm?

2 PË. Mendimi im i kohës është, domethënë, që të gjithë ishin  
3 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, s'mue të veçoja ndokënd  
4 prej atyre ashtu sikur u tha, nuk mund tash në formë separatë  
5 të them ky apo ai ngase nga ata njofsha vetëm Jakup Krasniqin.  
6 Për atë po them.

7 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar, po shikojmë  
8 faqen 37 dhe rreshtin 8 dhe besojmë që ka një gabim në  
9 procesverbal në transkriptin. Na thanë që -- aty thuhet:  
10 "Na është thënë ..."

11 Po në fakt dëshmitari tha që:

12 "Mendoj që të tjerët ishin nga Shtabi i Përgjithshëm".

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ndoshta mund ta pyesim  
14 dëshmitarin nëse dëshiron që ta rregullojë procesverbalin.

15 Jua kanë thënë apo e keni prezumuar, keni menduar ju që  
16 të tjerët ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm?

17 PË. Neve na kanë thënë se janë anëtarë të Shtabit të  
18 Përgjithshëm. Po unë kam prezumuar në kuptim të asaj që përveç  
19 Jakup Krasniqit mund të jenë edhe të tjerë anëtarë të Shtabit  
20 të Përgjithshëm.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

22 Faleminderit, znj. Alagendra, që e ngritët këtë çështje  
23 me ne.

24 Z. Ibishi, a dinit se cili ka qenë funksioni ose roli i  
25 Rexhep Selimit brenda Shtabit të Përgjithshëm, a kishte në

1 fakt një rol apo pozicion?

2 PË. Për kohën, për kohën nuk e kam ditur, më vonë e kam  
3 kuptuar, shumë vonë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe si e dini tani, si e  
5 keni kuptuar rolin e tij ose funksionin brenda Shtabit të  
6 Përgjithshëm të UÇK-së cili ka qenë ai në 1998? Ose më saktë,  
7 kur jeni takuar me të në gusht të 1998?

8 PË. Mund të them nga asnjë nga ata, në kuptim po ndaj mendjen  
9 ato çka kam dit për kohën edhe ato çka kam mësu më vonë.

10 Për momentin absolutisht s'kam pas kurrfarë njohurie,  
11 përveç Jakup Krasniqit edhe, normal, më vonë edhe Bislim  
12 Zyrapit që ka qenë në aspektin, në aspektin si përfaqësues, të  
13 them, ashtu shef shtabi më tepër për aspekte ushtarake. Aty i  
14 referohem dhe takimit edhe të dytë. Pra, takimit të dytë i  
15 referohem më shumë për Bislim Zyrapin, pra, në takimit të  
16 tetorit, jo të gushtit.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk e di nëse e kuptuat  
18 pyetjen time. Pra, pyetja ime ishte kjo: Tani si e dini ju  
19 cili ka qenë roli i z. Selimi në gusht të 1998 kur jeni takuar  
20 me të?

21 PË. Nuk e di. Nuk e kam ditur.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ende nuk e dini se çfarë  
23 roli apo funksioni ka patur brenda për brenda Shtabit të  
24 Përgjithshëm të UÇK-së në gusht të 1998, këtë po na thoni?

25 PË. Unë më vonë, për më vonë kam kuptuar se ai mund të ketë

1 qenë, po kjo është më vonë, të kuptuarit më vonë, mos tani me  
2 kohën, që ai ka qenë shef i inspeksionit, sa kam dëgjue.  
3 Mirëpo tash nuk e di a ka vlejti ajo në kohën e takimit tonë të  
4 parë apo të dytin. Mirëpo më vonë kam kuptue edhe tash nuk  
5 mund të vejë veten në siklet ta di saktësisht emërimin e tija.  
6 Ka qenë ai i emëruar në atë kohë shef i inspeksionit apo në  
7 1998 apo ka mund të ndodhë dhe muaj apo kohë më vonë. Pra, nuk  
8 muj t'i referohem saktësisht. Por më vonë kam mësue se ka qenë  
9 shef i inspeksionit, por pa ju referue kohës.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani dëshiroj  
11 të kalojmë tek një çështje tjetër.

12 Z. Ibishi, gjatë dëshmisë që dhatë javën e shkuar ju  
13 përmendët disa herë ndryshimin e emrave të Brigadave 151 dhe  
14 152. Besoj e mbani mend këtë apo jo?

15 PË. Gjithsesi se isha pjesë e saj.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Sipas  
17 paragrafit numër 67 të Shënimit Përgatitor numër 2, ju i keni  
18 thënë ZPS-së gjatë seancës përgatitore, që ka ndodhur dikur në  
19 nëntor ose dhjetor të 1998 kur numrat ose emrat e brigadave u  
20 ndryshuan dhe 151 Brigada u bë Brigada 152, është e saktë kjo?  
21 PË. E saktë është.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju keni qenë në atë kohë  
23 ende komandant brigade apo ishit emëruar si shef shtabi i  
24 zonës së Llapit kur u ndryshuan emrat e dy brigadave?

25 PË. Mendoj që ka qenë aty në kufi, domethënë, mund të jetë

1 ngase unë isha dhe kryes, ushtrues i detyrës dhe shefit të  
2 operativës së bashku me zëvendëskomandantin Kadri Kastrati,  
3 pra, më herët. Dhe emërimi apo ndryshimi i emërimit ka ndodh  
4 për shkak të pozicionimit në vijën e parë të frontit, pra, në  
5 pjesën perëndimore të magjistrales Prishtinë-Merdare në kufi  
6 të Serbisë.

7 Edhe për shkak dhe të pozicionimit ka ardh deri tek  
8 ndryshimi i emrave, gjegjësisht numërimit të brigadave edhe  
9 aty ka ardh ndryshimi 151 është bë 152, vetëm me ndryshim të  
10 emërimit po jo edhe ndryshim personelit. Kështu që arsyeja ka  
11 qenë pozicionimi në fortifikatat në vijën e parë të frontit,  
12 them, pozicionet e vijës së parë të fronti që fillon numërimi  
13 nga e majta në të djathtë edhe për këtë arsye fillon 151, 152.

14 Dhe nga kjo arsye është bë, pra, vetëm ndryshimi i  
15 emërimit në renditje. Asgjë s'ka ndryshuar në strukturë të  
16 organizimit të brendshëm të brigadave. Vetëm janë ndryshue emri  
17 151 Zahir Pajaziti, pra, në 152 Shaban Shala, vetëm janë  
18 ndryshue emrat pa ndryshim të emërimit për shkak të  
19 vetpozicionimit.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk e di nëse arrita ta  
21 kuptoja plotësisht përgjigjen tuaj. Por pyetja ime ishte: A  
22 keni qenë në atë kohë komandant brigade apo ishit promovuar të  
23 themi, ishit rritur në detyrë, emëruar shef i shtabit të zonës  
24 në atë kohë?

25 PË. Mendoj se ka ko incidencë në atë kohë kur ka ardh deri tek

1 ky ndryshim, pasi që për afërsisht ka ndodhë edhe pozicionimi  
2 në vijën e parë të frontit. Arsyeja e së cilës ka ardh dhe te  
3 ndryshimi i emërimit të brigadave.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Ibishi, kush e vendosi që  
5 të dy brigadat duhet të ndërronin emrat?

6 PË. Pra, ishte propozimi i ushtruesve të detyrave, pra,  
7 shefit të operativës, në këtë rast Kadri Kastratit, Dajës edhe  
8 mue si bashkëkryes në këtë detyrë të shefit të sektorit të  
9 operativës. Pra, i ofruar komandës së zonës dhe komanda e  
10 zonës dhe bashkë me komandantin morën vendim për këtë ndryshim  
11 të emërimit të brigadave apo ndryshimit të emërimit të  
12 brigadave.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju sapo thatë që ne e  
14 morëm vendimin për të ndryshuar emrat, pra, ishte vendimi i  
15 komandant Remit, Kadri Kastratit dhe ju personalisht apo ishte  
16 thjesht një vendim që u mor nga komandant Remi si komandant i  
17 zonës operative?

18 PË. Jo. Propozimi ishte nga komandant Daja, Kadri Kastrati  
19 edhe unë, si bashkëkryes të shefit të sektorit të operativës.  
20 Për shkak të strukturimit brigada i propozon komandës dhe  
21 komandant Remit që të bëjë ndryshimin, pra, ndryshimin në  
22 emërimin e brigadave. Edhe ata morën vendim për këtë,  
23 gjegjësisht, komandant Remi mori.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe Shtabi i  
25 Përgjithshëm i UÇK-së ka qenë i përfshirë në këtë vendim? Për

1 shembull, vendimi a është vërtetuar, konfirmuar më vonë,  
2 miratuar nga Shtabi i Përgjithshëm?

3 PË. Nuk kam njohuri.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po a dini nëse, ju vetë, a e  
5 keni njoftuar Shtabin e Përgjithshëm ose dini nëse dikush  
6 tjetër e ka njoftuar Shtabin e Përgjithshëm pas marrjes së  
7 këtij vendimi?

8 PË. Nuk kam njoftim. Kjo ka ndodh sikur rastin e parë të  
9 emërimit, pra, nga niveli i komandës së zonës, gjegjësisht,  
10 komandantit të zonës. Edhe nuk di në raport pasi që nuk kam  
11 pas kontakte direkte me Shtabin e Përgjithshëm. Vërtetë, jo  
12 kontakte, po s'kam qenë përgjegjës për kontakte me Shtabin e  
13 Përgjithshëm edhe për këtë arsye nuk ka njohur lidhur me atë  
14 se a kanë qenë të njoftuar lidhur me këtë emërim. *De facto* unë  
15 kam qenë i emëruar nga komanda, gjegjësisht, komandanti i  
16 zonës për shef të shtabit. Nuk kam njohuri se çfarë roli ka  
17 pas Shtabi i Përgjithshëm.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë më herët gjatë  
19 dëshmisë tuaj këtu në sallë që komandant Remi ka qenë në  
20 kontakt me Shtabin e Përgjithshëm. Po ai a do të kishte  
21 përgjegjësi për informimin e Shtabit të Përgjithshëm për  
22 ndryshimin e emërimit ose numrave të këtyre brigadave?

23 PË. Mendoj se po. Dhe ai është dashtë ta informojë Shtabin e  
24 Përgjithshëm për këto emërimë. Po realiteti është që unë nuk  
25 kam marrë një vendim formal për këtë përveç emërimit nga

1 komandanti i Zonës Operative të Llapit, Remit edhe komandës të  
2 zonës.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Ibishi, përpara se të kaloj tek pyetja tjetër, a mund  
5 t'i kërkoj Sekretarit të seancës që në ekran të vendosë provën  
6 materiale P01765. Dhe duhet përdorur versioni i rishikuar, më  
7 i fundit i rishikuar që në fakt u pranua nga Trupi Gjykses sot  
8 dhe të dyja versionet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën  
9 angleze.

10 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës  
11 këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë  
13 tani pushimin prej gjysmë ore, sepse nuk jemi fort të qartë  
14 për [Mikrofoni çaktivizuar]. Do të rikthehemi në orën 11.25.

15 Dëshmitar, mund të largoheni nga salla dhe do të bëjmë  
16 një pushim prej gjysmë ore.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
19 rifillojmë në orën 11. 25.

20 --- Pauza fillon në orën 10.55

21 --- Seanca rifillon në orën 11.26

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
23 sillni dëshmitarin në sallë.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do



1 vazhdojmë tani me pyetjet e Gjykatësit Barthe.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirë se u ktheve, z. Ibishi.  
3 PË. Faleminderit.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani i kemi në ekran të dyja  
5 versionet e dokumentit. Ky dokument, z. Ibishi, ka të bëjë me  
6 formacionin e komandës së brigadës së UÇK-së, dhe në mes të  
7 faqes përmendet edhe seksioni, sektori, më falni, i zbulim dhe  
8 kundërzbulimit. E shihni?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pranë brigadës tuaj keni  
11 pasur një sektor të tillë?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] I lutem Sekretarit të  
14 seancës të na kalojë tani në faqen me numër 123666 [Sipas  
15 përkthimit] -- 1232666 [Sipas përkthimit].

16 Z. Ibishi, kjo organigramë, është organigrama e brigadës  
17 tuaj, apo jo, 151?

18 PË. Po, me ndryshimet e mandej që kanë ndodh në kontekst të  
19 kohës. Ngase ky organogram është punue pas lufte, pasi që ka  
20 pas çdoherë ndryshime në aspektin e ardhjes apo emërimit të  
21 kuadrove në kuadër të strukturës organizative. Edhe kështu që  
22 janë këtu, në fusnota të caktuar disa ndryshime që konform  
23 kohës kanë ardh deri te ndryshimi për shkak të largesës, por  
24 edhe për çështje të tjera që janë të caktuara këtu në fund të  
25 organogramës në tekstin me shkrim.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.  
2 Edhe në këtë organigramë dikund të faqes [Sipas përkthimit]  
3 përmendet një person, Xhavit Halimi, e shihni z. Ibishi? Sabit  
4 Rrahimi, më falni, e shihni?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sabit Rrahimi, a ka qenë  
7 shef i sektorit të zbulim-kundërzbulimit në brigadën tuaj --

8 PË. Po --

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- siç thuhet në këtë  
10 organigram?

11 PË. -- po, ka qenë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kush e ka  
13 emëruar z. Rrahimi?

14 PË. Po ai është emëruar nga niveli i komandës së zonës. Edhe,  
15 normal, në, me siguri në propozim të caktuar të sektorit të,  
16 pra, në nivel të, pra, zonës.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini kur, kur është  
18 emëruar z. Rrahimi si shef i zbulimit dhe kundërzbulimit në  
19 brigadën tuaj?

20 PË. Po, s'jam i sigurt, në kontekst të kohës. Po ajo mund të  
21 jetë dikund tetor, nëntor, s'jam i sigurt. Por mund të jetë në  
22 atë kohë, të 1998.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po Shtabi i  
24 Përgjithshëm, keni dijeni, ka qenë i përfshirë në këtë  
25 vendimmarrje, dhe nëse po, në ç'mënyrë?

1 PË. Sa kam njohuri, jo, nuk ka qenë i përfshirë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, vendimi për të emëruar  
3 z. Rrahimi si shef të zbulimit dhe kundërzbulimit është marrë  
4 prej komandant -- që është marrë prej komandës së zonë  
5 operative nuk është konfirmuar apo miratuar më pas nga Shtabi  
6 i Përgjithshëm, me sa keni ju dijeni?

7 PË. Unë sa kam dijeni, jo. Pra, ju keni dokumente të shumtë  
8 lidhur me propozimin për emërimet të caktuara në nivel të  
9 brigadave. Ato kanë shkuar në kuadër të zonave, autoriteteve  
10 të zonës, zonave operative, përveç normal, nivelit të  
11 komandantëve të brigadave dhe më lart. Për këtë arsye mendoj  
12 që kjo ka qenë çështje e autoriteteve në nivel të zonave dhe  
13 sektorëve të caktuar.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, e kuptoj.

15 I lutem Sekretarit të seancës që të shkojmë në faqen  
16 pararendëse, në faqen me numër 123265.

17 Z. Ibishi, kjo është një organigramë e zonës operative të  
18 Llapit, këtu përmendeni edhe ju në cilësinë e shefit të  
19 shtabit. Edhe këtu, në të majtë përmendet Latif Gashi,  
20 përndryshe Lata, si shef i shërbimit informativ, thuhet këtu.  
21 Ose përndryshe J-2, në nivel zone. E sheh?

22 PË. Po, e shof.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A është e saktë kjo  
24 organigramë? A ka qenë z. Latif Gashi shef i drejtorisë,  
25 sektorit informativ në zonën e Llapit?

1 PË. Po. Kjo ka qenë dhe pse ka të bëjë me material pune,  
2 gjegjësisht, kjo strukturë organizative, apo organogramë, ka  
3 qenë, pra, të them, si dokument punues, nuk ka qenë definitiv.  
4 Por realiteti është që z. Latif Gashi ka qenë, pra, udhëheqës  
5 i sektorit të, pra, të shërbimit informativ. Megjithëse këtu  
6 pak ka ndryshim mes organogramës për të cilën kemi diskutu  
7 edhe në, pra, me Prokurorin, në fazën preliminare, mes  
8 definimit se si u përkthye këtu në gjuhën anglisht, pra, si  
9 sektor i shërbimit të inteligjencës. Edhe këtu si është në  
10 origjinal, që ka të bëjë sektori i shërbimit informativ.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çështje terminologjie thoni,  
12 apo ka një dallim? Ka dallim mes shërbimit informativ dhe  
13 shërbimit të inteligjencës?

14 PË. Unë po them në aspektin e përkthimit të -- të pastër,  
15 gjuhësor. E në aspektin përfaqësor [fonetiki] është për t'u  
16 diskutuar, s'kam ndonjë qasje të veçantë, por unë po i  
17 referohem vetëm qasjes gjuhësore të përkthimit.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime është kjo: z.  
19 Latif Gashi a merrej me çështjet e zbulim-kundërzbulimit apo  
20 jo, merrej me marrëdhëniet me publikun? Apo ndonjë detyrë  
21 tjetër?

22 PË. Për atë po them, në gjuhë shqipe kemi dy përkufizime, që  
23 mund të, nëse shkoni në pjesën tjetër, pra, është për afërsisht  
24 një, ekuivalencë e njëjtë e aspektit gjuhësor mes sektorit, i  
25 shërbimit informativ, dhe sektori i, pra, i informimit. Që

1 substancialisht janë të, çështje të ndryshme. Unë tash po i  
2 referohem organogramës në origjinal edhe çështjes së  
3 përkthimit.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Ibishi, të enjten e javës  
5 së kaluar, ju konfirmuat se z. Gashi ishte emëruar prej  
6 komandant Remit qysh në korrik të 1998, a është kjo e saktë?

7 Kjo për procesverbal është në faqen 21186 dhe 7 të  
8 transkriptit. Këtë e keni thënë gjatë pyetjeve që ju ka bërë  
9 Mbrojtja e z. Thaçi, kështu ka qenë?  
10 PË. Po, ashtu ka qenë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me sa dini ju, Shtabi i  
12 Përgjithshëm ka qenë i përfshirë në këtë vendim, pra në  
13 vendimin për ta emëruar z. Gashi si shef të sektorit të  
14 zbulimit ose të J-2, siç është këtu, në zonën operative të  
15 Llapit. Dhe nëse po, si ka ndodhur? Tani, pse po ju pyes unë?  
16 Po ju pyes sepse shefi i zbulim-kundërzbulimit është i  
17 rëndësishëm jo vetëm për zonën e llapit, por për të gjithë  
18 Kosovën. Sepse i interesonte, do t'i interesonte shumë Shtabit  
19 të Përgjithshëm të dinte kush do të ishte përgjegjës për një  
20 detyrë të tillë.

21 Pra, ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i përfshirë në  
22 emërimin e z. Gashi si shef të shërbimit informativ apo të  
23 shërbimit të zbulimit, J-2

24 PË. Edhe pse kjo s'ka qenë kompetencë e imja, nga pozita që  
25 kam ushtruar, por sa kam njohuri kjo nuk ka pas lidhje me, sa

1 kam njohuri, pra, të përgjithshme, që kjo është caktuar në  
2 kuadër të zonës dhe nuk ka pas interferim me Shtabin e  
3 Përgjithshëm. Pra kufizohem me atë që nuk kam njohuri.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

5 Tani do kaloj në një temë tjetër. Z. Ibishi, javën e  
6 kaluar përshkruat rolin e të ashtuquajturës mbrojtje civile  
7 për identifikimin e bashkëpunëtorëve, dhe ju thatë si në  
8 vijim. Kjo gjendet për palët në materialin me numër 21114,  
9 21115 të transkriptit. Dhe unë po ju lexoj nga transkripti.

10 "Në kuadër të detyrimeve të zonës operative të Llapit dhe  
11 mbrojtjes së civilëve në zonë ne kishim për detyrë, e kishim  
12 përgjegjësi që t'i mbronim nga kolaboracionistët e armikut,  
13 sepse në vitet 1990 shërbimi informativ dhe policia serbe  
14 krijuan një rrjet kolaboracionistësh. Për këtë arsye, vendimi  
15 u mor që në kuadër të mbrojtjes civile, dhe me kërkesën e  
16 tyre, sa u takon disa personave që bashkëpunonin me serbët, me  
17 strukturat pushtuese serbe, apo forcat serbe, dhe u  
18 identifikuan disa persona, dhe procedura ishte e atillë që të  
19 kalonte përmes komandantit të brigadës, policisë ushtarake, e  
20 deri në qendrën e ndalimit në Llapashticë.

21 "Kjo ka qenë procedura kur ekzistonin arsye për të  
22 dyshuar për persona të caktuar."

23 Tani, unë kam këtë pyetje për ju, z. Ibishi, nëse e dini  
24 a mund të na e shpjegoni dhe një herë çfarë roli ka pasur  
25 sektori i zbulimit dhe i kundërzbulimit në nivel zone dhe

1 brigade? A bashkëpunonin ata me mbrojtjen civile për të  
2 identifikuar kolaboracionistët?  
3 PË. Po gjithsesi, ky ka pas atë rol. Por në veçanti policia  
4 ushtarake që gjithashtu ka qenë në kuadër të brigadave, por  
5 edhe në kuadër të zonës operative të Llapit, pra, në kuadër të  
6 brigadave, por të zonës operative të Llapit. Edhe ata kanë pas  
7 bashkëpunim të vazhdueshëm me mbrojtjen civile, një strukturë  
8 për të cilën është specifike e zonës operative të Llapit nga  
9 se ajo është funksionalizue me kohë.

10 Me qëllim që ajo t'i përgjigjet si pjesë strukturale,  
11 pra, edhe si sektor i veçantë, detyrave, pra, në mbrojtjen  
12 civile në kuadër të lokaliteteve, pra, të fshatrave, por edhe  
13 pjesëve urbane, edhe që në një formë ngritshin shqetësimet  
14 edhe për aspektin e sigurisë së, pra, edhe misionit të  
15 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe interesat e  
16 popullatës civile. Pra, siç ne si palë ndërluftuese kishim  
17 edhe një mandat të kujdesemi për këtë, mu për shkak që  
18 kontrollonin një pjesë të territorit të operacioneve tona në  
19 këtë zonë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Ibishi, kam  
21 edhe disa pyetje për organigramat edhe provën materiale me  
22 numër P10765.

23 I lutem Sekretarit të seancës që të shohim faqen 12326 --  
24 Meqë përmendët policinë ushtarake, z. Ibishi, në  
25 organigramën e, në këtë faqe, diku në fund është një shënim që

1 thotë: Nazif Mehmeti ka qenë komandant i policisë ushtarake në  
2 nivel zone. E shihni?

3 PË. Po. Nazif Mehmeti ka qenë ushtrues i detyrës së  
4 komandantit. Por, realisht s'ka pas të them emërimin si  
5 zëvendëskomandant. Mirëpo, në mungesë të komandantit ai ka  
6 ushtruar, pra, detyrën e komandantit të policisë ushtarake në  
7 nivel të zonës operative të Llapit.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kush e emëroi  
9 z. Mehmeti?

10 PË. Po sikur që ka ndodh, emërimet në kuadër të, pra, të  
11 niveleve edhe të brigadave, pra, në kuadër të strukturës  
12 organizative të brigadave, por edhe njësitë kështu të,  
13 konstituive, në kuadër të zonës, kjo ka shku me propozim, pra,  
14 në komandën e zonës. Edhe komandanti i zonës ka emëruar, pra,  
15 në postin e zëvendëskomandantit, gjegjësisht kryesi i detyrës  
16 së komandantit, z. Nazif Mehmeti, ngase e ka pas një shkollim,  
17 pra, adekuat, por edhe njëkohësisht edhe një, pra, një  
18 eksperiencë, pra, dhe karrierës në polici, policinë civile të  
19 kohës.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini kur është emëruar  
21 z. Mehmeti? Me përfaqësi.

22 PË. Mendoj që është dikund kah fundi, kah pjesa e fundit të  
23 vitit, a mund të jetë nëntor apo dhjetor, nëntor më duket, i  
24 vitit 1998. Nëse nuk gaboju. Kufizohem pak, siç dhe ka kalu  
25 kohë e gjatë, vështirë t'i kujtoj këto.



1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të njëjtën pyetje si më  
2 përpara. Ky vendim u konfirmua apo u miratua nga Shtabi i  
3 Përgjithshëm, me sa keni ju dijeni?

4 PË. Nuk kam dijeni për këtë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka problem.

6 I lutem Sekretarit të seancës të kthehemi edhe një herë  
7 në faqen me numër 123266.

8 Poshtë, majtas, në organigramë thuhet që komandant i  
9 policisë ushtarake për Brigadën 151 ka qenë Naip Gjubetini.  
10 Naip Gjubetini, kështu ka qenë? Z. Ibishi, Naim Gubetini ka  
11 qenë komandanti i policisë në brigadën tuaj?

12 PË. Po. Naip Gubetini.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam të njëjtën pyetje si më  
14 përpara. Kush e emëroi, dhe kur është emëruar nëse e dini?

15 PË. Por sikur është dhe procedura të tjera për të cilët janë  
16 dokumentat relevantë në procedurat e emërimeve në kuadër të  
17 brigadave, pra, në batalione edhe ma poshtë, edhe kjo i ka  
18 shkue në propozim, pra, komandës së zonës, pra, edhe në atë  
19 drejtim duke u konsultuar, normal, me, edhe me policinë  
20 ushtarake, dhe kështu që ky vendim është marrë në nivel të  
21 komandës së zonës.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ky vendim është konfirmuar  
23 apo miratuar nga Shtabi i Përgjithshëm apo jo?

24 PË. Nuk kam njohuri për këtë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

1 Kalojmë në një temë tjetër që është trajtuar edhe sot nga  
2 Prokurori, nga Prokurorja, më falni. Gjatë pyetjeve që ju ka  
3 bërë Mbrojtja e Thaçit, që është e reflektuar në faqen 21150  
4 të transkriptit, ju thatë që Adem Demaçi, që ju e keni quajtur  
5 simbol të rezistencës, për përkushtimin që i ka dhënë Kosovës,  
6 ju ka vizituar, ju ka mbështetur dhe ju ka inkurajuar kur ka  
7 ardhur t'ju takojë në zonën operative të Llapit. Ju kujtohet  
8 që ta keni thënë këtë edhe javën e kaluar, por edhe sot?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Ibishi, do të donim të na  
11 thonit sa herë ju ka vizituar z. Demaçi në zonën operative të  
12 Llapit ose sa herë e keni takuar apo keni biseduar me të?

13 PË. Shumë herë. Ai na ka vizitu edhe në kuadër të brigadave,  
14 edhe në kuadër të zonave, të zonës, të vërtetë, edhe, normal,  
15 në raste të ndryshme në kërkesat. Na ka inkurajue gjatë, pas  
16 betejave, edhe, normal, na ka ftue, çdo herë ka qenë pranë  
17 nesh një personalitet i veçantë që unë me shumë respekt e  
18 konsideratë, jo vetëm unë, por gjithë pjesëtarët e Ushtrisë  
19 Çlirimtare të Kosovës, kemi pas një konsideratë të veçantë.

20 Kështu që nuk mund me saktësi t'i kujtoj takimet me të.  
21 Ka pas prej takimeve personale me të, në kuadër të brigadës,  
22 mandej në nivel të zonës ku kemi bisedu për çështje të  
23 caktuara, edhe për çështje të veçanta, me rastin e vizitës së  
24 Shefit të KDOM-it të OSBE-së, z. Shaun Byrnes, një vizitë,  
25 pra, në zonën tonë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju sapo konfirmuat që z.  
2 Demaçi ju ka inkurajuar dhe ju ka mbështetur. Tani unë kam  
3 këtë pyetje. Konkretisht, si ju ka mbështetur dhe si ju ka  
4 inkurajuar, çfarë ka bërë?  
5 PË. Na ka inkurajuar në kuptimin e një qëndresës së  
6 vazhdueshme për të jem, të kem qëndrueshmëri, ngase kjo luftë  
7 do të ketë, do të zgjatë. Të jem të kujdesshëm në të gjitha  
8 aspektet. Edhe, normal, që në çështje, pra, të tjera që ka të  
9 bëjnë edhe me pra, misionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,  
10 por edhe në raport me ndërkombëtarët, ngase ai ishte përherë  
11 në lëvizje. Ishte në të gjitha zonat, ishte edhe me  
12 misionarët, por njëkohësisht ishte dhe zëfolës në kryeqytetin  
13 e Kosovës, Prishtinën, ku dilte me deklarata lidhur me  
14 gjendjen e sigurisë gjegjësisht apo operacionet luftarake, por  
15 njëkohësisht edhe rreziqet e tij që ballafaqohej nga  
16 postbllloqet serbe, disa herë që unë vetë i kam përgjuar, duke  
17 u kërcënuar atje direkt edhe me likvidim. Mendoj që ai ka qenë  
18 një personalitet jo vetëm përkrahës, por njëkohësisht ka  
19 rreziku jetën e vet me qëllim të mbarëvajtjes së misionit të  
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Ibishi.

22 Përveçse ju ka inkurajuar dhe ju ka mbështetur, z. Demaçi  
23 ju personalisht apo ushtarëve të tjerë, u ka dhënë ndonjë  
24 urdhër apo direktivë, për shembull, të sulmonit ose të mos  
25 sulmonit një vend të caktuar.

1 PË. Jo. Përkrahja ka qenë më tepër morale, të them kështu,  
2 mbështetëse edhe në bazë autoritetit të tij që është thënë [E  
3 pakuptueshme]. Por në aspektin ushtarak mendoj, ai na  
4 inkurajonte mua nga ajo se kishim në zonën tonë sadopak një  
5 kuadër dhe një performancë profesionale që, një formë nuk  
6 donte të interferonte shumë në çështjen e operacioneve  
7 luftarake. Por çdo herë na thirrte në qëndrueshmëri edhe në  
8 moral, pra, të lartë me qëllim që të jem të qëndrueshëm deri  
9 në fund të luftës tonë të drejtë për çlirimin e Kosovës.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kam ende disa  
11 pyetje për ju, z. Ibishi.

12 Pyetja ime e radhës është kjo: Gjatë pyetjeve që ju bëri  
13 Mbrojtja e Thaçit javën e kaluar, në faqen 21169 të  
14 transkriptit, Avokati ju bëri këto pyetje, dhe unë po e citoj,  
15 pyetje:

16 "... i keni thënë ZPS-së javën e kaluar se ai", bëhet  
17 fjalë për komandantin e zonës, ai, komandant Remit, domethënë,  
18 "me autoritet përfundimtar, të plotë, çka do të thotë se ishte  
19 personi me nivelin më të lartë që mund të merrte vendime për  
20 lirime apo amnisti?"

21 Dhe sipas transkriptit, ju keni thënë:

22 "Kështu ka qenë. Pozicioni i tij e kishte këtë autoritet.  
23 E kishte këtë autoritet si komandant zone."

24 Z. Ibishi, a mund të na shpjegoni çfarë keni dash të  
25 thoni ju me këtë? Për shembull, a keni dash të thoni ju që

1 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk kishte fare të drejtë fjale  
2 në lirimin apo arrestimin e kolaboracionistëve? Në qoftë se  
3 Shtabi i Përgjithshëm do të kishte thënë komandant Remit ta  
4 lironte një person që dyshohej se bashkëpunonte me armikun,  
5 komandant Remi a mund t'u thoshte edhe jo?

6 PË. Unë thashë s'mund ta interpretoj, apo se si do të -- do  
7 t'i referohej në këtë kërkesë komandant Remi, ngase është  
8 pozita e tij, por mendoj që, pra, komandant Remi çdo herë me  
9 marrjen e vendimet është konsultuar me komandën e zonës, për  
10 vendime të caktuara, edhe, normal, ka marrë vendimin krahas  
11 vlerësimit tonë edhe, normal, të sektorëve të ndryshëm për  
12 vendime të caktuara, pra, në këtë rast sikur që përmendet edhe  
13 në lirimin e personave.

14 Unë tash nuk muj nga pozita e tij ta interpretoj  
15 qëndrimin se çfarë ai do të kishte marrë në kuptim të, pra,  
16 një kërkesë të veçuar për lirim apo për një arrestim, për një  
17 lirim, sikur që thatë, nga Shtabi i Përgjithshëm.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po sikur Shtabi i  
19 Përgjithshëm, shprehimisht t'i thoshte Remit të mos e lironte  
20 një person? Komandant Remi, sidoqoftë, mund t'i jepte amnisti  
21 këtij personi dhe ta lironte?

22 PË. Po Remi tash prapë nuk dua ta interpretoj, por them nga  
23 pozita ime, ai është konsultue me komandën e zonës, edhe,  
24 normal, ka marrë vendime të ashtu çfarë ai ka pa në  
25 kompetencën e tij. Në kuptim të asaj që [E pakuptueshme] ka bë

1 në harmoni të vlerësimit të situatës edhe besoj që edhe në  
2 këtë rast do të marrte vendimin adekvat për çështjen e  
3 caktuar, në kërkesën e Shtabit të Përgjithshëm për të cilën  
4 nuk prejudikoj një vendim të caktuar të tij.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dijeni për ndonjë  
6 rast konkret ku komandant Remi ta ketë liruar apo falur një  
7 person kundër vullnetit të shprehur prej Shtabit të  
8 Përgjithshëm?

9 PË. Nuk di për këtë rast.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Ibishi, po ashtu javën e kaluar në faqen 21169 të  
12 transkriptit, ju keni thënë se komandant Remi kishte autoritet  
13 të plotë për të liruar të ndaluarit dhe të jepte amnisti në  
14 bazë të propozimeve që i merrte prej komandës. A të kujtohet  
15 ta keni thënë këtë javën e kaluar, të enjten?

16 PË. Po, ashtu është.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 Për cilën komandë e keni fjalën?

19 PË. Komandën e zonës operative të Llapit. Apo të rajonit të  
20 Prishtinës, me e thanë, pasi nganjëherë bëhet konfuzion krahas  
21 terminologjisë gjeografike si janë quajtur shtatë zonat  
22 operative. Zona operative e Llapit ka përfshi Prishtinën,  
23 Podujevën, dhe Fushë-Kosovën si zonë të përgjegjësisë,  
24 komunat, me kryeqytetin.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë, thjesht që të jemi

1 të qartë, ju nuk i jeni referuar komandës së Shtabit të

2 Përgjithshëm, apo jo?

3 PË. Jo.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Është e qartë  
5 tani.

6 Tani të kalojmë tek një temë tjetër. Sipas paragrafëve 63  
7 dhe 64 të Shënimit Përgatitor numër 2, ju i keni thënë  
8 Prokurorisë si më poshtë vijon, gjatë seancës përgatitore. Dhe  
9 meqenëse nuk e kemi versionin në shqip, unë do ta lexoj nga  
10 Shënimi Përgatitor që është bërë në anglisht. Pra ç'keni thënë  
11 ju atje.

12 Në paragrafin 63, ju keni thënë, z. Ibishi:

13 "Ai", thuhet aty, pra i referohen, ju referohen juve, "ai  
14 ju referuam dëshmisë së tij të bërë në datën 22 maj 2003, në  
15 faqen 9", me numrin SPOE00088349 në anglisht, "për çështjen e  
16 rojeve të pyllit dhe informacionin që u jepej paramilitarëve  
17 serbë, dhe ju bë pyetje në lidhje me këtë çështje, çfarë  
18 njohurish kishte. Dëshmitari W04758 tha, sepse rojtarët e  
19 pyllit e njihnin mirë terrenin dhe meqenëse UÇK-ja operonte në  
20 një territor që mbulohej me pyje, rojet e pyllit kishin  
21 informacion për zonën në fjalë. Gjuetarët në të njëjtën --  
22 kishin të njëjtat njohuri, por ama aktivitetet e gjuetisë  
23 ishin të kufizuara në atë kohë. Dëshmitari W04758 tha  
24 gjithashtu që rojet e pyllit mund të udhëhiqnin edhe forcat  
25 serbe për të -- për të sulmuar pozicionet e UÇK-së dhe, ata

1 ende po punonin në atë kohë dhe të kalonin informacion tek  
2 serbët si pjesë e detyrave të tyre. Për sa u përket rojeve të  
3 pyllit që punonin për administratën serbe, policia serbe dhe  
4 shërbimi informativ i Serbisë, jo vetëm i orientonin dhe i  
5 udhëzonin ata, por edhe u vinin presion për, që ata të  
6 raportonin. Dëshmitari W04758 di që disa prej rojeve të pyllit  
7 u detyruan që ta kalonin këtë informacion.”

8 Ndërsa në paragrafin 64 thuhet kështu:

9 “Kur u pyet nëse aktiviteti i prerjes së pemëve ishte i  
10 dyshimtë, dëshmitari W04758 tha që në vetvete kjo nuk ishte  
11 problem, megjithatë rojet e pyllit lejonin edhe formën e  
12 paligjshme të prerjes së pemëve në mënyrë që të merrnin  
13 informacion prej prerësve të drurit dhe të shkëmbenin  
14 informacion.”

15 Z. Ibishi, a është ende e saktë kjo që ju kam lexuar dhe  
16 a mbetet kjo dëshmia juaj?

17 PË. Po, vetëm një shtesë. Znj. Prokurore e din që disa nga  
18 ata, nuk mund të, në mënyrë gjenerale të them për të gjithë  
19 rojet e pyllit, por disa nga ata. Edhe kjo qëndron çfarë është  
20 thënë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe a ishte  
22 kjo një gjë që e dinin të gjithë tek UÇK-ja? Pra, ushtarët e  
23 brigadës tuaj e dinin që të paktën disa roje të pyllit u  
24 kalonin informacion autoriteteve serbe dhe disa nga ata që  
25 prisnin dru në fakt edhe shkëmbenin informacion dhe jepnin



1 informacion?

2 PË. Shumica e këtyre të dhënave sa i përket aspektet të  
3 sigurisë, pra, vinin edhe nga vetë qytetarët nëpërmes  
4 mbrojtjes civile. Edhe, normal, ne ato i bartnim te vartësit  
5 tonë me qëllim të ngritjes së vetëdijes edhe të kujdesit nga  
6 një rrezik i tillë pra, i veprimit.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju personalisht keni  
8 informuar ushtarët e brigadës tuaj në lidhje me këtë çështje?  
9 Këtë sapo thatë? Këtë keni bërë?

10 PË. Po, normal, në kuadër të ligjëratave, pra, përveç  
11 aspekteve të, si temë e parë, çdo herë duhet cekur që zona  
12 jonë është shquar nga ajo se tema e parë e çdo trajnimi ka  
13 qenë e drejta ndërkombëtare e luftës. Që nënkupton katër  
14 konventat e Gjenevës dhe dy protokolle shtesë, dhe të drejtën  
15 humanitare. Por ndër të tjera në aspektin e sigurisë, kemi  
16 shpërfaqë edhe çështjet që duhet të kem parasysh ushtarët  
17 lidhur me sigurinë edhe të misionit të Ushtria Çlirimtare e  
18 Kosovës, por njëkohësisht edhe vetë civilëve që rreziqet që  
19 mund të vinin nga, pra, struktura të ndryshme që bashkëpunonin  
20 me forcat e armikut, pra, strukturat e sigurisë së regjimit  
21 serb të, apo regjimit okupues serb në Kosovë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Ibishi, tani do të kalojmë tek tema e fundit që kam.  
24 Në seancën përgatitore me ZPS-në, dhe këtu i referohem  
25 paragrafit 76 të Shënimit Përgatitor numër 2, ju thuhet që i

1 keni thënë Prokurorisë që në 1998 dhe 1999 UÇK-ja ka përdorur  
2 telefon satelitor, Motorola, si edhe radiomarrës dhe  
3 ndonjëherë edhe celularë, a është e saktë kjo? A ia keni thënë  
4 këtë Prokurorisë?

5 PË. Po, ia kam thanë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur keni parë për herë të  
7 parë telefon satelitor tek UÇK-ja, në 1998 apo më vonë?

8 PË. Në 1998 dikur. S'mund t'i referohem kohës, por kah fundi  
9 i 1998.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ku e keni parë këtë  
11 telefon satelitor, kush e ka patur këtë telefon?

12 PË. Por për shkak të numrit të kufizuar të tyre, të këtij  
13 sistemi që ishte i ri për kohën, për herë të parë  
14 ballafaqohemi me këtë sistem, ne kishim, s'mund ta kujtoj  
15 saktësisht, një apo dy në fillim, e më vonë na sollën edhe  
16 disa të tjerë. Pra, kishte në nivel të komandës së zonës,  
17 mandej edhe të dhomës operative ku ne, pra, zëvendëskomandanti  
18 i zonës Kadri Kastrati edhe unë si shef i shtabit, pra, nga  
19 dhjetori i 1999, pra, komunikim në kuptimin e asaj apo  
20 përdornim për çështje, pra, të komunikimit përveç sistemit të  
21 radiolidhjeve që kishim, pra, një fushëveprim të kufizuar  
22 ngase punonim vetëm në sistemi *simplex* apo në sistemin e  
23 drejtpërdrejtë të komunikimit mes dy aparateve të  
24 radiolidhjeve, por jo nëpërmes sistemit *semi duplex* të  
25 komunikimit nëpërmes repetitorëve.

1 Kështu që ma tepër kemi përdor sistemin e radiolidhjeve  
2 për komunikim kuadër të, pra, të njësive që ishin në afërsi  
3 dhomës operative kur ne kryenim, pra, apo ishte dhoma e  
4 komandës të them, të zona operative e Llapit, për çështjet  
5 operacionale.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni përdorur edhe  
7 celularë?

8 PË. Celularin e kemi përdor shumë në mënyrë të kufizuar, edhe  
9 çdo herë duke pas parasysh se kemi supozuar se ato janë të  
10 përgjuara edhe mund të na përcaktojnë lokacionin. Kështu që  
11 aspekti i përdorimit të celularit ka qenë me udhëzim të  
12 caktuar që të largohemi nga zonat e komandës apo të  
13 përqendrimit, edhe vetëm në raste të përjashtimit mund të  
14 përdorim celularin, ngase nga vetë ajo, ato njohuritë tona që  
15 ata mund të përgjoheshin edhe për njëkohësisht përcaktohej  
16 edhe lokacioni që mund ta sillnin në rrezik veten gjatë edhe  
17 normal, strukturat e komandës së zonës në rrezik nga  
18 targetimi.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe pyetja e fundit  
20 z. Ibishi. A keni përdorur dhe korrierë gjatë luftës? Keni  
21 patur korrierë?

22 PË. Kemi patur, por shumë pak ngase vetëm për njësitet kur  
23 nuk funksiononte thujse këto sistemet e ndërlihdjes, çfarë ju  
24 i përmendët, dhe atëherë. Por në shumë raste të rralla kemi  
25 përdor korrierët nga rreziku i vetë komunikimit në pjesën e

1 zonave që shpesh ishin të pakontrolluara mirë edhe korrierët  
2 mund të bijshin në pusi të forcave të armikut.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë  
4 z. Ibishi. Këto ishin pyetjet që kisha unë. Faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
6 Mettraux.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit,  
8 z. Dëshmitar.

9 Dëshiroj që të vijoj me disa nga ato çështje që kanë dalë  
10 me palët e para. Ka të bëjë me trajnimet që ju thatë janë bërë  
11 për anëtarët e UÇK-së në zonën tuaj të përgjegjësisë. Me ç'kam  
12 kuptuar, ju keni sugjeruar që një pjesë e atyre trajnimeve ka  
13 pasur të bëjë me katër konventat e Gjenevës, si dhe me  
14 protokollet shtesë. A është e saktë kjo?

15 PË. Po, e saktë është.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, a do të mund të  
17 sugjeronim nga kjo gjë, a do të ishte e drejtë të sugjeronim  
18 që me ç'keni kuptuar ju, si edhe me ç'kanë kuptuar komanda e  
19 zonës që si UÇK-ja ashtu edhe anëtarët e saj, ishin të  
20 detyruar t'i përmbaheshin detyrimeve të kësaj, të këtyre  
21 Konventave. Është e drejtë kjo, mund ta themi?

22 PË. Po. Dhe duhet të spjegoj edhe këtë. Kjo i referohet  
23 çështje të, pra, nenit 87 të Protokollit 2 Shtesë të  
24 Konventave të Gjenevës ku përcakton edhe detyrimin e komandës  
25 për t'u njohur edhe, normal, edhe të reparteve të, pra,

1 funksionale të zonës, me të drejtat e luftës edhe respektimin  
2 e tyre.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Okej, do ta kontrollojmë  
4 numrin e nenit, sepse unë nuk di që të ketë nen 87 Protokolli  
5 Shtesë, i Dytë Shtesë. Megjithatë, e lëmë këtë mënjane. A mund  
6 të na thoni që çfarë i keni thënë ju ushtarëve të UÇK-së për  
7 Konventat e Gjenevës? A mund të na tregoni, pra, ç'u keni  
8 thënë atyre për Konventat dhe protokollet e tyre?

9 PË. Është veç çështja jua të merreni me çështjet -- por  
10 realiteti është ky. Ngase unë e kam një karrierë edhe policore  
11 edhe ushtarake, edhe kam njohuri të, edhe jam njëkohësisht  
12 edhe magjistër në shkenca juridike. Edhe këto i kam studiuar  
13 edhe kam pas si prioritet bashkë me komandën e zonës që duhet  
14 t'i bëjmë këto tema, të vetëdijësojmë strukturën me qëllim të  
15 respektimit, të obligimit, pra, të secilit, pra, në bazë të  
16 diskrecionit të pozitës, që t'i përmbahem rregulloreve  
17 gjegjësisht dispozitave të katër Konventave të Gjenevës të  
18 vitit 1949, e dy Protokolleve Shtesë të vitit 1977. Këtu ka të  
19 bëjë edhe në aspektin e palëve ndërluftuese, edhe në aspektin  
20 e të drejtës, pra, të organizatave humanitare të personelit që  
21 një formë ndërmjetëson në një konflikt, qoftë të brendshëm apo  
22 të jashtëm.

23 Pasi që konflikti i Kosovës e dini që është edhe konflikt  
24 i brendshëm edhe ndërkombëtar, në varësi prej kohës. Dhe që do  
25 detyrimisht t'i referohemi këtyre, edhe, normal, të drejtave

1 edhe të personave civilë, por edhe çështjeve të tjera që një  
2 formë duhet të jenë të kujdesshëm në zbatim. Pra, kjo është  
3 një formë e vetëdijësimit të strukturës për të gjitha ato çka,  
4 pra, përmban Konventat e Gjenevës edhe të mos të kemi pasoja  
5 nga mos, them, mossensibilizimi apo mosnjohuritë lidhur me  
6 këtë.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptova. Tani, javën e  
8 shkuar ju iu referuat nenit 75, 85 ose 86, nuk dua dispozitën  
9 e posaçme, por me ç'kuptova unë iu referuat Konventës së  
10 Katërt të Gjenevës. E kam kuptuar mirë që një pjesë e  
11 trajnimit ka qenë për të trajnuar ushtarët e UÇK-së se si të  
12 trajtonin popullatën civile?

13 PË. Po, unë e kam nxjerrë nga, në atë kohë, nga pjesë, pasi  
14 kisha literaturën nga pjesë më substanciale që ishin me  
15 rëndësi tamam, neni 3 i katër Konventave të Gjenevës, por edhe  
16 referoja edhe Protokollit të Dytë Shtesë, pra, të vitit 1977  
17 në atë Artikullin, për Artikullin 75 edhe 87.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a ka qenë pjesë e  
19 trajnimeve edhe që t'u tregonit ushtarëve të UÇK-së, atyre që  
20 po trajnoheshin, se çfarë pret Konventa e Gjenevës për  
21 trajtimin që u bëhet të ndaluarve. Pra, u keni treguar atyre  
22 se si shprehet Konventa e Gjenevës për trajtimin njerëzor dhe  
23 për keqtrajtimin që është i ndaluar, dhe për aktet çnjerëzore,  
24 ua keni treguar këtë gjë?

25 PË. Po, gjithsesi. Edhe atë unë e kam ofru si dëshmi këtë,

1 edhe fatkeqësisht nuk është përfshi çështja e këtyre, kësaj të  
2 them, prove kur e kam ofru në vitin 2003 në Gjykatën e Qarkut  
3 në Prishtinë ndaj katër të dyshuarve atëherë, dhe edhe disa  
4 dëshmi të tjera që ka të bëjë me çështjen e video-incizimeve  
5 të refugjatëve, mandej fotografinë time të largesës duke i  
6 mbrojtur refugjatët në vijën e parë të frontit, në zbrapsjen  
7 e forcave serbe. Por edhe çështje të tjera që një formë janë  
8 hedh si prova. Por, këto tema janë të përshkruara në  
9 monografinë për zonën operative të Llapit, të z. Skënder  
10 Zhitia. Edhe mendoj se është ajo provë e kësaj, mendoj që ajo  
11 do të merret parasysh. Pra, përgjigjja ndaj ju, këto njohuri  
12 apo këto ligjërata janë ba me qëllim që ata janë të vëmendshëm  
13 me qëllim që mos të shkelin të drejtat e njeriut, gjegjësisht  
14 që të përmbahen kompetencave, dispozitave që ka të bëjë me,  
15 pra, me çështjet e mbrojtjes, pra, të personave që  
16 apostrofohen në këto dispozita të Konventave të Gjenevës dhe  
17 Protokolleve Shtesë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e radhës është,  
19 çfarë procedure ose çfarë hapash keni vendosur ju në mënyrë që  
20 këto synime të përmbushjes të kriterëve të Konventave të  
21 Gjenevës të kryheshin, pra, që anëtarët e organizatës tuaj t'u  
22 përmbaheshin atyre dhe t'i respektonin ato?

23 PË. Por përveç ligjëratave, ne bënim edhe mbikëqyrjen në  
24 kuptim të zbatimit të disiplinës ushtarake. Edhe ju keni  
25 dëshmi të plota lidhur me masat që ndërmarr nëse eventualisht

1 ka pas shkelje të disiplinës, por eventualisht edhe çështjeve  
2 që ndërlidhen me dispozitave, dispozitat e Konventës së  
3 Gjenevës dhe dy protokolleve shtesë, për aq sa kemi pas  
4 njohuri që, si komandë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të kaloj tek pjesa e  
6 disiplinës pas pak me një shembull. Megjithatë, më lejoni të  
7 tregohem më konkret. Pra, ju u keni treguar personave që kanë  
8 marrë pjesë në trajnime që duhet t'i trajtonit të ndaluarit në  
9 një mënyrë njerëzore, nuk mund t'i keqtrajtoni ata. Por çfarë  
10 hapash, me ç'dini ju, janë ndërmarrë që të bëhet kjo gjë në  
11 formë aktive dhe ata të vepronin në këtë formë?

12 PË. Po, këtë kemi ndërmarrë veprime në kuptimin e asaj që  
13 bëjmë përgjegjës nivelin e komandave të caktuara, pra, të, e  
14 dhe të ushtarëve, që ata nganjëherë ballafaqohen në aspektin e  
15 një ngjarje të atypëratyshme, sikur që ka ndodh shpesh, apo në  
16 kuadër të një njësitit apo pozicionit, por njëkohësisht edhe  
17 kemi kufizuar në nivel të përgjegjësisë të brigadave që ato të  
18 merren me çështjet e trajtimeve, në bashkëpunim edhe me  
19 mbrojtjen civile edhe, domethënë, pjesëtarët apo përfaqësuesin  
20 e shërbimit informativ, por edhe policinë ushtarake me qëllim  
21 që shkeljet e tilla mos të jenë, pra, them, prezentë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, të përqendrohemi  
23 tek të ndaluarit për momentin. Përgjegjësia e kujt ka qenë për  
24 ta përdorur, pra, një shprehje që keni përdorur dhe juve, ka  
25 qenë që të, që të mbikëqyrnin që personat e ndaluar të



1 trajtoheshin duke respektuar dispozitat e Konventave të  
2 Gjenevës. Në zonën tuaj, kush e ka patur këtë përgjegjësi?  
3 PË. Po përgjegjësinë e kanë pas ata që është dashtë t'i  
4 zbatojnë këto, këto kërkesa të mbrojtjes civile, pra, ata kanë  
5 qenë sikur që përmenda prej nivelit të komandantit të  
6 brigadës, me policinë ushtarake, edhe deri te, pra, në kuadër  
7 të brigadës, deri te policia, pra, në nivel të zonës, ku edhe  
8 ka qenë qendra e mbajtjes, pra, të personave.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po komandanti i zonës, a  
10 ka përgjegjësi komandanti i zonës për veprimet e këtyre  
11 personave në lidhje me atë që mund të ndodhë me të ndaluarit?  
12 PË. Po, gjithsesi. Edhe komandanti i zonës deri në nivelin,  
13 edhe të brigadave, deri te ushtarët të cilët kanë një  
14 përgjegjësi ngase ajo nuk derivon vetëm me një përgjegjësi të  
15 nivelit të caktuar, por ne jemi munduar që nëpërmes njoftimeve  
16 të, prej nivelit bazë e deri në, them, superstrukturë që të  
17 njoftohen për përgjegjësitë edhe në aspektin individual të  
18 përgjegjësive si diskrecion, por edhe në nivel të eprorëve të  
19 zonës.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta e keni thënë edhe  
21 më parë, por thjesht dëshiroj të bëj këtë pyetje për ta  
22 kuptuar atë që keni thënë. Përgjegjësia e kujt ishte ajo që të  
23 shkonte në ambientet e ndalimit për t'u siguruar që  
24 respektoheshin Konventat e Gjenevës, pra, kush e kishte këtë  
25 përgjegjësi në, me ç'dijeni keni ju?

1 PË. Pra, në kuadër të qendrës të ndalimit, kemi pas, pra,  
2 policinë ushtarake. Policia ushtarake ka qenë e edukuar dhe e  
3 shkolluar, ajo ka pas një eksperiencë të kaluar policore.  
4 Edhe, normal, aty ata kanë qenë përgjegjës edhe për çështjen e  
5 mbarëvajtjes së, pra, apo mbajtjes së personave edhe në  
6 aspektin ambiental, edhe në aspektin e ushqimit, edhe, pra, të  
7 kontrolleve mjekësore, edhe gjithë ato ka pas që një formë ajo  
8 të jetë transparente. E gjithashtu transparente ka qenë edhe  
9 çështja e vizitave që janë bë nga të afërmit e personave që  
10 janë mbajtur, por që edhe vetë, i kam dy raste të veçuara, për  
11 të cilat unë kam vizituar qendrat për të cilat këto i keni --  
12 [Folës që flasin njëkohësisht].

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, faleminderit.  
14 Faleminderit. E keni përmendur këtë gjë.

15 Ju përmendët disiplinën dhe do t'i kthehem edhe kësaj  
16 çështjeje.

17 Por do t'i lutesha Sekretarit që në ekran të vendosë  
18 dokumentin U000-9710 deri në U000-9792-ET, dhe e njëjta ERN  
19 për versionin në gjuhën shqipe. Numri i faqes që dëshiroj të  
20 kemi në ekran është 9777. Është faqja tjetër në versionin  
21 anglisht. Faleminderit. Po, kjo është faqja.

22 Atëherë, zotëri, a e mbani mend që ju është treguar ky  
23 dokument gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal, kjo

1 është, ky është Shënimi Përgatitor numër 2 dhe paragrafi 33.

2 Atëherë.

3 Vetëm për pak çaste, të kalojmë tek faqja tjetër në  
4 gjuhën shqipe, ju lutem. Dhe rreth fundit të faqes.

5 Gjëja e parë që dëshiroj të konfirmoni për ne është që ju  
6 e njihni firmën në këtë dokument, nënshkrimin?

7 PË. Po, e njof.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a mund të na tregoni  
9 se i kujt është ky nënshkrim?

10 PË. Kjo është i komandant Dajës, gjegjësisht,  
11 zëvendëskomandantit të, në këtë rast, nënzonës operative të  
12 Llapit, për vetë, kjo është koha kur akoma jemi në Zabërgjë.  
13 Pra, zëvendëskomandanti Kadri Kastrati.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kadri Kastrati.  
15 Faleminderit. A mund t'i kthehemi faqes së parë në gjuhën  
16 shqipe?

17 Po të shikojmë paragrafin e parë, zotëri, në versionin  
18 anglisht, thuhet kështu:

19 "Në bazë të rregullores së përkohshme të shërbimit në  
20 UÇK, dhe autorizimeve të komandantit të zonës operative të  
21 Llapit, respektivisht komandantit të brigadës, për  
22 mosrespektimin e urdhrat respektivisht për pakujdesi që kanë  
23 treguar gjatë -- për pakujdesi që kanë treguar gjatë kryerjes  
24 së detyrës dhe obligimeve ushtarake."

25 A e shihni këtë, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja e parë, përpara se  
3 të hyjmë në thelbin e çështjes. A e mbani mend që ka patur një  
4 rregullore të përkohshme të UÇK-së, të shërbimit në UÇK të  
5 cilës i referohet kjo faqe, ky vendim?

6 PË. Tash në, s'po mund t'i referohem saktësisht. A mund ta  
7 zbret vetëm pak datën ta shof në fund të kësaj që është me  
8 dorëshkrim në shqip? Ngase këtu përmendet, pra, Brigada 2.  
9 Akoma.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] po.

11 PË. Edhe pak, se nuk shof datë të caktuar për cilën periudhë  
12 kohore i referohet. Nejse, nuk e kam kohën --

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër  
14 në gjuhën shqipe, që ta ndihmojmë dëshmitarin, sepse data  
15 është në atë faqe. Po, faleminderit. E shihni datën tani,  
16 Dëshmitar?

17 PË. Po. Tani është 9 shtatori, pra, kjo ka të bëjë me masat  
18 disiplinore për pjesëtarët e brigadës, atëherë si emëru  
19 Brigada 2, apo Brigada 152, Shaban Shala. Për, pra, tre  
20 pjesëtarët ndaj të cilëve është shqiptu masa disiplinore, pra,  
21 në nivel të zonës. Por, lidhur me pyetjen e juaj se për  
22 cilën --

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, do të vij tek pyetja,  
24 por së pari. Data është 1 shtator [Sipas përkthimit] 1998,  
25 jeni dakord me këtë?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, të kthehemi  
3 sërish tek faqja tjetër në gjuhën shqipe.

4 Në verën e vitit 1998, në korrik 1998, Shtabi i  
5 Përgjithshëm i UÇK-së miratoi rregullore të përkohshme të UÇK-  
6 së. A ju kujtohen këto rregullore?

7 PË. Po, në kontekst të kohës, pra, disa rregullore më  
8 kujtohen, disa jo. Tash nuk jam i sigurt t'i referohem. A  
9 është pra, kjo rregullore e Shtabit të Përgjithshëm apo në  
10 shumë raste në mungesë të rregulloreve të caktuara që kanë  
11 mbulue fusha të caktuara, ne kemi bo rregullore të përkohshme  
12 pra, në kuadër të nënzonës atëhere, se atëherë është nënzona,  
13 të cilat i ka miratue, pra, i kemi bo unë në bashkëpunim me  
14 zëvendëskomandantin, Dajën, edhe ka qenë rregulloret e  
15 përkohshme derisa Shtabi i Përgjithshëm na i ka dërgu, pasiqë  
16 ka pas vonesa në çështjen e dorëzimit të këtyre rregulloreve,  
17 edhe kjo është var ekskluzivisht nga vizita e komandantit të  
18 zonës që ka qenë shumë rrallë në selinë e Shtabit të  
19 Përgjithshëm.

20 Edhe tash nuk mund t'i referohem lidhur me këtë çfarë po  
21 apostrofohet, as rregullorja e Shtabit të Përgjithshëm apo ne  
22 kemi bo rregullore të përkohshme apo kaluese. Nuk jam i sigurt  
23 për këtë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptova. Do ta bëj  
25 pyetjen në këtë formë. Kur ju keni marrë rregulloret e

1 përkohshme nga Shtabi i Përgjithshëm, a e mbani mend që t'i

2 keni marrë ato në verën e vitit 1998?

3 PË. Nuk -- kemi marrë, por nuk mund, ndoshta kemi marrë disa,

4 por nuk mund t'i referohem se cilave në mënyrë specifike, se

5 ka kalu koha. Por, unë i referohem asaj, nëse kemi pas

6 rregullore që kanë mbulu fushën, ne kemi bo rregullore të

7 përkohshme tranzitore deri në sjelljen nga Shtabi i

8 Përgjithshëm pra, rregulloren që, e caktuar.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptova. Dhe pasi morët  
10 rregulloret e Shtabit të Përgjithshëm atëherë atë përdornit si  
11 bazë apo jo? Në bazë të saj vepronit?

12 PË. Edhe një herë po them, nëse kishim atëherë do ta, do t'i  
13 referohem asaj. Por nëse nuk e kishim, ne do t'i krijon në  
14 autoritetin e zonës ku do ta nënshkronte komandanti propozimin  
15 tonë duke iu bazue, pra, standardeve, pra, ushtarake edhe  
16 dispozitave të caktuar që përkon edhe me të drejtën  
17 ndërkombëtare, edhe rregulloret e brendshme. Do të bënim  
18 rregulloren e fushës, edhe ajo do të ishte në funksion deri në  
19 sjelljen nga Shtabi i Përgjithshëm.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani e kam të qartë.  
21 Faleminderit.

22 Të lutem, shiko personin e parë që përmendet këtu, që ka  
23 qenë objekt i masave të disiplinore. Agron Harolli është emri  
24 këtu.

25 PË. Havolli.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Havolli. Havolli. Ju  
2 lutem, hidhi një sy arsyeve për marrjen e masave disiplinore.  
3 Pra, lexoje paragrafin, njihu me paragrafin dhe më pas do ju  
4 bëj një pyetje.

5 PË. [E pakuptueshme] Por po e kuptoj për çka është rasti.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, a pajtoheni ju me  
7 parashtrimin tim që z. Havolli ka qenë objekt i masave  
8 disiplinore sepse nuk është bindur urdhrave të komandantit, se  
9 ka konkretisht ai është larguar nga pozicioni i tij në  
10 kundërshtim me urdhrin e dhënë? Pajtoheni ju me arsyet që janë  
11 aty?

12 PË. Po. Janë dy arsye. Domethënë, e para është që ai është  
13 largue nga zona e përgjegjësisë apo zona e përgjegjësisë së  
14 brigadës, duke marrë edhe disa ushtarë të tjerë të armatosur,  
15 dhe ka shku në një fshat tjetër në pjesën tjetër të zonës të  
16 përgjegjësisë tonë, që nuk ka qenë nën kuadër të kësaj  
17 brigade.

18 Edhe ka -- shkelja tjetër është se ka mobilizuar në  
19 kundërshtim me urdhrat, pra, edhe një automjet, pra, si  
20 përmendet këtu, Lada.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, a mund të themi  
22 bazuar në këtë dokument, por dhe bazuar në rrethanat të tjera  
23 që në brigadën tuaj pritej që vartësit t'i respektonin  
24 urdhrat. Dhe nëse vartësit nuk do t'i respektonin urdhrat,  
25 atëherë do të ishin objekt i masave disiplinore. A ishte ky

1 një përmbledhje, më falni, ishte kjo një përmbledhje e drejtë  
2 nga ana ime?

3 PË. Po. Për shkelje që bënin në kuadër, pra, të përgjegjësi  
4 edhe të asaj, shkeljeve të tjera të rregulloreve. Pra,  
5 ushtarët gjegjësisht, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të  
6 Kosovës mbanin përgjegjësi. Edhe vetë e kam edhe një rast për  
7 të cilin ndoshta edhe e cekët, kur edhe ushtarin tim e kam,  
8 pra, ndërmarrë masat strikte menjëherë me mu për shkak që ka  
9 rrezikue, ka shkakto një rrezik të përgjithshëm në pra, në  
10 përdorim të armës, edhe kjo ka qenë masë e menjëhershme me  
11 qëllim të vetëdijesimit të strukturës për mos me përsërit  
12 raste të tilla, në aspektin e edukimit apo edhe riedukimit.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, besoj se e pamë këtë  
14 javën e kaluar. Kishte numrin e provës 1763. Faleminderit.

15 Tani, nga sa shohim këtu dhe nga sa po thoni ju që ka  
16 pasur pritshmëri në brigadën tuaj, që ushtarët e UÇK-së nuk  
17 mund të largoheshin si dëshironin nga pozicioni i tyre, sepse  
18 nëse do ta bënin, atëherë do të merreshin masa disiplinore për  
19 ta, kështu?

20 PË. Ashtu është.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë tani dua t'ju bëj disa  
22 pyetje lidhur me diçka që i keni thënë Prokurori kur ju ka  
23 intervistuar.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse po i hiqni dokumentin, a mund  
25 t'ju lutem për këtë pjesën që përmendët, rregulloren e



1 përkohshme të UÇK-së në 1998? A mund të na jepni referencën,  
2 ju lutem? Sepse na shërben dhe ne.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më duket me sa e kam unë  
4 parasysh, bëhet fjalë për provën me numër 163. Kështu që, këtu  
5 fokusohuni nëse do të keni dhe ju pyetje për dëshmitarin.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Po, po, pse pikërisht për këtë  
7 pyeta.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshmitar, pra, siç thashë  
9 unë dua që të sqarojmë disa nga aspektet që keni diskutuar me  
10 Prokurorinë.

11 Së pari, lidhur me strukturën e zonave. Me sa kam kuptuar  
12 unë, ju në intervistën për Prokurorinë, Pjesa 1, faqja 14, e  
13 cila tashmë ka numrin e provës P1755, ju keni thënë që  
14 struktura e zonës është bërë në bazë të urdhrave të Shtabit të  
15 Përgjithshëm. Pra, me fjalë të tjera, urdhri ka ardhur nga  
16 Shtabi i Përgjithshëm, dhe më pas është krijuar struktura në  
17 zonë. A e kam kuptuar unë drejt këtë, zotni?

18 PË. Pra, struktura, sa e di unë, ka ardh nga Shtabi i  
19 zonës -- i Përgjithshëm, por që ne e kemi modifikuar konform  
20 nevojave specifike tonat, sikur që kam përmend, edhe ma herët,  
21 çështjen e BIA-s, çështjen e mbrojtjes civile, çështjen e pra,  
22 batalionit të shëndetësisë, edhe këto janë specifika të zonës  
23 që ka, ndryshojnë nga ajo. Ajo nuk ka qenë urdhër, ajo ka qenë  
24 një formë apo dy forma të modelit se si të bëhet. Pra, si të  
25 bëhet organograma, apo struktura organizative, ma tepër ka

1 qenë referencë. Kështu, edhe kjo, edhe këto dëshmia marrë qysh  
2 ma herët janë ofruar gjatë procesit në vitin 2003, në Gjykatën  
3 e Qarkut në Prishtinë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim edhe për  
5 zbatimin, por fillimisht për kontekst.

6 Si pjesë e këtij, kësaj strukture, apo këtij modeli, pra,  
7 kur krijuat ju strukturat, a krijuat dhe objektet e ndalimit  
8 bashkë me strukturat?

9 Është Pjesa 4 kjo, faqja 9 edhe 10.

10 PË. Pra, ajo ka ardh si çështje e informueshme e kohës, nuk  
11 ka pas në kuadër të strukturës organizative një aspekt të  
12 tillë të qasjes.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, unë e kam fjalën  
14 kështu. Ka qenë pjesë e, ju thatë "model" më duket. Pjesë e  
15 modelit që jua ka propozuar Shtabi i Përgjithshëm?

16 PË. Po, ashtu supozoj se do të jetë, si ka ardh nuk e di por,  
17 mendoj që ka qenë një, një model si mund të bëhet struktura  
18 organizative. Kjo ka qenë. Ne e kemi përshtat krahas,  
19 domethënë, nevojave tona sikur që përmenda me ato shtesat që i  
20 ceka ma herët.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas u bë kjo  
22 përshtatja, apo zbatimi, përgjegjësinë për këtë kush e kishte?  
23 E kishte komandanti i zonës pastaj? Apo ndokush tjetër?

24 PË. Kjo ishte përgjegjësi e komandës së zonës, në krye me  
25 komandantin.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të flasim tani për  
2 objektin e ndalimit në Llapashticë. Ju kujtohet me përafërsi  
3 kur është krijuar?

4 PË. Po mund të jetë se nuk e di me saktësi, por mund të jetë  
5 ndoshta në nëntor të vitit 1998, s'jam i sigurt.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe një herë, nuk dua të  
7 thoni diçka që nuk e dini. Por në intervistën me ZPS-në duket  
8 sikur keni thënë që mund të ketë qenë nga fundi i tetorit  
9 1998, mbase fillimi i nëntorit 1998. A ju kujtohet sot?

10 PË. Po. Ashtu diçka, e kam thanë. Por nuk muj saktësisht t'i  
11 referohem, se po të isha i sigurt do të thosha ose nëntor ose  
12 -- ose tetor ose nëntor. Keni parasysh kanë kalu 25-26 vite,  
13 nga njëherë njerëzit s'dinë çka, vjet çka ka pas, apo çka ka  
14 kry prej detyrave të shumta, e jo më këtë periudhë kohore ta  
15 kufizoj kohën e saktë kur ka ndodh këto. Por në atë periudhë  
16 kohore mund të jetë fundi i asaj, apo fillimi. Unë iu referova  
17 kështu çfarë ata, ku qëndron ajo, çfarë kam dhanë në  
18 deklaratë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që të jemi të qartë. Nuk  
20 po fajësoj se unë për vete s'mbaj mend fare, kështu që unë e  
21 kuptoj që është e vështirë.

22 Por do të doja të flisnim pak për kompetencat për lirimin  
23 e të ndaluarve në zonën tuaj. Këtë e keni trajtuar me  
24 Prokurorinë dhe me Gjykatësin, kolegun, më falni, me kolegun  
25 tim, Gjykatësin Barthe. A ju kujtohen këto pyetjet për

1 kompetencat?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa kuptova unë, ju  
4 thatë se përgjegjësinë kryesore për këtë brenda zonës, e  
5 kishte vetë komandanti i zonës. A kam kuptuar drejt?

6 PË. Ashtu diçka, vetëm thuhet që për përgjegjësinë  
7 përfundimtare, ngase ajo shkonte me një sistem paraprak të  
8 kërkesave ose vlerësimeve të caktuara, kështu që domethënë në  
9 aspektin përfundimtar ishte papërgjegjësi e komandantit të  
10 zonës, si komandanti kryesor, them, i zonës operative të  
11 Llapit.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim edhe për  
13 autoritetin përfundimtar. Por unë dua t'ju tregoj disa  
14 dokumente lirimi që i atribuohen komandantit të zonës, z.  
15 Rrustem Mustafa.

16 Do të tregoj fillimisht katër dokumente, dhe më pas do të  
17 bëj pyetje. Do t'ju jap dhe mundësinë që t'i lexosh vetë.

18 Dokumenti i parë është dokumenti me numër P1885 [Sipas  
19 përkthimit].

20 PË. Nëse mundet, te versioni shqip.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, po. Po unë nuk jam i  
22 sigurt nëse e kemi dhe shqipen. Mund ta kontrolloj gjatë  
23 pushimit. Por për momentin më lejoni t'jua lexoj unë --

24 PË. Jo, se s'është problem, edhe kështu e kuptoj, por nëse  
25 ndonjë detaj eventual ishte -- s'është problem. Vetëm lexoni

1 edhe --

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta gjejme pak më vonë,  
3 do ta kërkojmë.

4 Do -- kjo pretendohet se është një amnisti. Që ka datën  
5 17 janar 1999. Vjen nga zona operative e Llapit.

6 Shkojmë, ju lutem, në fund të dokumentit.

7 Është nënshkruar nga komandanti i zonës operative të  
8 Llapit, dhe ka të bëjë me katër persona që janë mbajtur të  
9 ndaluar nga UÇK-ja. Idriz Shabani, Fatmir Mustafa, Gani  
10 Rakovica dhe Bedri Ademi.

11 Ju lutem të shkojmë përsëri në krye të faqes për një  
12 çast. Unë dua t'ju lexoj paragrafin e parë, dhe më pas do të  
13 bëj pyetjet për këtë. Kjo amnisti që mendohet se e ka lëshu  
14 komandant Remi, ka këtë paragraf.

15 "Bazuar në deklaratat politike të Shtabit të Përgjithshëm  
16 të UÇK-së, Rregulloren e Brendshme të UÇK-së dhe bazuar në  
17 Rregulloren për Administratën Civile, komandanti i zonës  
18 operative të Llapit të UÇK-së shpall: Amnistinë."

19 E kuptuat?

20 PË. Po.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shqipen mund ta gjeni me numrin  
22 e provës P150.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë,  
24 Dëshmitar, po nxjerrim dhe shqipen në ekran.

25 Faleminderit, dhe faleminderit Sekretarisë.

1 Ju lutem, shkojmë në fund të dokumentit, tek shqipja.

2 Dëshmitar, pikë së pari, e njihni nënshkrimin në këtë  
3 dokument?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I kujt është?

6 PË. Komandanti i zonës, Remi.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim lart shqipen. Ju  
8 lutem lexoni vetëm paragrafin e parë, dhe mbajeni parasysh  
9 sepse do t'ju bëj një pyetje.

10 PË. Po, urdhno.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, shkojmë në provën me  
12 numër P22 -- [Mikrofoni çaktivizuar].

13 Do jua tregoj dhe faqen e plotë në shqip, por dhe kjo  
14 duket se është një amnisti për disa persona që kanë qenë të  
15 ndaluar në zonën operative të Llapit të UÇK-së, ka datën 31  
16 dhjetor 1998.

17 Shkojmë më poshtë në të dyja gjuhët, ju lutem.

18 Edhe kjo i atribuohet komandantit së zonës operative të  
19 Llapit. E njihni nënshkrimin në këtë dokument?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është i Remit, apo jo?

22 PË. Unë mendoj se po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shkojmë përsëri sipër  
24 në dokument.

25 Sipas këtij vendimi, amnistia për këta katër persona

1 është mbështetur në rregulloren e UÇK-së, komunikatat e  
2 Shtabit të Përgjithshëm, rregullores së administrimit civil,  
3 si dhe në bazë të vendimit të komandantit të zonës operative  
4 të Llapit, 001 thotë këtu. E shihni?

5 PË. Po, e shof.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër,  
7 në të dyja gjuhët.

8 E shihni që kjo ka lidhje me amnistinë e mëparshme. Në  
9 fakt, është vendimi për zbatimin e dokumentit të mëparshëm.  
10 Edhe ky dokument mban datën 31 dhjetor 1998, dhe është një  
11 vendim për t'i liruar Mujë Zejnullahun, e shihni?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në fund të faqes.

14 A mund ta konfirmoni që dhe ky është një vendim i lëshuar prej  
15 komandantit të zonës?

16 PË. Jo. Nuk -- nuk po mund ta njof si nënshkrim i tij. Mendoj  
17 është dhanë shumë -- të mund ta krahasoj në kuadër të  
18 nënshkrimit, çfarë e ka Remi. Nuk jam i sigurt.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por, sidoqoftë, pajtoheni  
20 që ky është një dokument që i atribuohet një komandanti, dhe  
21 nëse shohim në krye të faqes, këtu thotë, "komandanti i  
22 zonës".

23 PË. Sigurisht se po, është dokumenti, por nënshkrimi s'po  
24 mund ta njoh si të tij. Nuk ka -- me i krahasue me formën  
25 çfarë ka nënshkrimi, tash, sa di unë, zakonisht kur një dikush

1 tjetër e ban nënshkrimin për autoritet, thotë, "për" autoritet  
2 edhe nënshkrun. Edhe me emër, mbiemër edhe nënshkrimi. Këtu  
3 nuk mund ta identifikoj, ndoshta ka mujt shpejt me nënshkrue,  
4 por nuk po më duket sikur nënshkrimi i komandant Remit.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ka problem.

6 Atëherë, paragrafi i parë thotë:

7 "Në bazë të Rregullores së Brendshme të Ushtrisë  
8 Çlirimtare të Kosovës, komunikatave të Shtabit të  
9 Përgjithshëm, Rregullores së Administrimit Civil, si dhe në  
10 bazë të vendimit 001 të komandantit të zonës operative."

11 Pajtoheni me këtë?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do ju tregoj dhe  
14 dokumentin e fundit. Është dokumenti SITF00242574.  
15 Faleminderit.

16 Ky është një dokument i panënshkruar, por pretendohet se  
17 është lëshuar prej zonës operative të Llapit të Shtabit të  
18 Përgjithshëm të UÇK-së. Ka një numër, por jo datë. Ka lidhje  
19 me disa persona, unë do të lexoj disa syresh për një çast.

20 Por në paragrafin e parë thuhet kështu, që amnistia që  
21 është lëshuar për këta persona, është:

22 "Bazuar në memorandumet politike të Shtabit të  
23 Përgjithshëm, Rregulloren e Brendshme të UÇK-së, Rregulloren  
24 mbi Administrimin Civil" dhe me vendim të komandantit të zonës  
25 operative të Llapit, ai shpall amnistinë për personat si në



1 vijim.

2 Së pari do t'ju bëj këtë pyetje.

3 Shkojmë në fund të dokumentit që të duken të gjithë  
4 emrat.

5 Njihni ndonjë prej personave në këtë dokument? Dhe më pas  
6 është dhe një faqe tjetër.

7 PË. Nuk i kam njoft në atë kohë. Por që gjatë procesit të --  
8 kam, disa nga ata më kujtohen, kështu si emra që janë përfol.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, mund të na thoni  
10 cilat emra?

11 PË. Për shembull, ky Rakovica, më kujtohet, kështu. Vetëm si  
12 emër --

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Numri 3 apo numri 4?

14 PË. Nuk tash ta dalloj, por si mbiemër. Potera më kujtohet si  
15 mbiemër, por -- Enver Sekiraqa, më kujtohet, po. Këta. Gjatë  
16 procesit këtu, ma tepër --

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ndonjë nga këta e ke  
18 njohur personalisht asokohe?

19 PË. Vetëm Enverin e kam njoft.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Hetem Jasharin, e ke  
21 njohur?

22 PË. Jo. Nuk më kujtohet.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ke pas ndonjë kontakt  
24 mbase luftës ose më saktë, para, gjatë ose mbas luftës me këtë  
25 person?

1 PË. Me cilin?

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Hetem Jasharin.

3 PË. Jo, s'më kujtohet.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse unë do ju thoja që ju  
5 keni shkuar bashkë në Kroaci, do të ishte e pavërtetë?

6 PË. [E pakuptueshme] s'po e di kush është. Jo, s'kam. Pse të  
7 shkoj në Kroaci unë me të? Çfarë rrethanash?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse dikush do thoshte që  
9 ti në të vërtetë ke shkuar, atëherë kjo është e pavërtetë.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Të jemi të drejtë me dëshmitarin,  
11 t'i japim panoramën e plotë të situatës. Këto janë pyetje që i  
12 ka bërë Prokuroria -- më falni, nëse do i bënte Prokuroria  
13 këto pyetje, unë do t'i kisha kundërshtuar, por të jemi të  
14 drejtë. Nuk mund t'ia bëni të tillë pyetjen.

15 Që të thotë ai që është një gënjeshtar personi që e ka  
16 thënë, duhet të dijë të plotë se çfarë është thënë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë nuk po them që gënjen  
18 Dëshmitari, por besoj se ju e dini se ç'përmbajnë transkriptet  
19 e këtij procesi gjyqësor. Dhe për t'ju ndihmuar, unë po  
20 mbështetem në faqen 3376 e në vijim të këtij procesi gjyqësor,  
21 një prej asistentëve tuaj mund t'ju ndihmojë dhe do ta shikoni  
22 që është bërë një pyetje, [REDAKTUAR] lidhur me këtë.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk po më kuptoni. Nuk ka lidhje a e  
24 di unë, sepse unë e di, por nuk e di dëshmitari. Këtë po  
25 përpiqem të them unë.

1 Unë po them, t'i japim të plotë panoramën dëshmitarit --

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Dixon, e vendos unë se  
3 çfarë do të them. Nëse ti mendon se do të jesh më i drejtë me  
4 dëshmitarin dhe do t'i japësh kontekst më të plotë, atëherë  
5 jepja kontekstin atij kur të kesh radhën për t'i bërë pyetjet  
6 pas pyetjeve tona.

7 Aktualisht, unë nuk po i them dëshmitarit që na ka  
8 gënjyer lidhur me z. Hetem Jashari. Unë thjesht po i bëj një  
9 propozim për diçka që kemi dëgjuar në këtë sallë gjyqi. Nuk ka  
10 asnjë problem për mua nëse e pranon apo jo dëshmitari, është e  
11 drejta e tij.

12 Z. DIXON: [Përkthim] E kam të qartë, por unë po them që  
13 dëshmitari duhet t'i kishte rrethanat e plota për këtë  
14 situatë.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mbështes dhe unë  
16 parashtrimet e z. Dixon sepse sugjerimi është që kemi pasur  
17 një dëshmitar tjetër të cilin ju po e përdorni për bazë që me  
18 sa duket nuk ka thënë të vërtetën. Mbështes parafolësin.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Alagendra, para se të  
20 bëni këtë sugjerim, lexoni transkriptin. Unë nuk po them që  
21 dhe dëshmitari tjetër ka gënjyer. Është diçka që i kanë thënë  
22 dhe atij dëshmori [Sipas përkthimit].

23 Unë nuk kam problem lidhur me deklaratën e këtij  
24 dëshmitari. Nëse ju keni pyetje të mëtutjeshme, mund t'i bëni  
25 kur t'ju vijë radha, por tani është momenti i pushimit.

1 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Por duket sikur po  
2 përpigëni të merrni dëshmi nga ky dëshmitar lidhur me një  
3 dëshmi që dha një dëshmitar tjetër.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
5 znj. Alagendra. Do bëjmë pushimin e drekës.

6 Dëshmitar, tani kemi një orë e gjysmë pushim. Do  
7 rikthehemi në orën 14.30 në sallën e gjyqit. Ju lutem, mos  
8 flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshminë tuaj.

9 Mund të largoheni tani nga salla.

10 DËSHMITARI: Faleminderit.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim  
13 deri në orën 14.30.

14 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

15 --- Seanca rifillon në orën 14.30

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,  
17 ju kërkuat fjalën në fakt më përpara.

18 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. Dhe  
19 lidhja me çështjen që diskutuam me Gjykatësin Mettraux,  
20 pyetjen, pra, që po bënte Gjykatësi përpara pushimit. Thjesht  
21 dëshiroja që të sqaroja se mund të kishte patur paqartësi, që  
22 Gjykatësi Mettraux dhe në faqen 78, rreshti 6 të transkriptit,  
23 thuhet që "një pyetje që ka të bëjë me pyetjen e [REDAKTUAR]".

24 Dhe thjesht që të jemi të qartë, është një gjë, unë pata  
25 mundësinë që ta shikoja, e ka ngritur vetë dëshmitari, nuk i

1 është kërkuar atij gjatë kohës që ka qenë duke dhënë dëshmi.

2 Thjesht doja ta sqaroja.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptova.

4 Faleminderit.

5 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se

8 erdhët sërish, Dëshmitar. Ju falënderojmë për durimin tuaj

9 sepse ka qenë një kohë e gjatë. Por ju falënderojmë që

10 vazhdoni të jeni me ne.

11 Tani do të vijojmë me pyetjet e Gjykatësit Mettraux. A na

12 dëgjoni mirë?

13 DËSHMITARI: Po, mirë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Faleminderit.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar,

17 faleminderit për durimin edhe një herë. Pothuajse kemi arritur

18 në fund të pyetjeve.

19 Dëshiroj që për pak çaste t'i rikthehem, t'u rikthehem

20 katër vendimeve për amnisti që pamë në ekran dhe që diskutuam

21 përpara pushimit. I mbani mend ato, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në ekran do të doja që

24 të vendosej ndonjëra prej tyre sa për ilustrim. Do t'i lutesha

25 Sekretarit të seancës që në njëherë anë të ekranit të kemi

1 provën P885 në anglisht dhe P150 në anën tjetër, që është i  
2 njëjti dokument por në gjuhën shqipe.

3 Kam dy propozime që dëshiroj t'ju them dhe mund të bini  
4 dakord ose të mos bini dakord me to.

5 E para është: Ju jeni dakord që ky dokument, ky vendim  
6 ose amnisti apo vendimet e tjera dhe amnistitë e tjera që ju  
7 kemi treguar vërtetojnë ose mbështetin sugjerimin tuaj që  
8 komandanti i zonës kishte autoritetin për të liruar personat  
9 që ishin ndaluar nga UÇK-ja brenda zonës? Pajtoheni me këtë?  
10 PË. Po, pjesërisht. Me shpjegim se lirimi është, ka ndodhë në  
11 disa kohë simbolike, them ashtu, është Viti i Ri, para Vitit  
12 të Ri, domethënë dhe çështja tjetër është një festë me siguri  
13 që koïncidon më këtë datën tjetër çfarë ishte janari 17, po.

14 Dhe nuk ka qenë krejt në autoritetin e tij, por që  
15 propozimet kanë qenë për aspektin e garancive që kanë ardh që  
16 ata persona që kanë qenë të mbajtur për disa ditë, ju kanë, në  
17 një formë, kanë kalu ato fazat e arsyeshmërisë së mbajtjes.  
18 Edhe komandanti i zonës, komandant, domethënë, me autoritet ka  
19 veprue konform asaj.

20 Sikur një ekuivalencë mes, kur bëhet amnistia prej  
21 presidentit çdo jipen rekomandimet nga dikush. Unë tash po e  
22 bëj një krahasim, presidenti i shtetit kur bën një amnisti,  
23 atëherë vijne rekomandimet nga stafi profesional me kuptim të  
24 rekomandimeve për amnisti të caktuara që ka pas efektin e vet.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju keni thënë dhe për

1 të përdorur fjalët tuaja, disa prej këtyre amnitive janë  
2 vendosur "në momente simbolike të vitit". A keni dijeni që  
3 edhe Shtabi i Përgjithshëm ka lëshuar amnisti të tilla në  
4 momente simbolike të vitit?

5 PË. Jo, nuk kam njohuri për këtë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani duke parë dokumentin  
7 që keni përpara, a do të ishit dakord me sugjerimin, që duke  
8 patur parasysh paragrafin e parë autoriteti i komandantit të  
9 zonës për të liruar të ndaluarit e UÇK-së, rrjedh nga  
10 deklaratat e Shtabit të Përgjithshëm dhe rregullore të tjera  
11 të cilat janë miratuar nga Shtabi i Përgjithshëm? Jeni dakord  
12 me këtë?

13 PË. Po ajo është në, them, pranë preambulën apo në hyrje të  
14 asaj. Unë vetëm e shoh si referencë. Kështu që është çështje  
15 që është këtu si në dokument.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani  
17 dëshiroj t'ju pyes në lidhje me një lirim specifik për të  
18 cilën ju është bërë pyetje, lirimin e inspektorit serb ose një  
19 inspektori me etni serbe, Goran Zbilic. E mbani mend që ju  
20 është bërë kjo pyetje në veçanti nga z. Misetić?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thjesht që të jemi të  
23 qartë, ju personalisht keni qenë i përfshirë në procesin e  
24 lirimimit të z. Zbilic?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju keni parë ndonjëherë  
2 ndonjë vendim me shkrim që kishte të bënte me lirimin e tij?  
3 PË. Po kur them a kam qenë pjesë e lirimit, po kam qenë pjesë  
4 e bisedimeve, të them, për lirimin e tij ngase ka ekzistuar  
5 kërkesa e z. Adem Demaçi, pra, lidhur me këtë. Edhe ju kam  
6 referu asaj që këtë person e kam njohur.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë më lejoni ta bëj  
8 pyetjen në këtë formë. A dini ju se me kë ka biseduar Adem  
9 Demaçi në mënyrë që të lirohej Goran Zbilic në veçanti a keni  
10 dijeni që ai të ketë folur me Shtabin e Përgjithshëm?

11 PË. Jo, nuk kam këtë njohuri. Po e di se ka folur me komandën  
12 e zonës, me komandantin edhe pjesëtarë tjerë dhe ndër ta dhe  
13 me mua.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a keni dijeni për  
15 faktin që disa anëtarë të caktuar të Shtabit të Përgjithshëm  
16 kanë qenë të përfshirë në procesin e lirimit të z. Zbilic,  
17 keni dijeni për këtë?

18 PË. Jo.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dëshiroj t'ju pyes në  
20 lidhje me dy emra. Edhe nëse një herë nëse mund të ndihmoni do  
21 t'ju isha mirënjohës. Në rast se jo, në rregull. Por në janar  
22 të vitit 1999, në kolegët tuaj të UÇK-së a mbani mend dikë me  
23 emrin ose me mbiemrin Belul ose Beluli, e mbani mend dikë me  
24 këtë emër ose mbiemër?

25 PË. Jo.



1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk e njihni Ramadan

2 Belulin ose Belul Limajn, për shembull?

3 PË. Jo.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po mbiemrin Murati? A keni  
5 patur në janar të vitit 1999 një bashkëluftëtar të UÇK-së me  
6 këtë emër?

7 PË. Me mbiemrin Murati jo. Po emrin Murati po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a mund të na jepni  
9 emrin e atij personi zotëri?

10 PË. Murat Ajeti.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a keni dijeni, a  
12 njihni individë me emrin Valon Murati dhe Skënder Murati, a i  
13 njihni këta persona?

14 PË. Valon Muratin po. Skënder Murati s'po kujtohet që e njoh.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a mund të na thoni se  
16 çfarë pozicioni ka patur Valon Murati në janar të 1999, nëse e  
17 dini?

18 PË. Po sa di unë, Valon Murati është prej një lëvizje për  
19 lirinë e Kosovës, LKÇK-së, sa e mbaj mend unë. Edhe ai ka qenë  
20 një udhëheqës i sektorit, nëse nuk gaboj, për moral edhe për  
21 moral. Ashtu sa kam mbajtur mend unë, pra, për atë e di  
22 saktësisht. Sektorit për moral.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kur thoni sektorin e  
24 moralit, e keni fjalën për pjesën e komandës së zonës së  
25 Llapit.

1 PË. Po. Dhe ai ka qenë një kohë të caktuar, nuk ka qenë  
2 gjithë kohën, them ashtu, në atë pozicion.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini nëse ka përdorur  
4 ndonjë nofkë në atë kohë?

5 PË. Jo, nuk di.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, zotëri për  
7 durimin tuaj. Dhe këto ishin pyetjet që kisha.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
9 Gaynor.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

11 Së pari, dëshiroj që të merrem me pjesën e "sektorit të  
12 zbulimit dhe kundërzbulimit".

13 Prandaj i kërkoj Sekretarit, që në ekran të vendosë  
14 dokumentin P1765 dhe të na tregojë faqen e parë të këtij  
15 dokumenti në gjuhën shqipe dhe në atë angleze.

16 A kam të drejtë që e kam kuptuar që ky është formati i  
17 informacionit të brigadës që është sjellë nga shtabi në zonën  
18 e Llapit nga komandant Remi?

19 PË. Tash s'muj në mënyrë specifike, por e di që është sjellë  
20 në atë zonë. Tash nuk mund t'i referohem saktësisht a  
21 komandant Remi apo dikush tjetër, po kryesore që këtë formë ka  
22 ekzistuar në atë Zonën Operative të Llapit.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe synimi, besoj, ka qenë  
24 që Shtabi i Përgjithshëm, pra, synimi i tyre ka qenë që ky  
25 organigram të ndiqej nga të tjerët nga komandantët e zonave,

1 nga komandat e zonave?

2 PË. Po, supozoj se po.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sekretarit të seancës i  
4 kërkuj që të na zmadhojë dokumentin për të na treguar kutinë e  
5 tretë në anën e majtë, pra, të tretën në të majtë dhe të  
6 tretën nga poshtë.

7 A mund të lexoni në gjuhën tuaj se çfarë është në këtë  
8 kuti të tretë nga e majta?

9 PË. Po. "Sektori i zbulimit dhe kundërzbulimit."

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A përputhet kjo me  
11 shkurtimin ZKZ?

12 PË. Po mvaret në kuptim të asaj se çfarë, domethënë,  
13 akronimet në çfarë kuptimi janë përdorë. Megjithëse, nëse  
14 bëhet një komperacion, nëse flasim për sektorë në nivel të  
15 brigadës edhe zonës, ky sektor dallon ngase në organogramën e  
16 zonës operative apo zonave nuk është sektori i zbulimit dhe  
17 kundërzbulimit, po është sektor i shërbimit informativ. Ndërsa  
18 këtu figuron si sektor i zbulimit dhe kundërzbulimit. Ndërsa  
19 specifikisht nuk mund ta di se a përdoret si ZKZ akronimi,  
20 domethënë, në çfarë konteksti të pyetjes i drejtohem. Këtu  
21 thotë sektori i zbulimit dhe kundërzbulimit.

22 I referoheni ndonjë dokumenti apo? Unë zakonisht kështu e  
23 kam hasur në këtë organogramë edhe kjo është.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen e  
25 katërt në të dyja gjuhët. Sekretarit i kërkuj që të

1 përqendrohet tek kutia e tretë në të majtë në origjinalin në  
2 gjuhën shqipe.

3 Dëshmitar, kjo në dukje është një organigramë i komandës  
4 së zonës dhe njësive apo sektorëve që raportonin aty, është e  
5 saktë kjo?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të lexoni se çfarë  
8 thuhet në kutinë e tretë në gjuhën tuaj mbi tek fjalët "Latif  
9 Gashi"?

10 PË. "Shef sektor pasi zbul edhe ajo, domethënë, plus kundër".  
11 Në kuptim të asaj të akronimit për shkak se të katrorit që  
12 s'ka mund të përfshijë komplet fjalët janë përdorur vetëm  
13 pjesë të fjalës në aspektin e përkufizimit të katrorit ku  
14 është shkruar teksti.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, a do të ishte e drejtë  
16 të thonim që kjo kuti do të thotë: "Shef sektorit të zbulimit  
17 dhe kundërzbulimit".

18 PË. Po. Vetëm se --

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A do të ishte e drejtë të  
20 thonim që fjalët inteligjencë dhe kundërinteligjencë janë,  
21 pra, zbulim dhe kundërzbulim siç duken këtu?

22 PË. Po, mund të jetë ashtu. Tash --

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Qëndrojmë tek ky organigram.  
24 Latif Gashi a ju raportonte ju në formë të drejtpërdrejtë si  
25 shef i shtabit apo raportonte te zëvendës komandanti i zonës

1 apo komandanti i zonës? Nuk është shumë e qartë nga kjo  
2 organigramë.

3 PË. Po tash shtabi ka filluar të funksionojë, pra, me ardhjen  
4 time për shef të shtabit dhe zëre kemi thënë që jemi takue në  
5 komandën e zonës. Komanda e zonës ka nënkuptue edhe shtabin,  
6 pra, me këtë dua të them se dhe komandanti i zonës dhe  
7 zëvendëskomandanti dhe shefi i shtabit kanë qenë së bashku me  
8 udhëheqësit e sektorit edhe sistemin e pavarur të, them  
9 kështu, të brigadave dhe njësive vartëse.

10 Pra, shtabi nënkupton edhe sektorët për të cilët ju po e  
11 drejtoni pyetjen.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kush raportonte Latif Gashit  
13 si shef sektori zbulim kundërzbulimit?

14 PË. Kush i raportonte? Kujt i raportonte -- se pyetja s'u bë  
15 mirë. Kujt i raportonte?

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Jo, jemi marrë me çështjen  
17 kujt i raportonte ai.

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po kush i raportonte atij,  
20 Latif Gashit?

21 PË. Po, Latif Gashit i raportonin, domethënë, këta -- ka pas  
22 dhe zëvendësin, Hyzri Tallën që këtu nuk figuron pasi që ai  
23 është vra në dhjetor të vitit 1998. Ndërsa i raportonin edhe  
24 persona, gjegjësisht, këta që i kishte nëpër zonat, pra, nëpër  
25 brigada që ishin shefat e zbulimit dhe kundërzbulimit. Veç i

1 raportonin komandantit të brigadës, normal, në vijën

2 sektoriale i kanë raportu edhe Latif Gashit.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, u përqendruat në një

4 çështje tek e cila jam shumë i interesuar.

5 Në rast se në nivel brigade komandanti i ZKZ-së, që tek

6 151 ishte Sabit Rrahimi, në rast se ai kishte dy vija

7 raportimi, një tek komandanti i brigadës, tjetra në nivel zone

8 tek komandanti i ZKZ-së, a mund të na shpjegoni, ju lutem,

9 çështjet për të cilat raportonte tek komandanti i brigadës dhe

10 çështjet për të cilat raportonte tek shefi i ZKZ-së, pra në

11 nivel zone që do të thotë Latif Gashi?

12 PË. Po, normal në aspektin e punëve të përditshme i

13 raportonte, domethënë, z. Sabit i raportonte komandantit të

14 brigadës. Ndërsa në kohëra të caktuara kur kish një interes më

15 madhor, pra, në interes të zonës i raportonte edhe shefit të

16 këtij sektori, pra, për këtë arsye them raportimi ishte i dy

17 anshëm në vijën komanduese ku ishte Sabit Rrahmani aty i

18 vendosun, Rrahimi. Por edhe në nivelin e një interesi të

19 përgjithshëm për forcat serbe për gjithë ato që kishin një

20 nevojë për një njoftim më të përgjithshëm atëherë raportonte

21 edhe shefit, pra, të sektorit nivel të komandës së zonës.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të qëndrojmë me komandën

23 e zonës për momentin.

24 Dhe, ndoshta, Sekretari i seancës mund të na e tregojë të

25 gjithë organigramën.

1 Dhe shikojmë që Nazif Mehmeti është pjesë. A mund të na  
2 thoni se kujt i raportonte ai, Nazif Mehmeti, komandanti i  
3 policë ushtarake?

4 PË. Pra, ai i raportonte sipas rastit, pra, kur kishte nevojë  
5 i raportonte shefit të shtabit, zëvendëskomandantit të zonës  
6 edhe komandantit të zonës në aspektin që pasi që shihet lidhja  
7 direkte me lartë. Edhe kjo ishte aspekti i raportimit të tij,  
8 pra, sipas nevojës. Them, nuk ishte anëtar i rregullt i  
9 shtabit, por them sipas nevojës kur ai kërkonte për pranim  
10 edhe vinte raportonte në nivel të shtabit, gjegjësisht,  
11 komandës së zonës.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa shpesh organizonte takime  
13 komandanti i zonës gjatë kohës që keni qenë ju anëtar i saj?

14 PË. Po aty mvarësisht prej zhvillimeve në front edhe nevojave  
15 për takim. Ai caktonte edhe brenda muajit disa takime, pra,  
16 mvarësisht prej aspektit të situatës, por nganjëherë edhe më  
17 rrallë, të them, brenda muajit apo më shumë muajve, jo brenda  
18 muajit edhe ndoshta edhe më rrallë bëheshin takime në nivel të  
19 komandës të zonës. Po dua të them që brenda muajit nganjëherë  
20 kur kishte situata të ndryshme u bëjshin takimet. Por  
21 nganjëherë edhe më shumë se një muaj u bënin takimet, pra, kur  
22 nuk kishte zhvillime të operacioneve luftarake apo nevoja për  
23 një thirrje të takimit.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse komandanti i policisë  
25 ushtarake ose komandanti i ZKZ-së do të kishin një informacion

1 i cili ishte shumë i rëndësishëm nga aspekti i zbulimit  
2 kundërzbulimit, pra, ku e merrnin ata, si do t'ia çonin atë me  
3 shpejtësi komandantit të zonës?

4 PË. Po ato janë raste -- ato raste janë të veçuara. Kur  
5 detyrimisht nëse ka një rrjedhim të menjëhershëm që mund të  
6 ketë pasoja të rënda, automatikisht, pra, informacioni shkonte  
7 në nivel të shtabit apo komandës së zonës. Pra krejt mvaret se  
8 sa ishte ajo me urgjencë. Në disa raste nuk mund të pritej një  
9 takim i radhës, por nganjëherë informacioni duhet të shkonte  
10 shumë shpejt në atë drejtim që të ndërrojmë masa përgjegjëse.

11 Për këtë arsye në aspektin, në këtë aspekt dhe  
12 organigrama tregon sistemin edhe horizontal edhe vertikal të  
13 komunikimit, pra edhe sektorëve edhe të njësive, them, mvarëse  
14 të komandës së zonës ku janë edhe brigadat edhe njësi tjera  
15 varëse.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Çfarë mënyrash komunikimi  
17 përdornit ju për të marrë informacion urgjent, me urgjencë nga  
18 policia ushtarake ose ZKZ-ja?

19 PË. Po ne i kishim të gjitha në funksion të mundshëm. Ne nuk  
20 kemi kry një detyrë specifike, të them, je komandanti shtabit  
21 apo shef i shtabit, je komandant i zonës, zëvendëskomandant  
22 apo je udhëheqësi i një sektori apo brigade, detyra jonë  
23 permanente është të mbledhësh informacione gjithandej.

24 Unë, si shef i shtabit, kam pas edhe detyra të përgjoj  
25 forcat serbe dhe ato i kam përgjue nëpërmes një sistemi



1 specifik të radiolidhjeve. Gati çdo operacion luftarak apo  
2 ofensivë apo ndërmarrje e kam zbulue. Dhe kjo nuk ka qenë  
3 detyrë specifike vetëm e atyre. Pra, ne kemi kry edhe punë të  
4 tjera që ndërlidhen me shërbime tjera të sektorëve sikur  
5 logjistika, sikur aspekti i shërbimeve tjera që ndoshta  
6 specifikisht nuk janë të lidhura me pozitën çfarë e ke këtu në  
7 organogramë.

8 Për këtë arsye detyra dhe mbledhjes, analizës së  
9 informacionit ka shkuar në një proces të përshpejtuar më për  
10 shkak që ne ishim në luftë dhe ishim çdo herë në kontakt me  
11 kontakt luftarak, them, me forcat e armikut. Dhe çdo vonesë  
12 kishte me pas pasoja të paparashikueshme. Për këtë arsye,  
13 informacionet mirren gjithandej nga të gjithë struktura  
14 ushtarake dhe normal që ndonjëherë vinte deri sistemi i  
15 këmbimit të informacionit nga të gjitha nivelet e komandimit.

16 Edhe normal aty ku ishte rreziku permanent për një  
17 ofensivë apo një operacion të caktuar nga forcat e armikut,  
18 ndërmerrej masa me qëllim që të jenë të gatshëm për me ju, për  
19 kundërvënie.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rast se ju do të merrnit  
21 informacion nëpërmes kësaj strukture që shpjeguat, një  
22 informacion që do të ishte veçanërisht i rëndësishëm, si do  
23 t'ia përçonit këtë informacion sa më shpejt që të ishte i  
24 mundur Shtabit të Përgjithshëm?

25 PË. Po ato ishin në -- kur ishte informacioni, unë e lidhi më

1 shumë me kompetencat e zonës çfarë i kishim edhe s'kam pas  
2 ndonjë rast që të veçuar që mund të them t'i këmbenim me  
3 Shtabin e Përgjithshëm. Mirëpo edhe nëse ka ekzistuar ajo,  
4 atëherë ka qenë komandanti i zonës ai të cilët ju ka dërgu  
5 informacione dhe ai e ka kaluar, gjegjësisht, e ka përcjellë  
6 deri në Shtabin e Përgjithshëm.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dëshiroj që të kalojmë në  
8 faqen e tretë të këtij dokumenti. Ky është një organigram i  
9 Brigadës 151 dhe këtu është edhe emri juaj si komandant  
10 brigade. Pyetjet që do t'ju bëj kanë të bëjnë me atë periudhë  
11 kohore kur ju keni qenë komandant i Brigadës 151.

12 Ju na keni shpjeguar vijat e raportimit nga ZKZ-ja, nga  
13 shefi i sektorit të ZKZ-së në nivel brigade. Pyetjet e mia  
14 kanë të bëjnë tani me policinë ushtarake dhe komandantin e  
15 policisë ushtarake në nivel brigade dhe emri i tij është Naip  
16 Gubetini këtu.

17 A mund të më thoni nëse ai ju raportonte ju si komandant  
18 brigade apo nëse ai i raportonte komandantit të policisë  
19 ushtarake në nivel zone të cilën e pamë në organigramën e  
20 mëparshme?

21 PË. Po raportimi i përhershëm apo permanent ishte në raport  
22 me mua apo zëvendësin tim, zëvendësi i komandantit të  
23 brigadës. Ndërsa me policinë ushtarake në nivel të zonës ishte  
24 sipas nevojave, pra, apo nevoja të dyanshme të policive, të  
25 policisë ushtarake edhe të brigadës por në raport me komandën

1 e zonës. Edhe për këtë arsye e përmbledh, që raporti ka qenë i  
2 dyanshëm, mirëpo permanent ka qenë me komandën e brigadës, në  
3 këtë rast, komandantin e brigadës, unë dhe zëvendësin tim Arif  
4 Muçollin, Profën.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Çfarë, me çfarë mjeti, çfarë  
6 teknologjie keni përdorur ju për të folur me Naip Gubetin  
7 kur ishit ju komandant brigade dhe ai ishte komandant i  
8 policisë ushtarake, me çfarë mjeti keni folur?

9 PË. Po ai ishte në afërsi, me përqendrim me zyre ishte në  
10 afërsi të komandës së brigadës dhe komunikimi ishte, them,  
11 gati fizik, përveç një largësie kështu shumë të afërt.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kush i raportonte  
13 komandantit të policisë ushtarake Naip Gubetini - më falni -  
14 kujt i raportonte Naip Gubetini?

15 PË. Më raportonte mua apo zëvendësit tim, Arif Muçolli, kur  
16 nuk isha unë dhe pasi që kryjshin dhe shërbime të tjera, në  
17 këtë rast, si shef i operativës, atëherë mua ose  
18 zëvendëskomandantit të brigadës.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ishte  
20 kush i ka raportuar Naip Gubetinit sa ka pasur -- kë ta pasur  
21 në varësinë e vet, sa njësi ka pasur?

22 PË. Po ai ka pas shumë, si me thënë, një grup të vogël.  
23 S'mund të them ta përkufizoj me numër pasiqë ka kalu koha, po  
24 një grup ndoshta tre-katër vetë, mendoj ashtu, kanë kryer  
25 detyrën e policisë ushtarake. Ky ka qenë si udhëheqësi i tyre.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si kontaktonit ju me Sabit

2 Rrahimin, si i mbanit kontaktet me Sabitin ju?

3 PË. Por kontakti ishte në bazë të nevojës për ofrim të këtij

4 informacioni apo në kërkim të një informacioni të caktuar. Ai

5 kryente detyrat e veta dhe në momentin kur vinte deri te një

6 informacion që ishte me interes për rajonin, gjegjësisht, e

7 përgjegjësisë së brigadës, ai më informonte menjëherë me

8 qëllim që të ndërmarim masat e menjëhershme për në aktualitet

9 për t'ju kundërpërgjigj një rreziku apo kërcënimi të mundshëm.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Çfarë teknologjie përdornit

11 për të kontaktuar me të?

12 PË. Shumicën e rasteve kontakt fizik, ngase ai ishte afër me

13 bazim afër shtabit të Brigadës 151.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani dua të flas tek

15 problemi serioz i personave që përcaktoheshin si

16 kolaboracionistë dhe për këtë dua të shohim dëshminë që ke

17 dhënë para disa ditësh, është transkripti i 24 tetorit 2024,

18 faqja 39 e transkriptit provizor. Ju na e thatë sesa e rëndë

19 ishte kjo. Dhe thatë:

20 "Në kuadër të detyrimeve të Zonës Operative të Llapit nën

21 Mbrojtjen Civile të kësaj zone, ne kishim përgjegjësinë për

22 t'i mbrojtur personat atje nga kolaboracionistët e armikut

23 sepse qysh në vitet 1990 shërbimet e zbulimit dhe policia

24 serbe krijuan një rrjet kolaboracionistësh. Dhe për këtë

25 arsye, ky vendim u la tek Mbrojtja Civile dhe me kërkesën e

1 tyre sa u takon disa personave që bashkëpunonin me strukturat  
2 pushtuese serbe apo me forcat serbe, kështu ata identifikuan  
3 disa persona. Procedura ishte e atillë që të kalonte nga  
4 komandanti i brigadës, policia ushtarake e deri poshtë në  
5 qendrën e ndalimit në Lllashticë.”

6 Ju kujtohet kjo dëshmi?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani mua më intereson të di  
9 se si vlerësohej, çfarë procesi, domethënë, ndiqej nga  
10 mbrojtja civile dhe si garantohej që personi që ishte  
11 identifikuar si kolaboracionist nga mbrojtja civile ishte  
12 vërtetë i atillë. Domethënë, a mund të na shpjegoni fillimisht  
13 çfarë procesi është ndjekur për të verifikuar nëse vërtetë  
14 dikush ishte kolaboracionist apo jo?

15 PË. Po. Së pari, në kuadër të lokaliteteve, çdo fshat ka pas  
16 mbrojtjen civile edhe ajo është kujdes për popullatën edhe  
17 normal përkrahjen tonë. Se nuk i kem njoft njerëzit. Pra,  
18 komanda me zonat, bashkëpunëtorët, kolaboracionistët, mirëpo  
19 popullata civile, nëpërmes qytetarët në atë lokalitet,  
20 nëpërmes mbrojtjes civile që u krijua, kanë qenë të njohur në  
21 bashkëpunim, pra, si bashkëpunëtorë të forcave të armikut edhe  
22 të policisë edhe të shërbimit inteligjent edhe këta i kanë  
23 identifikuar.

24 Që të mos krijohet anarki edhe ata të ndërmarrin veprime,  
25 pra, hakmarrëse ndaj tyre, këtyre kolaboracionistëve, që ishte

1 rrezik i madh për krijimin e një anarkie të tillë. Atëherë u  
2 desh të ndërmirren hapa që kjo njësi të sanohet edhe pra dhe  
3 identifikimi ka shkue nëpërmes qytetarëve dhe mbrojtjes civile  
4 duke e njoftue, normal, pra, brigadën që ishte përgjegjëse për  
5 atë rajon. Dhe mandej, ata procesun në drejtim të policisë  
6 ushtarake në nivel të zonës. Dhe mbahen për disa ditë duke,  
7 normal, duke u komunikuar arsyen e mbajtjes. Edhe kur  
8 përfundonin arsyet për mbajtjen e tyre, ata u lironin. Kjo  
9 ishte një procedurë sa mujta shkurtimisht t'jua përshkruaj.

10 Ishte jo një situatë ashtu e lehtë për neve ngase nga një  
11 përgjegjësi. Por realiteti është se rreziku më i madh është  
12 nëse fillonte një hakmarrje ndaj atyne bashkëpunëtorëve që  
13 ishin identifikuar me vite si bashkëpunëtorë të armikut dhe  
14 akoma ishin në veprim. Dhe na shkaktonin edhe neve si në  
15 misionin tonë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por kishin  
16 pasoja dhe për qytetarët, ngase nga aty rekrutoheshin ushtarët  
17 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët shumë raste kemi  
18 gjet që i kanë apostrofuar por njëkohësisht dhe në aspektet e  
19 mbështetjes logjistike dhe përqendrimit tonë.

20 Për këtë, ngase në këtë kohë ne nuk kemi pas organ tjetër  
21 përveç policisë ushtarake që, pra, as kemi pas hetuesi. S'kemi  
22 pas gjykata ushtarake, nuk kemi pas as hetues, as gjykatës, as  
23 në nivelin e strukturum të përgjegjësisë në nivel, pra, të  
24 strukturimit gjyqësor.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Të fokusohemi tek momenti

1 kur ka mbërritur një pëson i dyshuar si kolaboracionist në  
2 Llapashticë. Unë tani dua të di nëse është bërë ndonjë  
3 intervistë a ndonjë bashkëbisedim me të dyshuarin,  
4 bashkëbisedim informues pas mbërritjes në Llapashticë?  
5 PË. Po. Nuk ka pas bisedë informative, nuk ka pas intervista.  
6 Ka pas shkurtimisht një njoftim i shkurtër për arsyen e  
7 mbajtjes policore që ka qenë në diskrecion të policisë  
8 ushtarake edhe normal u ka bërë me dije që kur të pushojnë  
9 arsyet për mbajtjen ai do të lirohet.

10 Ne kemi përdor edhe metoda apo mënyra tjera me qëllim që  
11 të mos vijë deri te një, pra, përqendrim më i madh. Unë e kam  
12 rastin me një, pra, sa kam qenë komandant i brigadës me një  
13 person që, nëse është e nevojshme, na e diskutuam në seancën e  
14 para disa ditëve, ta shpjegoj. Se edhe kjo formë e një formë e  
15 kërkesës ndaj tij, që të mos bashkëpunojë, ka dhënë rezultat.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Në një nga  
17 deklaratat e mëparshëm - që mban numrin P1754, faqja 9 këtë po  
18 e themi për palët e tjera në sallën e gjyqit - ke thënë që:

19 "Keni marrë informacione që shumë të tillë u kishin dhënë  
20 informacione shumë të rëndësishme serbëve për pozicionet e  
21 civilëve por edhe për veprimet tona ushtarake."

22 Pra, këta persona që dyshoheshin si kolaboracionistë mund  
23 të kenë pasur informacione shumë delikate sidomos të  
24 rëndësishme për pikëpamjen kohore dhe këto informacione i  
25 kishin edhe kur kanë mbërritur në Llapashticë, apo jo?

1 PË. Po, sigurisht. Ata ishin aty, aty jetonin edhe, normal,  
2 komunikonin edhe me pjesën ku ishte zona, të them, akoma nën  
3 okupim nga forcat e armatosura serbe. Dhe sa shkonin atje ata  
4 kontaktonin, u jepnin informacione qoftë për pozicionimin e  
5 forcave tona, qoftë edhe për aktivitete tjera. Edhe këto, zona  
6 e jonë, flas për zonën tonë, pasi ajo ishte përgjegjësi edhe e  
7 brigadës më vonë edhe e shefit të shtabit, ka pas pasoja të  
8 rënda nga ky bashkëpunim.

9 Unë i përmenda herën e kalume, nëse ka nevojë do t'i  
10 përmendi edhe tani, vrasja e zëvendësshefit të sektorit Hyzri  
11 Talla me dy të tjerë në Prishtinë kur ka vizitu familjen apo  
12 në familje, më andej Adem Gashit, shefit të logjistikës, mbaj  
13 mend, personelit të kësaj brigade ku e keni këtu, Adem Gashi  
14 në sektorin e parë. Ai është vra gjatë vizitës së familjes së  
15 tij. Më andej kemi pas pasoja të rënda.

16 Nëse tash s'po du ta kthej në personale, ngase edhe mu më  
17 ka ndodh. Edhe, z. Shaun Byrnes, shefi i KDOM-it, ka ndërhy  
18 kur familja e ime është largue nga banesa e vet, banesa ku  
19 kanë qëndrue edhe mu ka djegë shtëpia në fshat edhe mu kanë  
20 vra shtatë familjarë, pra, kojshi edhe fqinjë të parë, ndër ta  
21 shumica fëmijë, mu për shkak të këtyre njohurive apo  
22 informacioneve që supozohet që i kanë dërguar bashkëpunëtorët.

23 Mendoj që pasojat kanë qenë të rënda. Ne jemi mundue me  
24 sa më pak pasoja të sanojmë gjendjen pasi që krejt po flas në  
25 mungesë, pra, të gjykatave ushtarake që s'i kemi pas në kohën.



1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Duke marrë parasysh pasojat  
2 shumë të rënda që sapo na përshkruat, në këto masa përfshihej  
3 marrja në pyetje e personave të dyshuar kolaboracionistë në  
4 mënyrë që ju të merrnit informacione delikate prej tyre?

5 PË. Jo.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Që mund të themi edhe sa  
7 mund të shpëtonit jetë njerëzish? Po pse jo?

8 PË. Jo, ngase s'kanë qenë ato të besueshme. Edhe këtë e kam  
9 deklaruar për të sajten herë. Edhe ne mu për atë arsye që të  
10 drejtave të tyre, gjegjësisht, shkeljes së drejtave të tyre  
11 ngase aspekti intervistës apo bisedave kishte me degraduar edhe  
12 në keqpërdorim nga policia ushtarake, për atë arsye ka qenë  
13 strikt e urdhëruar që nuk ka biseda informative, nuk ka  
14 intervista por ka vetëm njoftim për arsyen që ata thirren në  
15 mbajtje, ftohen në mbajtje edhe që do të lirohen në momentin  
16 kur po shohim rrethanat për të cilat për të cilën ata janë  
17 ftuar apo mbahen.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po atëherë, për çfarë  
19 qëllimi kishit sektorë të zbulimit dhe kundërzbulimit në nivel  
20 brigade dhe në nivel zone edhe më pas në Shtabin e  
21 Përgjithshëm nëse ju nuk kishit asnjë synim për të marrë në  
22 pyetje personat e dyshuar si kolaboracionistë, atëherë pse i  
23 kishit këto?

24 PË. Ne i kishim për të ndalë veprimin e tyre, pra, në  
25 raportim ndaj forcave të armikut. Kur na vinte një garancion

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 114

1 se ata nuk do të veprojnë, ne i lironin, ne faktikisht jua  
2 bënim me dije që qoftë familjari, qoftë dikush që garantonte  
3 se ai nuk do të bashkëpunojë me forcat e armikut, nuk do të  
4 jepte informacione më, ne ata i lironim.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] I lutem Sekretarit të  
6 paraqesë provën P1754, faqja 8, në shqip dhe faqja 9 në  
7 anglisht.

8 Z. Dëshmitar, do ju lexoj një pjesë në fund të faqes 8.  
9 Thuhet si në vijim:

10 "Kur e pyetën pse do të mbronin -- i pyetur pse do t'i  
11 mbronin bashkëpunëtorët të cilët na kanë shkaktuar aq shumë  
12 dëm, kur numri ynë ishte aq i vogël, ne kemi vendosur t'i  
13 burgosnim disa prej tyre në mënyrë që pas çlirimit të mund të  
14 gjykohen në gjykata. Gjithashtu është e vërtetë ... se kemi  
15 pasur për qëllim t'i mbajmë për arsye të sigurisë së tyre meqë  
16 atje nuk kishte autoritet tjetër. I kemi mbajtur pa marrë  
17 parasysh të shkuarën e tyre."

18 Të kujtohet ta keni thënë këtë?

19 PË. Po, saktësisht.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ju keni thënë që keni  
21 pasur njohuri të plotë për Konventat e Gjenevës dhe katër  
22 Protokollet Shtesë. Ju u mundësuar atëherë këtyre të ndaluarve  
23 që të kishin avokat?

24 PË. Nuk ishin rrethanat që t'iu mundësojmë pasi që këta u  
25 mbajtën disa ditë dhe kur i referohem Konventave të Gjenevës,

1 flas për nenin 75 që atyne i është bërë me dije arsyeja e  
2 mbajtjes, ajo ka qenë disa ditë. Edhe çështja tjetër është që  
3 ishte dhe për sigurinë e tyre se po që se ata vazhdonin të  
4 qëndronin në vendbanime ku ishin apostrofuuar si  
5 bashkëpunëtorë, rreziku ish që ata mund të atakohen nga  
6 qytetarët për shkak të këtij bashkëpunimi. Pra, një aspekt ka  
7 qenë dhe kjo.

8 Çështja tjetër është edhe e lidhur në mungesën e  
9 gjykatës, gjykatave ushtarake, ne nuk kemi ndërmarrë as  
10 intervista as veprime tjera ngase s'kemi pas kompetencë. Me  
11 këtë dua të them, që edhe aspekti i ofrimit të avokatëve nuk  
12 ka qenë i mundur ngase rrethanat kanë qenë të tilla.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po u keni dhënë ndonjë  
14 mundësi atyre ta kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të  
15 tyre?

16 PË. Po ata, normal, këta e kanë shprehur në raport me policinë  
17 ushtarake apo kur, pra, kur janë sjellë edhe kanë dhënë  
18 mundësi ofrimi me garancion edhe kjo shpesh ka rezultuar edhe  
19 me lirimin e tyre.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po u ke dhënë ndonjë mundësi  
21 ta kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre? A mund të  
22 dilnin ata para një gjykate, para një gjykatëse të thonin që  
23 mua më kanë marrë në mënyrë të paligjshme?

24 PË. Edhe një herë e thashë, na gjatë luftës nuk kemi pas  
25 gjykatë ushtarake. Ne kemi pas policinë ushtarake edhe në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 116

1 diskrecion të autorizimeve të saj është caktue kjo çështje e  
2 mbajtjes policore çfarë është zakon të bëhet. Normal që në  
3 disa raste ndoshta është shty me ditë tjera por ishin  
4 rrethanat e luftës.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në faqen 9 tek anglishtja e  
6 kësaj deklarate, keni thënë:

7 "Fakti ishte që nuk ishte pushtet, autoritet të serbëve  
8 atje po ne kishim mandatin e njerëzve për të mos lejuar  
9 anarkinë dhe ndiqnim urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm dhe  
10 komandës së zonës. Dhe organizonim që personat dhe kur  
11 personat merrnin pjesë dhe më pas - më fal - kur kemi ndaluar  
12 këta persona kemi vepruar në përputhje me vlerësimin dhe  
13 vendimet e Shtabit të Përgjithshëm dhe këtë nuk e kemi bërë  
14 bazuar në rregulla me shkrim."

15 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si ka komunikuar Shtabi i  
18 Përgjithshëm, si i ka përcjellë urdhrat, si ua ka dhënë Shtabi  
19 i Përgjithshëm urdhrat ju, urdhrat për të arrestuar dhe për të  
20 ndaluar këta persona?

21 PË. Ne nuk kemi pas, pra, unë s'ka pa në, domethënë, vendim  
22 për ndalim. Por ma vonë kam mësu për këtë. Por realiteti është  
23 se Shtabi i Përgjithshëm ka pas Komunikatën 53 lidhur me  
24 ndalimin e personave për të cilët ka ekzistue rreziku, flitet  
25 për një polici apo milicinë shqiptare që ka filluar të

1 rekrutohet. Edhe kjo ka qenë me qëllim që të parandalimit. Ne  
2 kemi marrë, ndërmarrë masa parandalimit ngase në komandën e  
3 Gjakovës dhe Deçanit ka filluar të krijohet nga autoritetet  
4 serbe pushteti serb me ministrinë e punëve të brendshme të  
5 instaluar në Kosovë por edhe me policinë serbe të krijon një  
6 strukturë të uniformuar edhe të armatosur edhe t'i kundërvihet  
7 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

8 Pra, kjo ishte në Komunikatën 53, pra, të Shtabit të  
9 Përgjithshëm dhe, normal, kemi referue për çështje të  
10 mbajtjes, pra, të aspektit të diskrecionit të zonës për të  
11 ofruar siguri edhe për strukturën ushtarake edhe civile të  
12 Zonës Operative të Llapit.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur keni ndaluar personat e  
14 dyshuar si kolaboracionistë në Llapashticë apo dhe në vende të  
15 tjera në zonën e Llapit, a e kam kuptuar unë drejt se ju  
16 besonit se po vepronit në përputhje me udhëzimet e Shtabit të  
17 Përgjithshëm?

18 PË. Po, ne kemi ndërmarrë masa, pasi që s'kemi parë asnjë  
19 urdhër strikt kështu që kam mujt me ju u referue. Na kemi  
20 veprue në diskrecion të kompetencave të zonës operative të  
21 Llapit, në kuptim të parandalonim një rrjedhim të keq në  
22 kuptimin e veprimit që këta kolaboracionistë të jenë cak i  
23 sulmit dhe siguria e tyre nga qytetarët në vendbanimet ku ata  
24 vepronin.

25 Për këtë arsye, mendoj që ne kemi vepruar drejt me qëllim

1 të parandalimit të një rrjedhimi të tillë jo të mirë edhe falë  
2 mungesës së gjykatave kompetente ushtarake të kohës.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] I lutem Sekretarit që të  
4 nxjerrë në ekran provën P225. Kalojmë në faqen e katërt, ju  
5 lutem. Më falni. Në rregull e kisha në fakt, faqja e katërt në  
6 anglisht dhe në shqip. Kjo është.

7 Po marr shembullin që kemi përpara, z. Dëshmitar. Në  
8 pjesën poshtë titullit vendim që është data 31 dhjetor 1999,  
9 këtu flitet për ndalimin e një personi për veprën penale të  
10 "falsifikim të dokumenteve të udhëtimit dhe bashkëpunim me  
11 okupatorin serb me qëllim të përfitimit material dhe pasurimit  
12 të paligjshëm". Këto janë arsyet që janë dhënë në këtë  
13 dokument për ndalimin e këtij personi, kështu?

14 PË. Po nuk ka qenë vetëm kjo, ngase ky person duket se ka  
15 bashkëpunue me autoritetet e armikut me qëllim të krijimit të  
16 falsifikimit të dokumenteve me qëllime të caktuara, pra, që  
17 një formë do t'i inkriminojshin qytetarët në veprime dhe ata  
18 të arrestohen për falsifikim dokumenteve. Pra, kjo shkonte në  
19 sistemin e ofrimit të mundësisë kinse për dokumenta legale.  
20 Ndërsa sa i merrshin qytetarët këto dokumente, ai lajmëronte  
21 se këto ia ka dhënë këtij e këtij personi, ndërsa policia  
22 serbe ata i inkriminonte në gjykatë se kanë bërë falsifikim të  
23 dokumenteve të caktuara.

24 Pra, pasojat ishin për qytetarët që kishin interes të  
25 ikun nga Kosova mu për shkak të reprezaljeve serbe që u bënë

1 në kohën e luftës. Pra, ky ishte një bashkëpunëtor i  
2 Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë i cili krijonte  
3 dokumente false, ia ofrojke qytetarëve me pasaportat e tjera  
4 që ata të ikun jashtë, mirëpo më vonë i denoncojke, i paraqiti  
5 te policia dhe ata kishin pasoja për çështje të dokumentit të  
6 falsifikuar.

7 Pra, kjo ishte, mu sa kam njohuri, për këtë çështje është  
8 fjala.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në zonën operative të Llapit  
10 nga e dinit ju që ky person mund të kishte marrë vërtet në  
11 këtë, mund ta kishte kryer vërtetë këtë falsifikimin e  
12 dokumenteve të udhëtimit dhe se kishte bashkëpunuar me  
13 okupatorin serb? Çfarë burimi informacioni kishit ju për të  
14 thënë këtë?

15 PË. Unë nga familjarët e atyne personave që pësonin arrestin.  
16 Domethënë, ky ofronte një dokument fals edhe mandej shkojke i  
17 paraqiste në polici. Policia i dinte adresat e atyre, i  
18 arrestonte për falsifikim. Ndërsa nuk e denonconte atë që ia  
19 ka bërë këtë dokumentin të falsifikuar, pra, ky ishte një  
20 bashkëpunëtor i cili donte që, domethënë, një formë të  
21 përfitonte nga ajo, po njëkohësisht edhe t'i denonconte  
22 qytetarët.

23 Pra, këtë, kesi raste kanë paraqitë vetë qytetarët ngase  
24 ka pas shumë të atillë që janë denoncu nga policia me qëllim  
25 të kërkimit të një dokumenti të caktuar, pasaportës apo diçka

1 për me shku jashtë vendit në kohën e luftës.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, po thoni ju me pak  
3 fjalë, që për ndalimin e një personi, e vetmja bazë provuese,  
4 pra, e thënë ndryshe, e vetmja arsye për të ndaluar një person  
5 ishte se disa persona civilë të caktuar ishin ankuar për këtë  
6 personin dhe ju nuk kishit asnjë strukturë për ta intervistuar  
7 personin e ndaluar për të vërtetuar ose për të përcaktuar nëse  
8 ishte e vërtetë apo jo akuza e ngritur për këtë persona nga  
9 një person tjetër civil?

10 PË. Ne donim të ndërprejmë vazhden e këtyre keqtrajtimit që u  
11 bënin nga ata persona të cilët, jo keqtrajtime, po me pasoja  
12 shumë të rënda ndaj qytetarëve. Ne nuk kishin, sikur që thatë,  
13 as kemi për polici ushtarake as mundësi tjetër. Mirëpo kjo  
14 ishte ajo mundësia që një formë ta ndalojmë një rrjedhim të  
15 keq. Të cilën prej dy të këqijave kemi zgjedhë një keqe më të  
16 vogël dhe pasojat t'i zvogëlojmë që të mos na krijohet një  
17 anarshi.

18 Unë duhet t'ju shpjegoj edhe këtë, unë kam shkru  
19 urdhëresë, për shembull, si komandant i brigadës, për ndalimin  
20 kam ndërmarrë masa të parandalimit për huliganizmin në  
21 shkolla, për vjedhje, për prerjen e pyjeve e të tjera, në  
22 kuptim të asaj që nuk kishte autoritet policor apo dikush  
23 tjetër, po ishte zonë e përgjegjësisë tonë. Për këtë arsye, ne  
24 domosdoshmërisht pasi shtrinim autoritetin në vendet ku ishim  
25 na, ishin të lira, donim që një formë të pengojmë një rrjedhim



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. D'Ascoli

Faqe 121

1 të keq dhe kjo ishte kjo mundësi. Po ta kishim policinë,  
2 gjykatat ushtarake e të tjera apo civile, ne do të vepronim  
3 ndryshe. Këto ishin mundësitë e kohës në një situatë të tillë  
4 çfarë aty mbretëronte.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kaq pyetje kisha për ju.  
6 Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
8 D'Ascoli, keni pyetje?

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kam nevojë për një sqarim për  
10 procesverbal.

11 Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. D'Ascoli:

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, kur ju përgjigjët pyetjeve të Gjykatësit  
14 Gaynor sot në faqen 87, rreshti 2, mendoj që nuk ka dalë emri  
15 siç duhet këtu. Ju është bërë një pyetje dhe ju kanë thënë  
16 "Kush i raportonte z. Latif Gashi?". Dhe këtu ka dalë sikur  
17 keni thënë:

18 "Ka pasur një zëvendës Izri Alla", emri nuk është i  
19 qartë, ju lutem, nuk na ka dalë emri i këtij zëvendësit në  
20 procesverbal që "Është vrarë në vitin -- dhjetor të 1998".

21 E përsërisni dot?

22 PË. Po.

23 PY. Emrin?

24 PË. Hyzri Talla. Mendoj që e kem përmirësue gjatë procedurës,  
25 po që prapë ka qenë një rrjedhim i tillë.

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 122

1 PY. Faleminderit.

2 PË. Hyzri Talla.

3 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e z.

6 Thaçi? Keni pyetje?

7 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, kam

8 pyetje.

9 Pyetje vijuese tjetër nga z. Misetiç:

10 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, kam disa pyetje për ju në bazë të pyetjeve që  
12 kanë bërë Gjyqtarët, Gjykatësit. Dhe së pari dëshiroj t'ju bëj  
13 një pyetje nga -- në lidhje me pyetjen që ju bëri Gjykatësi  
14 Barthe, i cili është në faqen 53, rreshti 22. Dhe pyetja  
15 është:

16 "A dini ndonjë rast kur komandant Remi ka liruar ndonjë  
17 person ose e ka falur atë në kundërshtim me vullnetin e  
18 shprehur të Shtabit të Përgjithshëm?"

19 Dhe pyetja ime është: A dini ndonjë rast kur Shtabi i  
20 Përgjithshëm ka shprehur vullnetin e vet, ia ka shprehur atë  
21 komandantit Remi për të liruar ose arrestuar ndonjë person?

22 PË. Pra, të them në raport me Shtabin e Përgjithshëm ka qenë  
23 kompetent, pra, komandanti i zonës Remi. Unë tash nuk mund t'i  
24 referohem specifikisht asaj, pra, se çfarë vendimi ka marrë në  
25 suaza të pyetjes së juaj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.  
2 Dëshmitar, nuk ka mbetur shumë kohë. Ju lutem dëgjoni pyetjen  
3 me vëmendje. Dhe është thjesht një përgjigje me "po" ose "jo",  
4 pra, vetëm pyetja që ju bëhet.

5 Vijoni, z. Misetic.

6 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]  
7 Faleminderit.

8 PY. Ta përsëris edhe një herë pyetjen. Pyetja ime ishte e  
9 thjeshtë. A keni dijeni për ndonjë rast kur shtabi i  
10 përgjithshëm ka shprehur vullnetin e vet komandant Remit për  
11 të arrestuar ose për të liruar ndokënd, dini një rast të  
12 tillë?

13 PË. Jo, nuk di.

14 PY. Faleminderit. Tani në lidhje me pyetjet që ju bëri  
15 Gjykatësi Mettraux që fillojnë në faqen 70 të transkriptit të  
16 procesverbalit, ju keni treguar strukturën ose modelin që keni  
17 përdorur për të krijuar zonën dhe që çfarë ka ardhur edhe nga  
18 Shtabi i Përgjithshëm dhe si pjesë e kësaj strukture apo  
19 modeli që keni përdorur ju dhe që mund të jetë përshtatur në  
20 bazë të nevojave dhe specifikave të zonës së Llapit. Ju keni  
21 thënë që kjo ju është përcjellë si në bazën e një dokumenti që  
22 të cilit i jeni referuar. Dhe Gjykatësi Mettraux sugjeroi që  
23 ju i keni thënë ZPS-së dhe kjo është në pjesën 4, faqet 9 dhe  
24 në 10 në anglisht që si pjesë e këtij modeli apo strukture ka  
25 qenë dhe krijimi i ambienteve të ndalimit.

1 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dhe dëshiroj  
2 që t'i kërkoj Sekretarit që të na vendosë në ekran dokumentin  
3 P1775.4, faqe 9 dhe rreshtin 12, ndërsa në shqip faqen 8 që  
4 fillon në rreshtin 18. E kemi në ekran?

5 PY. Atëherë më lejoni të lexoj atë që keni thënë ju. Pyetja  
6 që ju bë ishte që:

7 "Pak përpara apo përpara shumë kohe -- ta bëj dhe një  
8 herë pyetjen. Vendndodhja e ndalimit në Llapashticë është  
9 krijuar si reagim të një urdhri të Shtabit të Përgjithshëm?"

10 Përgjigja juaj:

11 "Besoj se po. Duhet të ketë qenë pas lufte."

12 "PY. Po. Po kjo qendër ndalimi u krijua sepse ka dhënë  
13 urdhër Shtabi i Përgjithshëm për ta bërë këtë gjë?"

14 Dhe ju thoni që:

15 "Vetëm mund ta supozoj këtë gjë por mund të ishte e  
16 mundur sepse askush - as Remi as dikush tjetër - nuk mund të  
17 merrte vendim të tillë pa patur urdhër."

18 "PY. Të ndaluarit që u mbajtën në Llapashticë, a mund të  
19 ndaloheshin pa urdhër të Shtabit të Përgjithshëm?"

20 "PË. Besoj që jo, përveçse rasteve shumë të rralla si  
21 për shembull Stankovic ose Fadili ose ushtari që arrestova,  
22 përveç këtyre. Kur flasim për qendër ndalimi është e  
23 logjikshme që të krijohet, që për t'u krijuar ajo duhet një  
24 urdhër."

25 E shikoni këtë gjë?

1 PË. Po.

2 PY. Atëherë, siç e kuptova unë me dëshminë tuaj, ju po thonit  
3 që ju thjesht supozonit që ky ishte rasti që kështu ndodhte,  
4 pra, këtë prezumuat ju në bazë të asaj që mendoni ju që është  
5 e logjikshme, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. E saktë. Ky është supozim edhe këtë e kam deklarue në  
7 procesin para Prokurores ngase nuk kam pas një informacion të  
8 tillë. Edhe e përmenda edhe tash, ai ishte në diskrecion të  
9 komandës së Zonës Operative të Llapit për qendrën e ndalimit.

10 Tash raportet mes komandantit të zonës edhe Shtabit të  
11 Përgjithshëm nuk mund t'i di ngase ka qenë kompetencë e  
12 komandantit të zonës Remit. Pra, edhe këtu e kam cek,  
13 presupozoj, por jo dhe e konfirmoj një gjë të tillë.

14 PY. Në rregull. Atëherë a jam i saktë kur mendoj që ju nuk  
15 keni njohuri personale vetë që këto lloj urdhrash për të  
16 krijuar këtë qendër ndalimi kanë ardhur nga Shtabi i  
17 Përgjithshëm?

18 PË. Jo, nuk kam.

19 PY. Në rregull. Gjykatësit Mettraux ju i thatë që ajo që keni  
20 parë ju nga Shtabi i Përgjithshëm ishte në fakt "një dokument  
21 të cilit i jeni referuar", pra, një strukturë, një model, një  
22 format, për të krijuar zonën e Llapit. Dhe ju thjesht po  
23 spekuloni nëse ka qenë urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për të  
24 krijuar këto ambiente ndalimi, a kam të drejtë unë kur mendoj  
25 që nuk ka patur ndonjë udhëzim në atë dokument referues për të

1 cilin ju i folët Gjykatësit Mettraux?

2 PË. Jo, nuk ka pas.

3 PY. Faleminderit. Tani do t'u kthehem pyetjeve të Gjykatësit  
4 Mettraux po për një çështje tjetër. Ju përmendët Komunikatën  
5 53 kur ju përgjigjët pyetjes së Gjykatësit Gaynor.

6 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dëshiroj që  
7 tani të shikojmë dokumentin P1775.7, faqen 24, në versionin në  
8 anglisht dhe në shqip faqen 19 duke filluar nga rreshti 11.

9 PY. Dëshiroj t'ju tregoj se çfarë keni thënë ju, çfarë i keni  
10 thënë ZPS-së kur keni diskutuar Komunikatën 53. Okej. Duke  
11 filluar në rreshtin 21, një fjali që ka të bëjë me komunikatën  
12 53 ju lexohet juve dhe thuhet:

13 "Disa masa ndëshkuese po merren kundër elementeve  
14 kolaboracionist që vazhdojnë t'i shërbejnë rendit pushtues."

15 Dhe pyetja ju bëhet juve:

16 "Po çfarë masash janë këto?"

17 Dhe përgjigja është:

18 "Ne s'kemi pas raste të tilla në zonën tonë, shembuj, por  
19 ndoshta në zonat e tjera. Tash unë nuk e di as vetë se kujt po  
20 i referohet."

21 Pyetja ju bëhet:

22 "A e dini se për çfarë është fjala për këto veprime  
23 ndëshkuese? Pra, kujt i referohej Shtabi i Përgjithshëm"

24 Dhe përgjigja juaj në 2019 është:

25 "Nuk jam i sigurtë se kujt po i referohen për çfarë

1 masash ndëshkuese, por u referohet atyre ishin rreshtuar me  
2 okupatorin dhe aty thuhet atyre që vazhdojnë t'i shërbejnë  
3 pushtetit okupator dhe për t'i mbajtur ata në pushtet".

4 Dhe ju bëhet sërish pyetja:

5 "Po ju a e dini për çfarë masash ndëshkuese e kishte  
6 fjalën shtabi?"

7 Dhe ju thoni:

8 "Nuk besoj se mund të hamendësoj këtu."

9 E shihni këtë pjesë?

10 PË. Po.

11 PY. Pra, në 2019, ju i thatë ZPS-së që nuk e dinit dhe i  
12 thatë atë fjali se për çfarë veprimi ndëshkimor e kishin  
13 fjalën, apo jo?

14 PË. Po. Ashtu kam thënë. Edhe çështja tjetër rreth strukturës  
15 --

16 PY. Po, atëherë --

17 PË. Nëse mund të shpjegoj vetëm këtë. Për krijimin, pak më  
18 parë fola, për krijimin e milicisë paralele të uniformuar dhe  
19 të armatosur që do të vijë, domethënë, në luftë kundër  
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kjo ka qenë rreziku më i lartë  
21 dhe për këtë strukturë ju kam referue në atë kohë. Mirëpo, ne  
22 kemi ndërmarrë masa parandaluese por përveç Gjakovës dhe  
23 Deçanit në zona tjera nuk kemi pas përfshirje të krijimit të  
24 policisë paralele nga shqiptarët e Kosovës, pra, as në zonën  
25 tonë. Për këtë arsye ky shpjegim i shkurtër.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 128

1 PY. Po. Po a pranoni faktin që deri në momentin kur u nxorr  
2 Komunikata 53 ka patur persona që ishin ndaluar nga zona e  
3 Llapit të paktën në fillim të gushtit?

4 PË. Po. Dhe ka pas për shkak që --

5 PY. Faleminderit. Tani do të flasim për tre dokumentet që ju  
6 tregoi Gjykatësi Mettraux.

7 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Që kanë  
8 numrat përkatës P225 dhe SITF00242574.

9 PY. Në fakt përpara se të kaloj tek ajo pjesë kam një pyetje  
10 tjetër. Ju keni qenë shefi i shtabit i komandant Remit që nga  
11 dhjetori 1998 deri në të paktën prill të 1999, është e saktë  
12 kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe si pjesë e detyrave tuaja si shef shtabi, a keni  
15 pasur edhe përgjegjësinë në përgatitjen e dokumenteve të cilat  
16 i firmoste komandant Remi?

17 PË. Po, kam pas.

18 PY. Okej.

19 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Tani më  
20 lejoni t'ju tregoj dokumentin P225, që është amnistia e 31  
21 dhjetorit 1998 të cilën ua tregoi më herët Gjykatësi Mettraux.  
22 Ju lutem të vendoset në ekran.

23 PY. Në rregull. Atëherë, Dëshmitar, ky është dokumenti të  
24 cilin diskutuat me Gjykatësin Mettraux dhe dua t'ju them që  
25 Gjykatësin Mettraux i ka treguar të njëjtin dokument Rustem



1 Mustafës, komandant Remit, kur ka dhënë ai dëshmi këtu në  
2 korrik të vitit 2023. Dhe që në procesverbal në faqen  
3 përkatëse 5913, rreshti 5 deri në 6, komandant Remi ka thënë  
4 që:

5 "E ka përpiluar personeli im dhe ne e kemi lexuar dhe nuk  
6 kisha asnjë arsye se përse të mos ta nënshkruaja. E  
7 nënshkruajta."

8 Atëherë, ju do të duhet të keni qenë i përfshirë si shef  
9 i shtabit në përpilimin apo hartimin e këtij dokumenti për  
10 komandant Remin për ta nënshkruar ai, e saktë, Dëshmitar?

11 PË. Jo. Unë këtë dokument nuk e kam hartuar. Ka mund ta  
12 hartoj, pra, dikush nga me siguri policia ushtarake që ka bë  
13 propozimin e caktuar. Por unë s'e kam hartuar këtë dokument.

14 PY. Okej. Në rregull. Në paragrafin e parë përmenden  
15 rregulla, rregullorja e UÇK-së, komunikatat, rregullorja e  
16 administrimit civil, pra, rregulla të tilla, por nuk  
17 specifikohet këtu ndonjë rregull konkret i UÇK-së, apo jo?

18 PË. Jo.

19 PY. Dhe nuk specifikon as ndonjë komunikatë të caktuar të  
20 Shtabit të Përgjithshëm për t'i inkurajuar zonat që të lironin  
21 të ndaluarit, apo jo?

22 PË. Po. Këtu vetëm përmenden komunikatat e Shtabit të  
23 Përgjithshëm, por jo në mënyrë specifike.

24 PY. Në rregull. Praktika standarde për përpilimin e këtyre  
25 dokumenteve ka qenë që personi që i përpilonte ato duhet të

1 tregohesh shumë konkret dhe specifik për ato ku i bazonte ato,  
2 ato dokumente ku i bazonte urdhrin që do të lëshohej.

3 PË. Mu j me thënë për këtë dokument? Po, me siguri po.

4 PY. Po, fiks. Pra, juve nuk ju është treguar ndonjë  
5 komunikatë me anë të secilës inkurajoheshin zonat për të  
6 liruar të ndaluarit, po ju a dini ndonjë lloj komunikate të  
7 këtillë që inkurajonte zonat që të lironin të ndaluarit?

8 PË. Po --

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kundërshtoj. Sepse dëshmitari e  
10 ka thënë qartë që nuk ka qenë i përfshirë në përpilimin e  
11 këtij dokumenti.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk jam  
13 dakord sepse ai bëri pyetjen në lidhje me këtë çështje. Dhe e  
14 kundërshtoj kundërshtimin tuaj, rrëzohet.

15 Pra, mund t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar.

16 DËSHMITARI: Pra, përveç kësaj, ka pas edhe është, pra,  
17 deklarata publike numër 2 që në një formë përcakton  
18 respektimin edhe të konventave ndërkombëtare, pra, komunikata  
19 e 2 prillit të vitit 1998 dhe në këtë aspekt, mund t'i  
20 referohemi edhe për këtë mundësi çfarë, pra, i jepet si  
21 referencë eventuale për këtë çështje për të cilët ju  
22 parashtuat.

23 Z. MISETIC:[Përmes videolidhjes] [Përkthim]

24 PY. Në rregull. Pra, përveçse një komunikate që është lëshuar  
25 në prill të 1998, pra, shumë përpara momentit kur mund të jetë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuredin Ibishi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 131

1 ndaluar ndokush në zonën e Llapit ju nuk keni dijeni për  
2 ndonjë komunikatë rreth dhjetorit të 1998 për të liruar, pra,  
3 komunikatë të Shtabit të Përgjithshëm për të liruar të  
4 ndaluarit, është e saktë kjo?

5 PË. Po. Kjo ka ardh më vonë. Në kuptim të asaj që unë s'e kam  
6 pa gjatë luftës. Pas luftës po. Por ajo ka qenë -- nuk e kanë  
7 pas atë komunikatë, të them, të Shtabit të Përgjithshëm në  
8 kohën e luftës, po pas lufte e kam pa si të tillë.

9 PY. E keni fjalën për komunikatën e prillit 1998?

10 PË. Jo, atë. Ajo është ditun publikisht. Po për këto çka po  
11 ju referoni për këtë për lirimin e personave për të cilët ju  
12 tash parashtuat këtë të fundit nga Shtabi i Përgjithshëm.

13 PY. Në rregull. Atëherë unë ju tregova gjatë kundërpyetjeve  
14 një urdhër i cili ishte lëshuar nga Bislam Zyrapi për zonat  
15 dhe ishte 1D29 dhe ju e keni parë edhe nga Prokuroria. Është e  
16 drejtë që deri në momentin që ky, deri në momentin e këtij  
17 dokumenti z. Zyrapi dhe Shtabi i Përgjithshëm e dinin sesi  
18 mund të lëshoheshin urdhrat për zonat apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Në rast se z. Zyrapi dhe Shtabi i Përgjithshëm dëshironin  
21 që të nxirrnin dhe të lëshonin një urdhër për zonat për  
22 lirimin e të ndaluarve nuk është se do të duhet të komunikonin  
23 me anën e komunikatave me komandantët e zonave ose me komandën  
24 e tonave, apo jo?

25 PË. Po ajo kishte një mënyrë. Tash unë s'mund të predikoj

1 ngase komunikimin mes Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantit  
2 të zonës, pra, zonës tonë nuk ka qenë ashtu i shpeshtë. Edhe e  
3 vetmja mundësi e dërgimit të tyre, përveç dokumenteve publikë,  
4 sikur që ishin deklaratat publike dhe komunikatat atyne mund  
5 t'ju referohemi të kohës. Kurse çështje tjera, urdhëresat, ato  
6 unë po them dhe një herë që i kam pa pas luftës, gjatë luftës  
7 vetëm kam mund t'i komentoj dikush po jo dh në formë burimore  
8 ta kem pas një urdhër të veçantë.

9 PY. Në rregull.

10 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Atëherë do  
11 t'ju lutesha në ekran të vendoset dokumenti P885 në anglisht  
12 dhe P150 në shqip.

13 PY. Ky është dokumenti i 17 janarit 1999 të cilin jua tregoj  
14 Gjykatësin Mettraux, ja po presim të vendoset në ekran dhe në  
15 gjuhën shqipe. E shihni tani?

16 Pra, këtu fillohet:

17 "Në bazë të bazë të deklaratave politike të Shtabit të  
18 Përgjithshëm të UÇK-së ..."

19 Dhe sërish, z. Ibishi, dëshiroj t'ju them që z. Mustafaj  
20 i ka thënë Trupit Gjykses në rreshtin numër 1 të faqes 5914:

21 "Unë i kam nënshkruar këto dokumente të cilat mi ka dhënë  
22 personeli, stafi im."

23 Ju a keni qenë i përfshirë edhe një herë në përgatitjen e  
24 këtyre dokumenteve si shef i shtabit?

25 PË. Sikurse thashë, jo. Jo, s'kam qenë i përfshirë.

1 PY. Dokumenti nuk identifikon ndonjë deklaratë të caktuar  
2 politike të Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

3 PË. Jo. Gjithashtu edhe këtu, atje ishte komunikata, këtu  
4 thotë për deklaratat politike që mund të jetë edhe komunikata  
5 edhe kjo deklaratat. Këtu specifike deklaratat politike,  
6 ndërsa në rastin e parë ishte komunikata. Po unë po i  
7 referohem pasi që s'kam qenë, pra, shkruar apo përgatitës, s'e  
8 kam përgatit këtë dokument edhe atij po i referohem tash kur  
9 po e shof.

10 Pra, në rastin e parë ishte e komunikatave, ndërsa në  
11 këtë rast është e deklaratave politike.

12 PY. Në rregull. Një pyetje e ngjashme për dokumentin e  
13 mëparshëm. A keni dijeni për ndonjë deklaratë politike nga  
14 Shtabi i Përgjithshëm në të cilin flitet për lirin e të  
15 ndaluarve?

16 PË. Nuk kam. Është përfol, por nuk e kam. Atë e kam pa pas  
17 lufte një vendim të tillë. Në të vërtetë nuk thotë për lirin  
18 po thotë për mos marrjen apo mos ndërmarrjen e masave ashtu në  
19 atë nivel edhe, sa kam mbajtur mend, sa që ato të përkufizohen  
20 në autoritetet të komandantit të brigadës me qëllim që të mos  
21 ketë keqpërdorime në atë aspekt. Por përgjithësisht nuk mund  
22 t'i referohemi ndonjë dokumenti, gjegjësisht, ndonjë deklaratë  
23 politike apo komunikate të caktuar lidhur me këtë.

24 PY. Në rregull. Dhe ju nuk mund të identifikoni ndonjë të  
25 veçantë, a ju kuptoni mirë, e keni fjalën për diçka që e keni

1 parë vetëm pas lufte?

2 PË. Jo. Pas lufte e kam pa, gjatë luftës nuk e i kam pa këto  
3 vendime.

4 PY. Në rregull.

5 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në ekran ju  
6 lutem të vendoset dokumenti SITF00242574.

7 PY. Dëshmitar, në ekran shihni këtë dokument të cilin  
8 diskutuat me Gjykatësin Mettraux. Këtu fillohet sërish me një  
9 ndrysim që thuhet:

10 "Në bazë të marrëveshjeve politike në kuptimin e  
11 memorandumeve të Shtabit të Përgjithshëm, rregullores së  
12 brendshme të UÇK-së ..."

13 Por edhe këtu nuk specifikohet ndonjë dokument i caktuar,  
14 apo jo?

15 PË. Aty kam versionin në anglisht, por ashtu po e kuptoj që  
16 nuk specifikohet.

17 PY. Në rregull. Dhe a keni dijeni për ndonjë memorandum  
18 politik që mund të ketë nxjerrë Shtabi i Përgjithshëm në  
19 lidhje me çështje e të ndaluarve?

20 PË. Jo.

21 PY. Në rregull. Faleminderit, Dëshmitar, që ju përgjigjët  
22 pyetjeve të mia.

23 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

24 Faleminderit, Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Dixon.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

3 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

4 Z. DIXON: [Përkthim]

5 PY. Z. Ibishi, vetëm disa çështje që kanë dalë. Së pari,  
6 Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje në faqen 59, në rreshtin  
7 8 dhe kjo kishte të bënte me aplikimin ose zbatimin e të  
8 drejtës ndërkombëtare humanitare. Një gjë dëshiroja që ta  
9 diskutoja me ju. Ju keni përmendur nenin 87 të Protokollit  
10 Shtesë, të Protokollit II Shtesë.

11 Në fakt mos e kishit fjalën për nenin 87 të Protokollit I  
12 Shtesë?

13 PË. Unë sa di është neni i Protokollit II Shtesë ngaqë ka të  
14 bëjë me konflikt të brendshëm. Edhe pse lufta e Ushtrisë  
15 Çlirimtare të Kosovës apo lufta në Kosovë ka dy aspekte. Edhe  
16 ka, është luftë, them edhe konflikt i brendshëm por edhe  
17 ndërkombëtar për shkak të implikimit të forcave ndërkombëtare.  
18 Unë ju kam referu në këtë rast Protokollit II Shtesë, sa unë e  
19 di, që ka të bëjë me konflikt të brendshëm dhe është neni 87.

20 PY. Po, Protokolli II Shtesë ka të bëjë me konfliktet e  
21 brendshme, po a keni dijeni që neni 87 i Protokollit I Shtesë  
22 ka të bëjë me detyrimet e komandantëve, mos ndoshta e kishit  
23 ke detyrat ose detyrimet e komandantëve në periudhat e  
24 konfliktit të armatosur?

25 PË. Unë sa kam mbajtur mend kjo, i referohet Protokollit II

1 Shtesë, veç nëse është një ko incidencë në nene, se unë u  
2 referue edhe neni 75 që ka të bëjë me çështjen e ndalimit të  
3 personave, ndërsa në nenin 87 përshkruan obligimet e komandës  
4 lidhur me personat e ndaluar në aspektin e kërkimit të  
5 përgjegjësive.

6 PY. Në rregull. A mund të kalojmë tani te një pyetje që ju  
7 bëri Gjykatësi Barthe, kjo ishte në faqen 48, në rreshtin 8 e  
8 tutje. Pyetja kishte të bënte me pjesën informimit e zbulimit  
9 që kishte të bënte me Mbrojtjen Civile dhe identifikimin e  
10 kolaboracionistëve. E mbani mend atë pyetje që ju bë?

11 PË. Po.

12 PY. Dua që t'ju çoj tek një pjesë e intervistës tuaj që i  
13 keni dhënë ZPS-së pikërisht për këtë çështje.

14 Do t'ua lexoj këtë pjesë dhe më pas d t'ju bëj disa  
15 pyetje në lidhje me të.

16 Juve ju është bërë pyetje në atë kohë duke ju referuar z.  
17 Gashi për të cilin kemi dëgjuar sot. Pyetja ka qenë e tillë --

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nëse mund t'ju ndërpresim, na  
19 jepni referencën, ju lutem.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Referenca është P1755, Pjesa 3  
21 dhe vjen nga faqja 17, rreshti 25 e tutje. Kjo është pjesa që  
22 na duhet.

23 PY. Pra, pyetja që ju bë ishte:

24 "Si shef i shërbimit të zbulimit për zonën, a do të thotë  
25 kjo që kishte përgjegjësi dhe për mbledhjen e informatave?



1 PY. Përgjigja juaj ishte:

2 "Po.

3 "A do të thotë kjo që kishin inteligjencë informata për  
4 armikun?"

5 Përgjigja juaj ishte:

6 "Po.

7 "PY. A përfshin kjo edhe ata që asistoin armikun?"

8 Dhe ju thatë:

9 "Për çfarë e keni fjalën?"

10 ZPS-ja tha:

11 "Civilë, të cilët ndihmonin armikun që ndihmonin, pra,  
12 armikun."

13 Dhe përgjigja juaj ishte:

14 "Po, mund të ketë qenë. Po nuk ishte ai roli i tij. Roli  
15 i tij dhe agjenda ka qenë që të mblidhej informacion që kishte  
16 të bënte me vendndodhjen e armikut, strategjinë e armikut dhe  
17 informata të cilat ishin të vlefshme në lidhje me këto  
18 çështje. Dhe, pra, kjo ishte kundërzbulimi për t'u përdorur  
19 për këto synime."

20 Më pas ju bëhet kjo pyetje:

21 "Por a kishte person që mund të mblidhte informacion për  
22 qytetarë që ndihmonin, asistoin ose besonin që ndihmonte  
23 armikun?"

24 Dhe përgjigja juaj ka qenë:

25 "Nuk mendoj që në atë kohë kemi patur kapacitete që

1 strukturën ta sillnim në këto lloj nivelesh apo që të ishin  
2 zgjeruar deri në këtë formë. Ka qenë e pamundur.”

3 A e mbani mend që ia keni thënë këtë ZPS-së, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Tani unë kam këtë pyetje: Kur thoni ju që nuk mendonit se  
6 kishit kapacitetet, a ka ndodhur kjo për faktin se kishit  
7 burime të kufizuara në këtë zonë, së pari, së dyti, s’ka pasur  
8 trajnimet përkatëse për çështjet e zbulimit, së treti, z.  
9 Gashi ka kryer një sërë detyrash dhe propozimi i katërt, ka  
10 pasur beteja të shumta që po ndodhnin në të njëjtën kohë?

11 Pra, këto janë katër arsye që i keni përmendur ju më  
12 përpara. Prandaj thoni ju që ne në atë kohë s’e kishim  
13 kapacitetin për këto arsye që keni përmendur më përpara?

14 PË. Po. Për këto nuk kishim kapacitete. Nuk kishim njohuri  
15 për bashkëpunim, po krejt këto rridhshin nga informacionet që  
16 vijke mbrojtja civile dhe qytetarët për bashkëpunim të hapur  
17 dhe që i kishin identifikuar me veprime të caktuara  
18 bashkëpunëtorët. Ne, në këtë aspekt, ato çka ju i dhatë dhe që  
19 unë po i përsëriti, kjo është ajo çka realisht ka qenë dhe ka  
20 ndodhë.

21 PY. Po, këtë doja të të pyesja në fakt. Si ishte vërtetë  
22 realiteti në terren në atë kohë gjatë konfliktit me të cilin  
23 po përballeshit ju?

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kundërshtoj. Kjo nuk ka lidhje  
25 me pyetjet e Gjykatësve.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Unë po bëj një pyetje për kapacitet  
3 për të trajtuar çështjet e kolaboracionistëve. Këtë pyetje e  
4 ka bërë Gjykatësi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Z. DIXON: [Përkthim] Unë thjesht doja ta pyesja cilët  
7 ishin.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Po bëje  
9 në mënyrë të kujdesshme këtë pyetje. Po është shumë pranë  
10 pragut të pa -- shumë pragut që nuk është e rëndësishme.

11 Z. DIXON: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, nëse nuk i përgjigjesh dot pyetjes, nuk e  
13 kuptuat pyetjen, unë po thoja këtë, duke marrë parasysh  
14 realitetin kur flisni për burimet që keni pasur në dispozicion  
15 ju në brigadën tuaj, në Brigadën 151 keni thënë që e keni pas  
16 një sektor të zbulimit. Dhe, në fakt, në këtë sektor ka pasur  
17 vetëm një person, z. Rrahimi, apo jo?

18 PË. Po, vetëm një person.

19 PY. Unë dua të flasim tani për një temë për të cilën ju pyeti  
20 Gjykatësi Mettraux sa i takon rregulloreve të përkohshme.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Që është reflektuar në faqen 65,  
22 rreshti 18 e në vijim. Ka lidhje me provën P163. Gjykatësi  
23 Mettraux foli pikërisht për këtë.

24 PY. Ju thatë që nuk ishit i sigurtë kur e kishit marrë këtë  
25 rregullore, nuk e mbani mend se kur e keni marrë këtë

1 rregullore, kështu?

2 PË. Jo.

3 PY. Po përpigem të kuptoj nga pikëpamja kohore sesi ka  
4 funksionuar sepse janë bërë disa pyetje për dokumentet me data  
5 të caktuara.

6 Ju e dini që komandant Remi ka dhënë dëshmi këtu në këtë  
7 sallë gjyqi.

8 Ai ka thënë në dëshminë me pranim fizike domethënë.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Po duhet të jap numrin e ERN për  
10 palët që po na ndjekin, bëhet fjalë për dokumentin me numër  
11 082894, Pjesa 2, në rreshtin 10 e më poshtë.

12 PY. Atij i është kërkuar të bëjë një përmbledhje lidhur me  
13 këto rregulloret se kur i ka marrë dhe ai thënë, po nuk ka  
14 qenë përpara nëntorit apo dhjetorit 1998. Po ty të kujtohet,  
15 duke të dhënë unë këtë informacion, nëse i keni parë edhe ju  
16 pak a shumë në të njëjtën kohë të qarkullonin në zonën tuaj  
17 këto rregullore?

18 PË. Dhe unë s'mund, sikur që të thashë më herët, nuk mund  
19 t'ju referohem saktësisht as rregulloreve dhe, pra, që janë  
20 sjellë nga Shtabi i Përgjithshëm.

21 Por, po e përsëris edhe një herë, për ato rregullore që  
22 kanë mungue ne kemi bë rregullore të përkohshme. Ne i kemi  
23 hartue, unë edhe Kadri Kastrati, komandant Daja edhe ato janë  
24 nënshkru nga komandant Remi dhe kanë qenë si rregullore të  
25 përkohshme deri në sjellje nga Shtabi i Përgjithshëm. Kështu

1 që kjo është përgjigja ime.

2 PY. Faleminderit. Në atëherë nëse s'mund të na jepni dot  
3 data, unë do të bëj një pyetje tjetër që ne e mbështesim tek  
4 dëshmia e komandant Remit. Ai ka thënë që ju në zonë jeni  
5 përpjekur t'i zbatoni:

6 "... po unë po ju them që kur filloi lufta ne ende po  
7 përpiqeshim të konsolidoheshim dhe s'ia kishim dalë ende. Po  
8 ishim më me fat se ç'menduam që do ishim."

9 Tani unë dua t'ju pyes dhe t'ju them: Këto rregullore -  
10 më falni - desha t'ju pyes: Këto rregulloret ju i vendosët  
11 ndonjëherë në praktikë në realitet dhe nëse i vendosët në  
12 praktikë deri në ç'skallë?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kjo nuk është pyetje që buron  
14 prej pyetjeve të Gjykatësve.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk i kam  
16 bërë unë këtë pyetje Gjykatësit.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po meqë u përdorën rregulloret si  
18 bazë në disa nga pyetjet e Gjykatësve.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të  
20 përdorni vetëm pyetjet e Gjykatësve.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull. Kjo ishte dëshmia e  
22 komandant Remit, kështu që s'po e zgjas më tej. Tani do kaloj  
23 tek aspektet e fundit që kam për të trajtuar.

24 PY. Z. Dëshmitar, dua të diskutojmë një pyetje që ju ka bërë  
25 Gjykatësi Gaynor dhe që është e pasqyruar në faqen 88, rreshti

1 8 e në vijim. Ju kanë bërë -- rreshti 12 e në vijim. Ai ju ka  
2 pyetur për ZKZ-në dhe strukturën e raportimit, vijën e  
3 raportimit në Brigadën 151 dhe brenda zonës. Dhe ju dhatë këtë  
4 përgjigje, po ta jap për orientim këtë:

5 "Rregullisht, z. Sabit i raportonte komandantit të  
6 brigadës. Ndërsa në momente të caktuara kur kishte çështje me  
7 rëndësi të madhe për zonën, atëherë ai i raportonte shefit të  
8 sektorit prandaj po them që kemi pasur një qasje të  
9 dykahshme."

10 A ju kujtohet ta keni dhënë këtë dëshmi?

11 PË. Po.

12 PY. Unë dua të kuptojmë çfarë ka ndodhur vërtetë në realitet.  
13 Kur keni thënë ju si rregull ai i raportonte komandantit të  
14 brigadës, ke dashur të thuash, që kjo ishte normalja, në  
15 përditshmëri kështu funksiononte?

16 PË. Ashtu është. Mbasi që ka qenë në kuadër të strukturës së  
17 brigadës.

18 PY. Po ju keni thënë që:

19 "... në momente të caktuara ka pasur çështje me rëndësi  
20 ..."

21 Po ishin të rralla rastet kur kontaktonte ai me shefin e  
22 sektorit?

23 PË. Po nuk janë të rralla. Mirëpo, normal, sipas asaj se sa  
24 ka qenë me interes ai të mbledhi informacionin apo ka qenë  
25 informacioni me interes të veçantë edhe për nivel të zonës,

1 pra, ashtu kam deklaru.

2 PY. Për çfarë informacioni po flasim këtu? Informacion për  
3 forcat serbe, për sulmet, avancimin e tyre, për këto?

4 PË. Po, direkt çka ka të bëjë me aspektet e rreziqeve dhe  
5 kërcënimeve nga forcat serbe krahas pozicionimit tonë dhe  
6 normal tendencave tjera edhe të shërbimit të inteligjencës  
7 serbe, po njëkohësisht edhe të policisë, të ushtrisë edhe  
8 strukturave paramilitare.

9 PY. Gjithashtu në lidhje me një pyetje që ju bëri Gjykatësi  
10 Gaynor në faqen 87. Ka folur për këtë akronimin, akronimin  
11 ZKZ. Ju keni dhënë dëshmi lidhur me këtë se nuk e kishit  
12 dëgjuar më përpara këtë akronim, po e keni dëgjuar për herë të  
13 parë pas luftës.

14 Unë dua të konfirmoj me ju nëse sektori i zbulimit në  
15 brigadë apo kudo, a njihej si ZKZ gjatë kohës që ke qenë ti në  
16 zonë?

17 PË. Unë e përmenda dhe më herët. Dhe nëse dojnë me bë një  
18 krahasim në nivel të zonës përdoret shërbimi, sektori i  
19 shërbimit informativ, ndërsa këtu ka një digracion,  
20 gjegjësisht, një ndryshim ngase përdoret si ZKZ. Po këtë ZKZ  
21 shumë pak është përdorë në atë terminologjinë e kohës.

22 PY. Faleminderit, z. Ibishi.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,  
25 keni pyetje?

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje. Faleminderit.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju  
4 e përfunduat dëshminë. Jeni i lirë të largoheni nga salla e  
5 gjyqit. Nuk kemi më detyrime për këtë Gjykatë. E vlerësojmë  
6 faktin që keni ardhur, e vlerësojmë shumë durimin tuaj. Ju  
7 faleminderit që ishit këtu dhe ju urojmë gjithë të mirat në  
8 të ardhmen.

9 DËSHMITARI: Falemnders.

10 Asistentja e sallës do t'ju shoqërojë.

11 [Dëshmitari largohet]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
13 të gjithëve. Sidomos faleminderit përkthyesve që kanë qëndruar  
14 më gjatë për ne sepse ishte e rëndësishme që ky dëshmitar të  
15 përfundonte. Në rregull.

16 Shihemi të hënën në orën 9.00.

17 --- Seanca mbyllet në orën 16.14

18

19

20

21

22

23

24

25